

REFORMA E PENSIONEVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Vjollca Sulejmani Asani

Dorëzuar : Universitetit Europian të Tiranës Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Fakultetin
Ekonomik, me profil Menaxhim, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor : Prof. Dr. Nagip Skenderi

Numri i fjalëve : 53918

Tiranë, Qershor, 2018

DEDIKIM

Këtë disertacion ia dedikoj vajzës sime, Morea Asani, për mungesën gjatë kohës që
i përkushtohesha disertacionit të doktoraturës...

FALËNDERIM

Për këtë udhëtim të gjatë të disertacionit, jam me fat falë disa individëve të mrekullueshëm, të cilët më mbështetën në çdo kohë; për këta individë fjalët, mirënjohjet dhe falënderimet nuk do të jenë të mjaftueshme për t'ua përcjellur.

Ky studim është rezultat i shumë viteve studim. Dituritë dhe aftësitë analitike të shprehura në këtë punim nuk do të ishin të këtij niveli pa ndihmën e profesorit dhe udhëheqësit tim, për të cilin kam një mirënjohje të veçantë, Prof. Dr Nagip Skenderi, të cilit ia dedikoj një falënderim të veçantë për ndihmën e palodhshme që më ka ofruar në çdo kohë për të ndërtuar këtë punim.

Udhëtimi i studimit tim është rezultat i besimit të familjes sime dhe prindërve të mi e sidomos i babit tim, e në veçanti besimi i bashkëshortit tim, Ridvanit, i cili për këtë kohë më mbështeti dhe mbajti një pjesë të përgjegjësisë të mia, pa të cilin nuk do të isha sot kjo që jam.

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim me titull: “Reforma pensionale në Republikën e Maqedonisë”, është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Tiranë,

06.06.2018

Emri mbiemri dhe nënshkrimi

Vjollca H. Sulejmani Asani

Tiranë, 2018

ABSTRAKT

Procesi i kalimit nga reforma e pensioneve të tranzicionit në sistem të reformave të pensioneve me kapital financiar si dhe përshtatshmëria në këtë sistem pensional paraqet vështirësi të mëdha.

Kalimi i sistemit pensional të tranzicionit në sistem të reformuar pensional, me kapital të financuar, parasheh edhe rrezikun e humbjeve për shkak të devijimit të tregut të pensioneve si edhe faktorit demografik.

Në Republikën e Maqedonisë reforma e pensioneve dhe modeli *Pay-As-You-Go plus kursimet* në vazhdimësi është e ardhmja, por edhe model i suksesshëm që po ndihmon në zhvillimin e tregut të kapitalit në Republikën e Maqedonisë.

Funksionimi i sistemit pensional *Pay-As-You-Go plus kursimet* është model i trendit demografik të popullsisë, por dhe funksion i sistemit pensional në përbërje të tri kolonave pensionale, ku shtyllën e parë e udhëheq shteti dhe për të cilën përgjigjet shteti, ndërsa shtyllën e dytë dhe atë të tretë e udhëheqin shoqëritë pensionale private, ndërsa përgjegjësinë në rast të falimentimit për mjetet e mban shteti, por vetëm për 80% të mjeteve të kolonës së dytë, ndërsa për shtyllën e tretë, e cila është shtyllë vullnetare, përgjegjësinë e mban i vetësiguruari ose vetë anëtari.

Problemi kryesor i kërkimit dhe argumentimi i këtij studimi është të studiohet dhe të vërtetohet ndikimi i reformës pensionale dhe interaksioni i saj me kushtet e tjera ekonomike në tregun pensional.

Fjalët Kyçe: reforma, pensione, solidaritet, kontribut, efikasitet, zhvillim, kapital, financim.

ABSTRACT

The transitional process of a transitional pension system into pension system with financial capital and adaptability of the reforms of the pension system presents a huge difficult.

The transfer of a transitional pension system into a pension system with financial capital provides the risk from losses due to diversion of pension market and demographic causes.

In Republic of Macedonia, the reforms taken in the pension system and the model Pay-As-You-Go plus savings are prospering continuously which is a successful model who is assisting in the development of the capital market.

The functional model Pay-As-You-Go plus savings pattern is demographic trend of the population and the pension system functionality consists of three pillars the first pillar of the pension is controlled by the state and the state takes responsibility whereas the second and the third pillar are controlled by private pension societies and the responsibility in case of bankruptcy of assets is held by the state but the state holds responsibility only for 80% of the assets of the second pillar and the third pillar which is voluntary the responsibility is held by self insured person or by members of that system.

During work I used the quantitative method of data collection, ie questionnaire was used for data collection. Another method used in this paper is descriptive method, by which I described editorial materials, scientific works, encyclopedias materials, official reports and primary literature regarding the matter by various authors mentioned in the literature review.

Keywords: Reforms, pensions, solidarity, contribution, efficiency, development, capital, financing.

STRUKTURA E PUNIMIT

KAPITULLI I.....	1
HYRJE	1
1.1. Shtrimi i problemit.....	2
1.2. Qëllimi i studimit.....	3
1.3. Pyetjet kërkimore të hulumtimit dhe hipotezat	3
1.4. Mundësitë dhe kufizimet	4
1.5. Përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe metodës së hulumtimit	5
KAPITULLI II:.....	6
RISHIKIMI I LITERATURËS	6
2.1. Koncepti i pensionit.....	6
2.2. Teorit mbi sigurimet shoqërore pensionale.....	9
2.3. Përvoja e reformës pensionale në shtetet e tjera	17
2.4. Historiku i reformës së pensioneve.....	27
2.5. Tranzicioni pensional.....	29
2.6. Nevoja për ti reformuar pensionet	31
KAPITULLI I III.....	37
REFORMA E PENSIONEVE ME KAPITAL FINANCIAR Të SIGURIMIT	
PENSIONAL	37
3.1. Kapitali financiar i sigurimit pensional.....	37
3.2. Qëllimi i Reformës Pensionale me Kapital Financiar.....	45
3.3. Rëndësia e pensioneve të reformuara	50
3.4. Rreziku social ekonomik, ku kapitali njerëzor fizik nuk mund të tregtohet	51
3.5. Institucionet e reformës pensionale me kapital financiar.....	53
3.6. Avantazhet për anëtarët e sistemit të reformuar pensional me kapital financiar	100
3.7. Tipologjia e pensioneve me kapital financiar të sigurimit pensional.....	106
KAPITULLI I IV	111
FUNKSIONIMI I PLANIT SHTETËROR TË PENSIONEVE DHE SHOQËRISË	
PENSIONALE PRIVATE.....	111
4.1. Roli i aktuarëve në planet pensionale	111
4.2. Funkcioni i Fondi për Sigurim Pensional në Republikën e Maqedonisë	114
4.3 Struktura e të hyrave dhe shpenzimeve të Fonit për Sigurim pensional Invalidor në Republikën e Maqedonisë.....	137

4.4. Struktura e të hyrave dhe shpenzimeve të shoqërive pensionale private me kapital financiar të sigurimit pensional.....	145
KAPITULLI I V.....	159
METODOLOGJIA E KËRKIMIT	159
5.1. Analiza dhe rezultate nga sistemi pensional në Maqedoni	159
5.2. Metodologjia, metodat dhe instrumentët bazë të studimit	160
5.3. Përmlledhje e rezultateve të Analizës së Regresionit, testimi i hipotezave	175
KAPITULLI I VI:	176
DISKUTIME, KONTRIBUTET E STUDIMIT, LIMITET & PERSPEKTIVAT E THELLIMIT NË TË ARDHMËN, PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	177
6.1. Diskutime.....	177
6.2. Kontributet e studimit, limitet & perspektivat e thellimit në të ardhmën	187
6.3. Konkuzionet.....	190
6.4. Rekomandimet.....	192
BIBLIOGRAFIA.....	194
A. Literatura kryesore (primare).....	194
B. Literatura dytësore (sekondare)	204
C. Literatura ndihmëse (terciare).....	209
ANEKS	219

Lista e Figurave

Figura 1. Institucionet në të cilat funksionon sistemi pensional në Republikën e Maqedonisë

Lista e Grafikëve

Grafiku 1. Struktura e ndryshimeve të popullatës

Grafiku 2. Parashikimet për mplakjen e popullatës

Grafiku 3. Krahasimi i të sigurve në tre skenarët

Grafiku 4. Numri i të sigurve nga 1991-2013

Grafiku 5. Numri i të sigurve deri në moshën 40 vjet dhe të sigurve 40-60 vjet

Grafiku 6. Numri i të sigurve sipas gjinisë

Grafiku 7. Numri i të sigurve sipas gjinisë

Grafiku 8. Krahasimi i të sigurve në tre skenarët

Grafiku 9. Pensione sipas llojit

Grafiku 10. Pensione sipas llojit

Grafiku 11. Të dalat e pensioneve si pjesë e GDP

Grafiku 12. Shpenzime tranzitive në krahasim me buxhetin

Grafiku 13. Shpenzimet tranzitive në krahasim me buxhetin

Grafiku 14. Struktura e të hyrave dhe shpenzimeve të Fondit për Sigurim Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë

Grafiku 15. Struktura e të hyrave dhe shpenzimeve në shoqërit pensionale KB dhe NLB për vitin 2012/2013

Lista e tabelave:

Tabela.1 Sisitemi i reformuar pensional me kapital financiar

Tabela.2 Shoqërit pensionale private në Republikën e Maqedonisë

Tabela.3 Instrumentet ku investohen mjetet e fondit pensional të obliguar dhe vullnetar

Tabela.4 Kushtet e anëtarësimit në shtyllën e dytë pensionale

Tabela.5 Avantazhet për anëtarët e kolonës së dytë pensionale

Tabela.6 Kontributete e për anëtarët e kolonës së parë pensionale dhe anëtarët e kolonës së dytë

Tabela.7 Shkalla e papunësis e shprehur në %

Tabela.8 Projektione për të siguruarit në periudhë afatgjate

Tabela.9 Numri i të siguruarve dhe pensionistëve prej reformës e deri në vitin 2013

Tabela.10 GDP për frymë banori e shprehur në euro

Tabela.11 Projektione për pensionistët dhe krahasimi ndërmjet të siguruarve dhe pensionistëve në periudhë afatgjate

Tabela.12 Projektione afatgjate për shpenzimet e pensioneve

Tabela.13 Numri i të siguruarve në vitin 2013

Tabela.14 Shkalla e rritjes së pensioneve prej vitin 1991-2013 sipas llojit të pensionit

Tabela.15 Numri i përfituesve të kompenzimit pensional i shprehur në para prej vitit 1997-2013

Tabela.16 Pjesmarrja e pensioneve në pagën mesatare neto

Tabela.17 Vlera e pensioneve minimale në vite

Tabela.18 Efektet financiare të sistemit të reformuar pensional

Tabela.19 Të hyrat e fondeve pensionale private për vitin 2013

Tabela.20 Shpenzimet e fondeve pensionale për menaxhim të fondit të obliguar pensional për vitin 2013

Tabela.21 Shpenzime për menaxhimin e fondit pensional vullnetar

Tabela.22 Mjetet e fondit pensional

Tabela.23 Asetet mesatare për të siguruarit

Tabela.24 Kontributet për anëtar në shtyllën e dytë pensionale në milion denarë

Tabela.25 Pensionet e realizuara për vitin 2013

Tabela.26 Numri i të siguruarve dhe pensionistëve të kolonës së dytë pensionale prej vitit 2006-2013

Tabela.27 Norma e kthimt të investimit tek fondet pensionale

Tabela.28 Njësia kontabël nga fillimi i reformës

Tabela.29 Të ardhurat dhe shpenzimet e fondeve private pensionale prej viti 2006-2013

Tabela.30 Shkalla anuale e kthimit nga investimet

Tabela.31 Kontributet e fondit pensional nga viti i parë i reformës pensionale

Tabela.32 Fondet pensionale vullnetare për vitin 2013

Tabela.33 Vlera e njësisë kontabël për vitin 2012-2013 në fondet pensionale vullnetare

Tabela.34 Vlera e njësisë kontabël e fondit vullnetar prej periudhës që egziston

Tabela.35 Kontributet e fondit vullnetar dhe vlera e kompensimit

Tabela.36 Pensionet e realizuara në fondin vullnetar për vitin 2013

Tabela.37 Rezultatet e regresionit të shumfishtë Modeli 1

Tabela.38 Tabela e korrelacionit, Modeli 1

Tabela.39 Rezultatet e regresionit të shumfishtë Modeli 2

Tabela. 40 Tabela e korrelacionit, Modeli 2

Lista e shkurtimeve dhe e fjalorit

MAPAS-Agjencia për supervizion i kapitalit financiar të sigurimit pensional

FSPIM-Fondi për Sigurim Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë

SHP-Shoqëria pensionale

FP- Fondi Pensional

FPO- Fondi pensional i obliguar

FPV- Fondi pensional vullnetar

KFSP- Kapitali financiar i sigurimit pensional

RM-Republika e Maqedonisë

NPF- Fond privat pensional

KB- Fond privat pensional

MPPS- Ministria për Punë dhe Politikë Sociale

MF- Ministria e Financave

ASP- Agjencia për sigurim pensional

KAPITULLI I

HYRJE

“Nderi i kombit fillon me të moshuarit dhe mbaron te fëmijët”

Abraham Linkolhn

Sistemi pensional në Republikën e Maqedonisë ka qenë i lidhur me zhvillimet e kalimit nga ekonomia e centralizuar në ekonomi tregu, që është një rënie e punësimit si pasojë e rënies të sektorit shtetëror. Kriza globale kishte ushtruar presion mbi ekonominë në përgjithësi, por edhe mbi politikën sociale pensionale në Republikën e Maqedonisë. Si pasojë e krizës globale u krijuan destabilizime financiare në sistemin pensional dhe u ndje nevoja për reformë pensionale. Këto ndryshime të vendit pas viteve ‘90-të të shekullit të kaluar e bënë të nevojshme, por edhe të domosdoshme, reformën pensionale me kapital financiar të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë. Në krahasim me format e tjera të mbrojtjes sociale, sistemi i pensionit në vend i është nënshtruar ndryshimeve më të mëdha, qysh prej vitit 1991.

Republika e Maqedonisë kishte shfaqur nevojën për reformë pensionale për arsye se reforma ishte menduar të bëhej nga shkaqet demografike (shtimi i numrit të plakjes së popullatës) dhe nga shtimi i numrit të pensionistëve në raport me të punësuarit, shkallës anuale të kthimit të pensioneve, aseteve mesatare për të siguruarit, përqindjes së papunësisë si dhe GDP.

Reforma pensionale në Republikën e Maqedonisë ishte bërë për siguri afatgjate të sistemit të qëndrueshëm financiar, efekteve pozitive afatgjate, një administrim pensional të shkëlqyer, si dhe një përgjegjësi e ndarë në mes të shtetit dhe fondit pensional privatë.

1.1. Shtrimi i problemit

Një pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë njerëzore ndikohet dhe drejtohet nga parashikimi i së ardhmes e pikërisht së ardhmës pensionale, pasi që mbështeten në pritshmërit që kanë në të ardhmen.

Problemi kryesor i kërkimit dhe argumentimi i këtij studimi është të studiohet dhe të vërtetohet ndikimi i reformës pensionale dhe interaksioni i saj me kushtet e tjera ekonomike në tregun pensional. Ky studim fillon me një vështrim teorik mbi literaturën e studiuar në lidhje me reforma e pensioneve. Më tej është bërë një kthim në retrospektivën për të kuptuar fillesat e para të reformës pensionale në Republikën e Maqedonisë.

Kapitulli tjetër është i fokusuar në funksionimin e dy institucioneve pensionale, atë të Fondit për Sigurim Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë dhe funksionimin e Shoqërive Pensionale Private. Duke e parë dhe duke e patur parasysh funksionimin e dy institucioneve të lartëpërmendura, ne jemi fokusuar në pritshmëritë dhe efektet financiare të tyre, të cilët na ndihmojnë për të parë ndikimin e reformës pensionale dhe interaksioni i saj me kushtet e tjera ekonomike në tregun pensional.

Punimi vijon me ndërtimin e një modeli ekonometrik i cili është i fokusuar në përcaktimin e faktorëve kryesor që ndikojnë në reformën pensionale dhe duke u fokusuar në këta faktorë do të bëhet indentifikimi i po atyre faktorëve që kanë më tepër ndikim mbi performancën financiare të pensioneve.

1.2. Qëllimi i studimit

Gjatë kërimit shkencor janë parashtruar qëllime të ndryshme me pikësynimin për të nxjerrë konkluzione të përafërta dhe të sakta për reformën pensionale.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është analiza e ndikimit të reformës pensionale tek të siguruarit dhe interaksioni i saj me kushtet e tjera ekonomike në tregun pensional.

1.3. Pyetjet kërkimore të hulumtimit dhe hipotezat

Ky studim përpiqet t'u gjejë zgjidhjen më të përshtatshme pyetjeve të mëposhtme:

- 1) A ka ndikuar pozitivisht reforma e pensioneve mbi numrin e të siguruarve?
- 2) A ka ndikuar pozitivisht reforma e pensioneve mbi asetet mesatare për të siguruarit?

Hipotezat e punimit janë:

H.1 Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguruarve.

H.2 Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

1.4. Mundësitë dhe kufizimet

Secili studim mëson që në mënyrën më të mirë t'i pasqyrojë të gjitha çështjet që janë të ndërlidhura me objektin i cili studiohet, por që në fakt është e pamundur që një studim të ndërtohet në mënyrë të përsosur.

Mundësitë e mia për një realizim të suksesshëm të punimit tim qysh në fillim ishin të konsiderueshme, pasi ushtroj funksion shtetëror të pensionet e pikërisht në mbikëqyrjen e pensioneve, por edhe për vetë faktin se punimi im është me temë për reformimin e sistemit pensional, nuk kërkon raporte ose materiale **të ndjeshme** dhe të brendshme konfidenciale.

Si për çdo studim, edhe tek ky studim rezultatet mvaren nga cilësia e të dhënave dhe nga një seri supozimesh të përdorura në studim, për të dhënat e të cilave kemi pasur si burim Agjencinë për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional, Fondi për Sigurim Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë dhe Fondet Pensionale Private, megjithëse në shumë raste nuk janë të dhëna edhe aq të plota.

Burimet dytësore (sekondare) i kemi grumbulluar nga institucionet e tjera përkatëse, të cilat janë edhe pjesë e sistemit të reformuar pensional, po sigurisht janë edhe pjesë të studimit.

1.5. Përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe metodës së hulumtimit

Ky studim shtrihet në reformën pensionale të Republikës së Maqedonisë. Të dhënat janë mbledhur gjatë vitit 2014. Natyra e punimit është hulumtuese dhe analitike. Mbledhja e të dhënave është realizuar në tre institucionet pensionale, atë të Fondit për Sigurim Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë, Shoqërive Pensionale private dhe në Agjencionin për mbikëqyrje pensionale. Përpunimi i të dhënave është realizuar përmes modelit statistikor ekonometrik të programit SPSS, ku analiza e regresionit të shumëfishtë është komponenta kryesore e analizës së rezultatetve të këtij studimi, testimit të hipotezave dhe nxjerrjes së konkluzioneve përfundimtare.

KAPITULLI II:

RISHIKIMI I LITERATURËS

Në kapitullin e II-të të studimit trajtohet në mënyrë analitike aspekti teorik i nocionit të pensioneve, sipas modeleve të ndryshme nga teoriticien të ndryshëm. Gjithashtu është trajtuar historiku mbi pensionet dhe nevoja për reformë pensionale me kapital financiar, problemet në realizimin e reformës pensionale, diskutimet për ta realizuar reformën pensionale si dhe trupi ndihmës për reformë pensionale dhe kreatorët e saj.

2.1. Koncepti i pensionit

Me pension nënkuptojmë përfitim me karakter kompensues. Sipas Dajmond dhe Bar, mirësjelljen e një shoqërie e paraqet standardi jetësor i shtresës së personave të moshuar e në veçanti shtresën e të varfërve dhe shtresën sociale pensionale. Financimi i shpenzimeve ka varshmëri nga akumulimi dhe grumbullimi i mjeteve të mëparshme financiare nga shteti.

Pensionet janë pjesë e sigurimit social të cilët sigurojnë një mbështetje financiare për popullatën e moshuar dhe për ata të cilët janë të paafte për punë.

Sipas Williams, (1997:2) pensioni është tërësia e procedurave të planifikuara dhe një proces ligjor për krijimin e një fondi të sigurtë për të përmbushur detyrimet e mbrojtjes sociale, për të cilën punëdhënësi është i detyruar ndaj punëmarrësit të tij të paguajë

kontribute deri në momentin e daljes në pension. (Guxho, 2014). Në përgjithësi pensioni personal është para së gjithash sigurim material, për të cilin i siguruari ka të drejtën e kthimit material për rastin e pleqërisë, por që plotëson kushtet e parashikuara me ligjë (Rregulla 17 mbi Vlerën e Benefiteve të Pensionit e aplikueshme për Fondin e Pensionit Suplementar Punëdhënës, Kosovë). Pensioni në vetvete përbën edhe fitimin e bazës së pensionit e cila nënkupton fitimin për pjesën e fitimit të pjesëmarrësit, vlera e së cilës mund të përcaktohet në Urdhëresën e Pensionit, të shfrytëzuar si bazë për llogaritjen e vlerës së kontributeve të pensioneve dhe benefiteve (Po aty.).

Për dallim nga pensioni, termi pension i shlyer nënkupton benefit të pensionit që rezervohet për pjesëmarrësin në përfundimin e marrëdhënies së punës së atij që paraqitet para moshës së pensionit, për të cilin fillimi i pensionit shtyhet derisa ai arrin moshën e pensionit (Dajmond, 2008:25). Me termin harmonizim pensional kuptojmë kur një individ krijon kontribute pensionale në përputhje me ligjin (Po aty.).

Mbulimi i pensionit është lloj i pensionit, i cili mund të jetë i pakompletuar. Me fjalën “e pakompletuar” kuptojmë kur personi punon për momentin dhe nuk i janë paguar kontributet në sistemin pensional dhe në të njëjtën kohë i punësuari nuk ka krijuar kontribute vullnetare (Dajmond, 2008:38).

Pensione me përfitime të përcaktuara kuptojmë kur benefitet pensionale janë të bazuara në pagën e individit dhe në kohëzgjatjen e shërbimit dhe ky lloj i kontributit financiar nuk mvaret nga mjetet e akumuluar, por mvaret nga rrezikshmëria e punës (Bar Dajmond, 39).

Pasi pamë nga definicionet e mësipërme se çfarë janë pensionet, në vazhdim do të shohim se çfarë janë pensionet financiare. Pensionet financiare paguhen nga fondi i grumbulluar, fondë i cili është i caktuar përmes kontributeve nga anëtarët e tyre

(Dajmond, 2013:189). Për dallim nga pensionet financiare, pensionet hipotetike me kontribute të përcaktuara janë pensione, të cilat financohen në bazën vjetore përmes kontributeve nga sigurimi pensional, ku pensioni mvaret nga kontributet jetësore të individit (Po aty.).

Pensionet nga tatimet vjetore janë pensione të cilat paguhen nga të hyrat momentale të grumbulluara nga tatimet vjetore në vend nga fondet pensionale (Po aty.).

Fond pensioni është një grup i mjeteve në pronësi të anëtarëve të fondit të pensionit, i përbërë nga kontributet dhe investimet e tyre, pasi janë zbritur të gjitha tarifat e krijuara mbi bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, ku secili anëtar ka në pronësi pjesën e tij, e cila përbëhet nga kuotat e zotëruara në fond. Administrimi i fondit të pensionit kryhet nga shoqëria e administrimit në bazë të kontratës së fondit të pensionit lidhur me anëtarët e fondit dhe me investimin e fondit.

Fondi privat i pensionit është një mjet kursimi i ideuar për të ardhurat shtesë kur të siguruarit e tij dalin në pension pleqërie, pension të parakohshëm, pension invaliditeti dhe pension familjar. Te fondi i pensionit, mbrojtja shoqërore është përgjigje ndaj nevojës për siguri, në kuptimin më të gjerë është proces i solidaritetit social dhe jo thjesht një sistem instrumentesh që garantojnë siguri (*ILO-international labour organization*). Me sigurim shoqërorë të detyrueshëm kuptojmë skemën jofitimprurëse, e cila mbron interesat e personave të punësuar dhe është sistem shoqëror i sigurimit, i cili garanton përfitimin në para. Me sistem të detyruar kuptojmë kur një anëtar kontributin e tij e ndan në dy pjesë, i cili njërën pjesë e transferon në shtyllën e parë shtetërore, ndërsa pjesën e dytë të mjeteve pensionale e transferon në kontribut individual, i cili në të ardhmen do të shërbejë si fondë i kursimit pensional.

Punimi im është bazuar në punimin e publikuar Pension Reform in Southeastern Europe me titull “Pension Reform and Financial Markets”: Encouraging Household Savings for Retirement të autorës Anita Tuladhar dhe Reformat e pensioneve në Shqipëri të autorës Valbona Gjini.

2.2. Teorit mbi sigurimet shoqërore pensionale

Teoria e parë ekonomike mbi sigurimet shoqërore pensionale shënohet që nga viti 1958 dhe është krijuar nga Samuelson, sipas të cilit për të ekzistuar një ekuilibër në një skemë pensionesh PAYG (paguaj ndërsa shkon), norma e kthimit duhet të jetë e barabartë me shkallën e rritjes së popullsisë, me kushtin e një page reale konstante. Samuelsoni ishte i pari që ka përshkruar se transfertat midis gjeneratave nënkuptojnë një normë të kthimit të barabartë me shkallën e rritjes së popullsisë, që ai e quante “norma biologjike e interesit”. Për këtë arsye, trendi demografik i një vendi është një çështje e rëndësishme, që duhet të merret në konsideratë, si në përcaktimin e masës në para të pensionit që duhet të përfitojë një individ, që ka paguar kontribute, ashtu edhe në përcaktimin e burimeve financiare të skemës së pensioneve. Përveç trendit demografik, aspekte të tjera që duhet të merren parasysh janë dinamika e tregut të punës (veçanarisht numri i personave në forcat e punës), politikat e tatimeve dhe taksave (sidomos aftësia në mbledhjen e taksave) dhe fakti që niveli i përfitimeve duhet të konsiderohet si një përshtatje e sistemit të pensioneve me ndryshimin e rrethanave. Disa nga këto aspekte janë analizuar edhe nga Banka Botërore dhe janë marrë në konsideratë prej saj në përcaktimin e shkaqeve dhe arsyeve të reformës së pensioneve në vendet e ekonomive në tranzicion, (Shtetet e Europës Lindore në vitet e ‘80-të të shekullit të kaluar patën një rënie të të ardhurave

kombëtare). Këto vende konsideroheshin si vende me të ardhura të mesme, për sa i përket të ardhurave për frymë banori apo aftësisë për të mbledhur taksa. Në të njëjtën kohë, në këto vende po shfaqeshin tiparet e mplekjes së popullsisë dhe të rritjes së shpenzimeve, njësoj si në vendet me të ardhura të larta (Poaty). Ndryshimet demografike kanë pa dyshim një ndikim të drejtpërdrejtë mbi qëndrueshmërinë financiare të skemës së pensioneve.

Në mbështetje të Samuelsonit, Araon argumentoi pensionet dhe funksionimin e tyre (1966:14) duke menduar se në një skemë pensionesh PAYG të konsoliduar, norma e kthimit duhet të jetë e barabartë me shkallën e rritjes së popullsisë, plus normën e rritjes së produktivitetit. Kriza e pensioneve si fenomen është përshkruar kryesisht si një barrë financiare e sistemit PAYG për shkak të mplekjes së popullsisë, si edhe për shkak të një financimi jo të përshtatshëm. Bazuar në zhvillimet aktuale për shumë vende, autorë të ndryshëm vënë në dukje se pas viteve '90-të të shekullit të kaluar, fenomeni i mplekjes së popullsisë ka ndikuar ndjeshëm në rënien e qëndrueshmërisë së skemës së pensioneve (Raporti i popullsisë mbi moshën e pensionit me atë të popullsisë në moshë pune). (Abromavici, 2003: 7-10).

Vende të zhvilluara siç janë Italia, Gjermania dhe Franca kanë pasur probleme serioze financiare në fund të viteve '90-të. Sipas Prewo, (2002:11), nga vendet europiane të cilat kanë aplikuar më së shumti sistemin *Pay-As-You-Go* ishte Gjermania e cila ka aplikuar sistemin pensional publik në vitin 1889, ku 85% e pensioneve ishin pjesë e sistemit PAYG+Kursimet, sistem pensional që ishte i detyrueshëm dhe kontribues. Në këtë sistem pensional punëdhënësit dhe punëmarrësit ishin të detyruar të kontribuonin në lidhje me pagën që ata përfitonin. Gjermania nga buxheti shtetëror iu jepte përfitime pensionale vetëm punëtorëve që ishin të paaftë për të kryer veprimtari, por të njëjtën gjë

e kishte në funksion të aplikimit edhe Franca, Italia dhe Belgjika, të cilat janë goditur më shumë nga kriza demografike (më plakja e popullsisë) sesa vendet që mbështeteshin më shumë tek skema profesionale e pensioneve (Xhumari.M: Trajektoret e pensioneve në Ballkanin Perëndimor, studim).

Sipas Feldstein, (2001: 2-4), rritja më e madhe e numrit të pensionistëve, krahasuar me rritjen e forcave të punës nuk është një problem i përkohshëm ose një problem tranzicioni, por është një shqetësim i përhershëm lidhur me qëndrueshmërinë financiare të skemës së pensioneve (Guxho, 2014).

Një faktor që nuk duhet të nënvleftësohet është edhe migrimi i popullatës. Siç e thekson Augusztinovic, (2002:9), migrimi nga një vend në tjetrin është një kusht i përhershëm dhe shumë i rëndësishëm i cili duhet të merret parasysh për hartimin e reformës së pensioneve.

Përveç mendimeve dhe ideve të parashtruara më lart nga teoricienë të ndryshëm, siç e ka vërtetuar edhe vetë Schmahl, (1999:45), faktorët lokalë kanë një rol të rëndësishëm në reformimin e skemës së pensioneve. Këta faktorë mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëri vend në tjetrin. Ndryshimet në situatën demografike dhe dinamika e tregut të punës mund të konsiderohen si dy nga faktorët kyç më të rëndësishëm që kanë impakt në skemën e pensioneve. Kështu, në një situatë më plakjeje të popullsisë dhe ku faktorët e tjerë janë të pandryshueshëm, sa më e lartë të jetë shkalla e varësisë së moshës së vjetër - aqë më e madhe është nevoja për reformimin e skemës. Sistemi i sigurimeve shoqërore, i bazuar në parimet e solidaritetit midis brezave, pasqyron përgjegjësinë e të gjithë shoqërisë për t'iu siguruar një nivel të lartë jetese të gjithë individëve që nuk janë pjesë e forcave të punës. Për ta garantuar këtë, sistemi i sigurimeve shoqërore mund të financohet nga buxheti i shtetit, përveç të ardhurave nga taksimi i

forcave të punës. Në ditët e sotme, prodhimi është më shumë i orientuar drejt kapitalit, kështu që një mënyrë tjetër financimi mund të jetë edhe financimi që vjen nga të ardhurat të cilat vijnë nga taksimi i kapitalit. Megjithatë, është e rëndësishme të thuhet se nënvleftësimi i kapitalit njerëzor mund të gjenerojë dhe të stimulojë strategji joeficiente prodhimi.

Sipas Teorisë së Morrow-t dhe Kulu-së vlen të theksohet se ekziston një pabarazi lidhur me shkallën e përgjegjshmërisë së kategorive të ndryshme të shoqërisë për zbatimin e parimit të solidaritetit.

“Mplakja e popullsisë do të ndikojë në mënyra të ndryshme në të dyja sistemet e pensioneve, si në sistemin *Pay-As-You-Go*, ashtu edhe në atë plotësisht të financuar”, duke filluar nga lindja e nevojës për të kompensuar efektet e zvogëlimit të forcave të punës dhe të rritjes së shkallës së varësisë të kontributeve të sigurimeve shoqërore në masën e kontributeve për pension, duke kombinuar forcën e tregut të punës me reformën e pensioneve, rritjen e popullsisë që sjell efektë në rritjen ekonomike dhe normën e kthimit në të dyja sistemet pensionale. Për këtë arsye ky efektë duhet të merret në konsideratë si në sistemin PAYG, ashtu edhe në sistem të financuar; politikëbërësit duhet të analizojnë ndikimin që ka mplakja e popullsisë në buxhet dhe nevojën për një sistem për ndarjen e barrës fiskale midis gjeneratave (Po aty.).

Sipas Davis, një sistem i menaxhuar nga shteti mund të jetë subjekt i ndryshimeve të shpeshta të rregullave se si dhe sa është masa e përfitimit të pensionit, që sipas Davis, (1998:7), mund të jetë edhe e dobishme për publikun. Nga ana tjetër, sistemet e menaxhuara privatisht kanë tendencë të kenë kosto administrative më të larta dhe "ekonomi" të shkallës më të ulët. Pjesëmarrja në një skemë pensionesh mund të jetë e detyrueshme me ligjë, ose mund të bazohet në vendimin personal të individit. Skemat

vullnetare të pensionit lejojnë individin që të vendos vetë për mirëqenien e tij, por në përgjithësi në këto raste të siguruarit mbartin në vete shumë rreziqe.

Sipas Bolle në Salisu, (2007:22), eksperiencat e deritanishme kanë treguar se skema pensionale me kapital financiar duhet të jetë e detyrueshme, kjo për arsye se personat me të ardhura të ulta mund të mos jenë të prirur për të marrë pjesë në mënyrë vullnetare në skemë, ndërkohë që ata që janë me të ardhura të larta mund të mos e shikojnë të nevojshme pjesëmarrjen në skemën e sigurimit, që do të thotë se paraqitet mungesë e kontributeve në skemë për këto kategori individësh (Po aty.).

Pinera përkrahu sistemin kilian të daljes në pension, i cili është i bazuar tek pronësia, zgjidhja dhe përgjegjësia personale. Sipas Pinerës, (2004:24), në këtë sistem, punonjësit mund të zgjedhin cilëndo nga kompanitë e fondeve private të pensioneve për të menaxhuar llogaritë e tyre të kontributeve. Këto kompani nuk mund të angazhohen në asnjë aktivitet tjetër privat dhe janë subjekt i një mbikqyrjeje të rreptë nga ana e një agjencie qeveritare. Punonjësve aktualë, që kishin kontribuar në sistemin shtetëror, u jepej mundësia të qëndronin në të edhepse e ardhmja e tyre ishte problematike. Ata që dolën nga sistemi morën një “bono njohjeje”, e cila vërtetonte kontributet e tyre në sistemin e vjetër. Kur këta punonjës do të dilnin në pension, qeveria do t’u shlyente këto obligacione. Ligji inkurajonte pasjen e një portofoli të larmishëm, pa asnjë lloj detyrimi për të investuar në bono qeveritare ose në forma të ndryshme sigurimi.

Teoritë dhe modelet e Bizmarkut shpjegojnë që pas Luftës së Dytë Botërore u bënë reforma të shumta në të gjitha sferat e jetës shoqërore, prandaj edhe në fushën sociale e shoqërore ndodhën ndryshime të tilla, saqë u bënë joshje për politikanët e asaj kohe. Një gjë të tillë e ka përjetuar edhe koncepti i shtetit social, shoqëror e pensional, i cili e ka nxitur kalimin në modelin institucional të mbrojtjes shoqërore, ku si garantues kryesor

paraqitet sidomos vetë shteti (Skenderi, 2000: 66). Format më të hershme të sigurimeve shoqërore i gjejmë në Gjermani, në qeverisjen e Bizmarkut, dhe në Francë. Në kohën e Bizmarkut, sanksionet me ligjë në sistemin e sigurimit shoqëror të detyrueshëm morën hovë. Në politikën sociale ky sistem mbështetej tek institucionet ekzistuese të solidaritetit dhe të ndihmës reciproke (Xhumari, 2003:151). Kancelari gjerman ndërmori një reformë sociale, e cila ndikoi dukshëm në zbehjen e ndikimit social, me ligjin për sigurim shoqëror të detyrueshëm, i cili hyri në fuqi më 17 Nëntor 1881. Elementë më me rëndësi në kohën e Bizmarkut ishte arritja e kompromisit në mes të tri palëve: punëdhënësit, punëmarrësit dhe shtetit, arritje e cila shmangu rrezikun e revolucionit social. Ky lloj i reformimit pensional u përhap me shpejtësi në vendet e Europës dhe sidomos në shtetet ku është paraqitur rreziku më i lartë social (Skenderi, 2010:63). Sistemi i sigurimeve shoqërore është bazuar në parimin e ligjit për sigurim shoqëror i cili ishte i propozuar nga Otto van Bismarck. Ai në vitin 1883, kishte rregulluar sigurimet shëndetësore, në vitin 1884 aksidentet në punë dhe në vitin 1889 kishte propozuar ligjin për invaliditet. Modeli i Bizmarkut në sigurimet pensionale ishte i përqendruar në përfitimet dhe sigurimet, të cilat paguheshin nga thesari ose nga fondi të cilët ishin menaxhuar nga partnerët socialë, të bazuar në kontributet e të dyja palëve: punëdhënësit-punëmarrësit (Po aty, 38). Në kohën e Bizmarkut, modeli liberal i pensioneve ishte i ndërtuar mbi bazën sociale, bazë e cila ka kuptimin që shteti ndihmon të pensionuarit dhe të pensionuarit socialë deri në vlerën kufitare minimale.

Modeli Kilian është implementuar në vitin 1981, në të është përfshirë shkrirja graduale e sistemit PAYG si edhe zëvendësimi me një sistem të detyrueshëm DC. Punëtorët e rinj mund të jenë pjesë vetëm në sistemin DC, ndërsa pjesëmarrësit në sistemin PAYG kanë të drejtë të përzgjedhin midis sistemit të vjetër dhe atij të ri (Hysa,

2013). Modeli Kilian është një llojë alternative e kursimeve të detyruara, i cili si model thekson vetëmbrojtje, por edhe një model të llogarive pensionale. Menaxhimi i llogarive pensionale është i privatizuar plotësisht dhe ka të bëjë me llogaritë pensionale nga vetëfinancimi publik e privat, nga kompani të sigurimit të pensioneve për të maksimizuar normën e kthimit, ndërsa implementimi i sistemit të sigurimit pensional është minimal. Ky model është tipar i pensioneve kursimore dhe vë theksin mbi një efikasitet të lartë, mjetet e të cilëve menaxhohen prej pjesëmarrësve të dalë nga lista e miratuar nga qeveria, në të cilën individët sigurojnë performancën e riskut të investimeve. Modeli Kilian përfshin garantimet e llojit të pensionit: një përfitim i ulët i ndihmës sociale për ato shpenzime që nuk mund të mbulohen nga plani i detyrueshëm, një pension minimal i garantuar nga shteti prej rreth 25% e pagës mesatare, nëse kontributet për pension janë paguar për të paktën 20 vjet dhe një normë përfitueshmërie minimale e garantuar për çdo fond pensioni, i krahasuar me mesataren për shtetin, ku pagesa e garantuar nga shteti vjen në shprehje në momentin kur kompania e sigurimeve pensionale private dështon në menaxhimin e saj (Hysa, 2013:18-19).

I pari që ka folur për skemën me bazë kontributet, madje edhe më parë sesa Modeli Kilian, ka qenë Buchanan, (1968: 386-395), i cili mbron tezën e kalimit në një sistem fondi pensional të kontributeve dhe mbajtjen e angazhimeve të sigurimeve shoqërore nga ana e shtetit me anë të lëshimit të bonove qeveritare. Si shteti, ashtu edhe individët privatë, mund të krijojnë një skemë fondi pensionesh.

Xhejms dhe Vizas skemën e kursimeve pensionale të obliguar e kishin argumentuar me rolin dhe efektin e veprimtarisë përmes pyetjes së kursimeve pensionale dhe pyetja e problemit ishte se cila është siguria pensionale dhe se a është skemë e obliguar pensionale, (1995). Kjo ishte e parashtruar si dilemë në Bankën Botërore, si problematikë e reformës

pensionale dhe kjo ishte e parashtruar në Oxford University Press, 1995. Pas diskutimeve të shumta rreth çështjes së shtruar të dilemës pensionale për kursim pensional, japin konkluzionet e para: përshkrimi bazik është kthim drastik i fondit të obliguar pensional në plan kursimi, i cili paraqitet si formë mesatare në mes të sigurimit social dhe fondit pensional. Dobësi e sistemit pensional është kthimi i normës së interesit për mjetet e investuara si dhe udhëheqja e tyre. Kjo dobësi, e cila nuk vjen nga të gjitha shtetet, por që ka qenë prezent në Singapur dhe në disa vende të tjera, për krahasim në Kili, ku kishin udhëhequr me shpenzime operative të larta (Bodi, Dejvis: 2003).

Kili ishte shembull i njohur në diskutim për financimin dhe llogarinë financiare të detyrueshme dhe sistemin e pensioneve multipolare¹, i cili aplikoi sistemin pensional multipolar (Dajmond, 2013: 42). Meqenëse qëllimi kryesor i reformës së pensioneve është reduktimi i varfërisë, disa nga komponentët e skemës së sigurimeve mund të financohen nga të ardhurat e buxhetit të shtetit, ose nga forma të tjera taksimi. Përkeqësimi i standardit të jetesës së një gjenerate (p.sh. njerëzit që janë tashmë pensionistë), për të mirën e gjeneratave të tjera (si p.sh. pensionistët e ardhshëm) nuk reflekton siguri dhe harmoni midis gjeneratave dhe për këtë arsye nuk konsiderohet si një zhvillim i qëndrueshëm ose si një formë e së drejtës sociale. Përfundimisht, mund të thuhet se shumica e ekspertëve për skemat pensionale kanë argumentuar se financat publike mund të balancohen përmes të ashtuquajturave reforma të mëdha, si edhe duke përfshirë financimin e disa prej komponentëve të skemës. Por në këtë rast, analiza për krizën e pensioneve nuk duhet të përqendrohet thjesht në sistemin *Pay-As-You-Go* por edhe në *Kursime pensionale*.

¹ Sistem multipolar i krijuar nga tri nivele/skema/kolona pensionale, autorja Vjollca Sulejmani.

2.3. Përvoja e reformës pensionale në shtetet e tjera

Fillimisht duhet të ceket se ekzistojnë disa referenca përmes të cilave është munduar të krijohen disa standarde minimale lidhur me sigurimet sociale. Në këtë drejtim duhet të përmendet Konventa e ILO-s, e cila përveç që shërben si bazë e dizajnit të sigurimeve sociale, ajo jep një përkufizimin të sigurimeve sociale për nëntë fusha sa i përmban kjo konventë, si dhe përmban minimumin e standardeve për secilën fushë. Ashtu siç u cek edhe më lartë, Konventa e ILO-s nr.102 përfshin nëntë fusha të cilat kanë të bëjnë me :

- qasjen në përkujdesjen shëndetësore,
- sëmundjet,
- papunësinë,
- përfitimin e pleqërisë;
- lëndimet në punë,
- pensionin familjar,
- përfitimin e lehonisë,
- pensionin invalidor, si dhe
- përfitimet e mbijetesës.

Megjithatë ekzistojnë lloje dhe modele të ndryshme të rregullimit dhe organizimit të sigurimit pensional ku rrjedhimisht sistemi pensional është ndërtuar nga secili shtet veç e veç.

2.3.1. Austria

Sistemi i pensioneve në Austri ka ndryshuar vazhdimisht gjatë dekadave të fundit. Hapi i parë është ligji “*pensionkassen*” që rregullonte përfitimet e pensioneve në bazë të planeve të reja dhe që hyri në fuqi në vitin 1990. U përcaktua ligji që harmonizonte moshën për daljen në pension për burrat dhe gratë deri 65 vjeç. Në vitin 2003 ndodhën ndryshime të mëdha në sistemin e sigurimeve sociale të cilat u aprovuan nga Parlamenti Austriak: pensioni i parakohshëm do të shfuqizohej, dhe shuma vjetore e menduar e kontributeve për pension do të reduktohej. Ndryshimet ndodhën edhe në vitin 2005 me qëllim të harmonizimit të skemave të ndryshme të pensionimit.

Aktualisht, pensionet bazike të moshës jepen nga mosha 65 vjeçare për burrat dhe 60 vjeç për gratë. Gradualisht mosha e pensionimit për gratë do të barazohet me moshën e pensionimit për burrat brenda viteve 2024 - 2033. Për të marrë ligjërisht statusin e pensionistit duhet të përmbushet periudha kualifikuese, që mund të jetë 180 muaj (15 vite) kontribute. Në Austri sistemi pensional është i organizuar në tre kolona kryesore.

Në shtyllën e parë bën pjesë sistemi pensional ligjor (shtetëror) apo i detyrueshëm, e që praktikohet pothuajse në tërë Evropën. Fondet pensionale në këtë sistem financohen nga kontributet e punëmarrësit dhe të punëdhënësit. Karakteristikë e veçantë e kolonës së parë është se fondet e grumbulluara nga popullsia aktive shfrytëzohen në të njëjtën kohë për financimin e pensioneve për popullatën pasive, siç njihet ndryshe “*solidariteti mes gjeneratave*”, që nënkupton se këto mjete nuk dedikohen për investime në tregun e kapitalit.

Kolona e dytë ka të bëjë me sistemin pensional të ndërmarrësisë. Në këtë shtyllë financimi i fondeve bëhet kryesisht nga punëdhënësi dhe mjetet e grumbulluara nga këto fonde; zakonisht janë të dedikuara për investime në tregun e kapitalit. Pasiqë mjetet e

grumbulluara të këtyre fondeve nuk dedikohen për financimin e pensioneve aktuale, por për ato të ardhshme, del që çdo person aktiv kontribuon në financimin e pensionit të tij në të ardhmen.

Kolona e tretë ka të bëjë me pensionet private. Financimi i këtyre fondeve bëhet nga personat që në mënyrë individuale vendosin për të financuar pensionet e tyre në të ardhmen. Vlen të theksohet se mjetet e dedikuara në këto fonde janë të liruara nga tatimet shtetërore.

Sistemi pensional austriak është kryesisht i orientuar nga ai shtetëror (*Kolona e parë*) dhe është i një rëndësie të veçantë pothuajse për tërë popullatën passive (pensionistët) dhe njëherit i vetmi burim i të ardhurave të tyre. Pra, 80 % e pensioneve aktuale paguhet nga ky fond. *Kolona e dytë* (ajo e ndërrmarësisë) dhe e tretë (ajo private), janë në zhvillim e sipër dhe nuk paraqesin ndonjë ndihmesë të veçantë për financimin e fondeve pensionale.

Përparësia e vetme e sistemit austriak të pensioneve është se mjetet e grumbulluara nuk janë të dedikuara për investim në tregun e kapitalit, gjë që mund të kuptohet se fondet pensionale austriake nuk janë shumë të varura nga zhvillimet e tregut të kapitalit, përkatësisht nga normat e interesit, apo nga kriza e tregjeve financiare, siç ishte rasti me krizën globale financiare. Ndërsa, mangësia e këtij sistemi është se ky sistem pensional është shumë i varur nga zhvillimet demografike (në njërën anë), kurse pensionet e ardhshme të gjeneratës së tashmë aktive (në anën tjetër), janë shumë të varura nga produktiviteti dhe aftësia financiare e gjeneratës së ardhshme.

Çdo ngritje e shkallës së pensionit, në njërën anë, dhe ulja e normës së kontributeve, në anën tjetër, të kësaj gjenerate ngarkon financiarisht në gjeneratën e ardhshme.

2.3.2. Zvicrra

Si në sistemin austriak, ashtu edhe në atë zvicëran, është i njohur koncepti, i ashtuquajtur “*modeli trikolonësh*”, i shpjeguar më lartë tek sistemi austriak. Përkundër sistemit austriak, sistemi pensional zvicëran është i orientuar sa në sistemin shtetëror (*kolona e parë*), po aq edhe në atë të ndërmarrësisë (*kolona e dytë*) dhe sistemin privat (*kolona e tretë*). Sistemi pensional shtetëror nuk e tejkalon shifrën prej 50% të pjesëmarrjes së tërësishme në sistemin pensional zvicëran. Pensionet e ndërmarrësisë përbëjnë 35%, kurse ai privat 15% të totalit të pensioneve. Vlen të theksohet se “Kolona e dytë “e sistemit pensional zvicëran është e obligueshme.

Punëdhënësi është i detyruar të paguajë kontributet pensionale për punëmarrësit e tij që janë të moshës mbi 25 vjet dhe që kanë pagën vjetore më të lartë se 24.360 CHF. Kjo shtyllë paraqet dallimin esencial të sistemit pensional zvicëran nga ai austriak, ngaqë kolona e dytë në Austri nuk është e obligueshme. Edhe sistemi zvicëran njih si kontributdhënës personat të cilët janë të papunë dhe marrin ndihmë, përkujdesin ndaj fëmijëve sa i përket shkallës së parë dhe me kushte të caktuara. Zvicra, poashtu ofron bonuse në pensione për gra dhe burra të cilët përkujdesen për persona të afërt.

Sistemi pensional zvicëran të vetmen mangësi që ka është se mjetet e grumbulluara nga fondet pensionale të ndërmarrësisë, dedikohen kryesisht për investime në tregun e kapitalit dhe nga kjo del se janë shumë të varura prej zhvillimeve të tregut të kapitalit. Rasti më i freskët është ai i vitit 2008, ku për shkak të krizës financiare globale fondi pensional invalidor në Zvicër regjistroi një humbje prej 14 miliardë frangash zvicërane.

Por, në anën tjetër, përparësitë e sistemit zviceran kundrejt atij austriak janë të shumta. E para, ka të bëjë me zhvillimin e e njëjtë të nënsistemeve (si ai shtetëror, i ndërmarrësisë dhe ai privat), çka gjenerata e tashme aktive nuk është shumë e varur nga

produktiviteti dhe aftësia financiare e gjeneratës së ardhshme , dhe poashtu gjeneratat e ardhshme nuk ngarkohen financiarisht për shkak të ngritjes së pensioneve të gjeneratës së tashme.

E dyta, sistemi zviceran i pensioneve është i organizuar në atë formë që klasa e pasur merr pjesë më shumë në financimin e fondeve në krahasim me klasën e mesme apo klasën e varfër. Këtu baza mbi të cilën llogariten kontributet nuk është e përkufizuar “*Sa më të larta janë të ardhurat, aq më të larta janë kontributet*”.

2.3.3. Mbretëria e Bashkuar

Mbretëria e Bashkuar ka një popullësi prej 70 milion banorësh dhe fuqi punëtore prej 29 milionë njerëzve. Rreth 23 milionë prej tyre janë të punësuar në sektorin privat dhe 6 milion në sektorin publik. Numri i pensionistëve në Britani të Madhe është 12 milion, ndërsa rreth 1,4 milion punëtorë janë pensionistë të moshës. Pensionet në Mbretërinë e Bashkuar janë të organizuara në tre divizione të mëdha dhe 7 nënndarje:

1. Pensionet e Shtetit:
 - Pensioni Bazë i Shtetit
 - Pensioni i Dytë i Shtetit (S2P)
2. Pensionet e Punës (Profesionale):
 - Pensioni i përfitimeve të përcaktuara
 - Pensioni i kontributeve të përcaktuara
3. Pensionet Personale (Individuale):
 - Pensionet e Palëve
 - Pensioni Personal për Grup
 - Pensioni Personal nga Vetë- investuar

Sistemi i pensioneve në Mbretërinë e Bashkuar mund të konsiderohet se është i organizuar në tre kolona apo nivele, të cilat kanë këto objektiva:

- Pensioni shtetëror, që ofrohet nga shteti dhe përbëhet nga një nivel bazë i pensionit që bazohet në vitet kualifikuese dhe kontributet e Sigurimeve Kombëtare. Ata që nuk kualifikohen për një pension bazë të shtetit, marrin një pension jokontribues .
- Pensioni i punës, që ofrohet nga shteti dhe ka për qëllim të ofrojë të ardhurat e pensionit që është e lidhur më ngushtë me të ardhurat e punonjësve, të cilat financohen bashkërisht nga punëdhënësi dhe të punësuarit.
- Pensioni personal, aranzhohet dhe organizohet për të kontribuar nga individ me ofrues nga kompanitë e sigurimit.

Pensionet shtetërore bëjnë pjesë në Grupin e Kolonës së Parë të dhënies së pensioneve, të cilat ofrohen nga shteti dhe përbëhen nga një nivel bazë i sigurimit të pensioneve, duke siguruar një nivel minimal të të ardhurave të daljes në pension. Në kuadër të këtij grupi janë të përfshira Pensioni bazë i shtetit, i cili vepron mbi bazën “PAYG”, përmes Sigurimeve Kombëtare dhe tatimi i përgjithshëm dhe Kredit Pensioni, i cili financohet nga tatimet e përgjithshme. Mosha e pensionit shtetëror nuk është e njëjtë si e moshës së pensionit. Mosha e pensionimit është kur ju zgjidhni të dilni në pension, por mund të vazhdoni të punoni pas moshës së pensionimit shtetëror.

Pension Bazë i Shtetit (PBSH) është një pension jokontribues në kuptimin që shuma finale e paguar për një individ varet nga numri i viteve të kontributeve të Sigurimeve Kombëtare të bëra derisa të arrijnë moshën e pensionimit. Pensioni Bazë i Shtetit varet nga data e lindjes së një individi, e cila është aktualisht 65 vjeç për burrat, ndërsa për gratë është rreth 62 e 1/2 dhe është në rritje, për t'u barazuar me meshkujt në vitin 2018

në moshën 65 vjeçare. Egzistojnë pesë kategori të pensioneve shtetërore themelore (PBSH) të siguruara nga shteti:

1. Kategoria A është e bazuar në kontributet e individit;
2. Kategoria B është e bazuar në vitet kualifikuese të bashkëshortit ose partnerit civil;
3. Kategoria C është jokontribuese dhe është e pagueshme për të vejat e njerëzve që ishin mbi moshën 65 nga 5 korrik 1948;
4. Kategoria D është jokontribuese dhe është e pagueshme për njerëzit mbi moshën 80 vjeç, por duhet të plotësojë disa kushte të qëndrimit dhe dështojnë të kualifikohen për kategorinë A ose B;
5. Mosha Shtesë, është jokontribuese dhe është e pagueshme për të gjithë përfituesit e pensionet shtetërore të moshës 80 vjeç e më lartë.

Kategoria A përfshin pensionin që është kontribues dhe është i bazuar në historinë e kontributeve të individit, pastaj vitet kualifikuese të një bashkëshorti apo ish-bashkëshorti (të ndara përmes ose kur humbin të afërmit apo ndarje) mund të zëvendësohen për të siguruar një PBSH më të lartë. Për ata që kanë arritur moshën e pensionit shtetëror nga 6 prilli 2010 , numri i viteve të nevojshme për t'u kualifikuar për një kategori të plotë një pension është reduktuar nga 44 vjet për një burrë dhe 39 vjet për një grua deri në 30 vjet kualifikuese njësoj për burrat dhe gratë. Një person i cili ka më pak se 30 vjet punë kualifikuese do të ketë të drejtë për një pjesë të PBSH të plotë për çdo vitë kualifikuesë.

Kategoria B përfshin pensionin i cili është kontribues dhe bazohet vetëm në një bashkëshort apo partneri civil të viteve kualifikuese dhe të ardhurat. Më parë ajo ishte

vetëm për t'u paguar për gratë e martuara, por nga 6 prilli 2010 edhe burrat dhe gratë mund të kërkonin PBSH.

Kategoria C përfshin pensionet që janë të pagueshme në masën 60% të PBSH e plotë për burra të moshës mbi 65 vjeç.

Kategoria D përfshin të gjitha pensionet jokontribuese, ekuivalent me të rritur të cilët janë të moshës 80 vjeç, apo më lartë, dhe kanë qenë resident në Mbretërinë e Bashkuar për të paktën 10 vjet gjatë 20 viteve të fundit.

Mosha Shtesë – është jokontribuese dhe është e pagueshme për të gjithë përfituesit e pensionit shtetëror të moshës 80 vjeç e më lartë.

Pensioni Kreditor – ka dy komponentë: Kredia Garantuese, e cila aktualisht paguhet nga mosha 62 e $\frac{1}{2}$,

Dhe, Kursimet Kreditore, të cilat paguhet nga mosha 65 vjeqare. Prej vitit 2010 mosha minimale për marrjen e kredive Garantuese është në rritje.

Kredia Garantuese – është mjet përfitimi kryesor (i testuar), e cila paguhet aktualisht për ata të moshës 62 e $\frac{1}{2}$ dhe më lart. Njerëzit (ose familjet) bëhen të ligjshëm për Kreditë Garantuese nëse mjetet e tjera (burimet e të ardhurave) nuk arrijnë një nivel të caktuar. Kredia Garantuese ofron një rrjet sigurie për një nivel minimal të të ardhurave. Kredia Garantuese është e paguar me një bazë “Njësie Përfitim” që do të thotë se ajo i paguhet një personi të vetëm ose një çifti, në kushtet që të ardhurat nga burime të tjera janë nën nivelin e plotë dhe me kusht që çdokush që ka punuar dhe kursimet që mbahen janë nën kufinj të përcaktuar. Kredia Garantuese është rishpërndarëse, ajo paguhet nga tatimet e tanishme, të cilat rrisin të ardhurat e një individi, ndërsa pagesat e Kredisë Garantuese janë bërë për ata që janë me të ardhura të ulta.

Kursimet Kreditore - synojnë të sigurojnë ata të cilët kanë bërë depozita private për kohën e daljes në pension ose kanë bërë përgatitjet më të madhe të Pensionit Bazë të Shtetit. Shuma maksimale e pagueshme sipas Kursimeve Kreditore është 14,82 £ në javë për një person të vetëm dhe 17,43 £ në javë për një çift nga Prilli 2015.

2.3.4. Letonia

Reforma e parë e sistemit të mbrojtjes pensionale është ndërmarrë në vitin 1990. Fondi shtetëror i sigurimeve shoqërore u nda nga buxheti i shtetit dhe administrohej nga Këshilli Trepalësh:

- Përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve,
- Përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve, dhe
- Qeveria.

Fondi i sigurimeve shoqërore financohet nga kontributi i punëdhënësve në shumë prej 30% të fondit të pagave dhe 1% nga kontributi i punëtorëve. Edhe pse këto norma nuk ishin të larta, buxheti i shtetit ishte deficitar. Në Janar të vitit 1995, Qeveria ka paraqitur në Parlament koncepte të reja për reforma të sistemit pensional, të ashtuquajtur “sistemi trerreshtorë”, që përfshin:

- Kolona e Parë do të modifikohet si sistem “pay-as-you-go”, me një lidhje të fortë me kontributet, si dhe me një pension minimal që t’i mbrojtë të varfërit;
- Kolona e Dytë, me karakter të obligueshëm, si sistem i financuar dhe i menaxhuar nga llogaritë e kursimit personal. Pjesëmarrja ishte e kufizuar për anëtarë të rinj, si dhe për ata të rinjë të cilët bëjnë pjesë në kontigjentin e punës;
- Kolona e tretë, që është vullnetare, pensionet e menaxhuara privatisht, parimisht të organizuara (por jo ekskluzivisht) nëpërmjet punëdhënësve.

Është parashikuar se lidhja midis pagimit të sigurimit dhe përfitimit të pensionit në të ardhmen do të çojë në zvogëlimin e punësimit të fshehtë dhe do të stimulojë aktivitetet ligjore. Sistemi i ri nuk ka ndonjë shtytje në moshën e daljes në pension. Minimumi i moshës për dalje në pension është mosha 60 vjeçare . Ky sistem i ri pensional siguron gjithashtu edhe një garancion minimal pensional për të gjithë ata që arrijnë moshën 60 vjeçare edhe nëse nuk kanë punuar. Ndhima sociale sigurohet edhe për personat të cilat e arrijnë moshën 60 vjeçare, por nuk kanë mbi 10 vjet përvojë pune. Niveli nominal i ndihmës sociale vendoset nga qeveria. Momentalisht është 60 % e mesatares së pensioneve dhe 20 % të mesatares së pagave. Megjithatë, disa pensione të caktuara vazhdojnë të jenë më të privileguara. Ato përfshihen në buxhetin e shtetit dhe jo në fondin e sigurimeve shoqërore. Këtu përfshihen pensionet e ushtarakëve, zyrtarëve shtetërorë të punëve të brendshme dhe të drejtësisë dhe pensionet e akademikëve. Pensione të veçanta ka edhe për personat me merita. Të gjitha këto pensione janë disa here më të larta se sa i sigurimeve shoqërore. Ekzistojnë dallimet e beneficioneve në mes të sistemit të vjetër dhe të sistemit të ri pensional.

- Në sistemin e vjetër shumica e pensionistëve me vite të plota të punës që dalin në pension, pas moshës 60 vjeçare nuk lejojnë ulje të beneficioneve. Beneficionet janë të larta sidomos për ata që i kanë të ardhurat e larta (të cilat në të ardhmen kontribuojnë më shumë), ndërsa beneficionet janë të ulëta për ata të cilat i kanë të ardhurat e ulëta.
- Në sistemin e ri dalja e hershme në pension dënohet, p.sh. femrat të cilat dalin në pension në moshën 55 vjeçare do të kenë ulje në pensionet e tyre, nëse i ndërpresim kontributet. Sipas ligjit të ri, pas 10 viteve shpenzimet e pensioneve supozohet të jenë më të ulëta për $\frac{1}{3}$ e atyre që kanë pasur mundësi të jenë pjesë

e sistemit të vjetër. Si rezultat i kësaj, kontributet të cilat shpërndahen për pagesën e pensioneve janë zvogëluar nga 26% në 20% në vitin 2001. Për lituanezët nën moshën 40 vjeçare (që do të fillojnë të marrin pensione mbas 20 vjetëve), rreth 40% të pensioneve të tyre pritet të merren nga fondi i kolonës së dytë (*Koncept dokumenti për rregullimin e pensioneve, Prishtinë 2016*).

2.4. Historiku i reformës së pensioneve

Ndryshimet socio-ekonomike në Republikën e Maqedonisë në fillim të viteve '90-të të shekullit të kaluar, kanë ndikuar në destabilizimin financiar dhe këto probleme kanë qenë të pranishme në vitin 1993 po në këtë vit ka pasur ndryshime në Ligjin e Sigurimit Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë. Në vitin 1993 u vu re vonesa me periudhë më të gjatë, vlera e së cilës ishte 2.451,19 milion denarë, me ç'rast u aprovua vendimi që të fillojë pagesa me tri periudha, që nga fundi i vitit 1993. Në këtë kohë u shfrytëzuan edhe pjesët e mjeteve të rezervave të detyrueshme nga akcizat e naftës dhe derivateve, me qëllim që të sigurohen të ardhura shtesë dhe të krijohet stabilitet. Faktorët socio-ekonomikë u krijuan si rezultat i asaj që shumë pensionistë kishin paraqitur teprica teknologjike dhe kalimi nga ekonomia e planifikuar në ekonominë e tregut të lirë kishte ndikuar në rritjen e numrit të pensionistëve, të cilët në këtë kohë shumë firma të sektorit privatë dhe publikë kishin falimentuar. Në fillim të vitit 1997 me ndryshimet e reja ligjore kishte filluar të ndihet efekti pozitiv i reformës së re, mirëpo ajo që në vazhdimësi ka qenë e pranishme në sistemin pensional por dhe që paraqitej si problem, ishte se sigurimi pensional e invalidor u aplikua me jetëgjatësi shumë të shkurtër, si pasojë e ligjeve dhe obligimeve që asnjëherë nuk i kanë paraparë rreziqet e mundshme që mund të paraqiten gjatë fazës së implementimit të sistemit pensional (*Vis, 2003*).

Në këtë periudhë të destabilizimit financiar, ndodhën edhe destabilizime në tregun e punës, siç ishin: numri i të sigurve nuk përafrohej me pensionistët, paraqitja e tepricës teknologjike në tregun e punës, për shkak të vonësës së pagave ndaj të punësuarve me automatizëm vonoheshin edhe kontributet për anëtarët në Fondin për Sigurim Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë, që ishin burim i vetëm i financimit të pensioneve invalide të të sigurve. Kjo gjendje ka ndikuar dukshëm në të ardhurat dhe në rritjen e shpenzimeve në fondë, e cila ka krijuar shkallë të lartë të jolikuiditetit të pagesës së pensioneve. Sipas burimeve në këtë gjendje destabilizimi, 43 ndërmarrje publike kishin falimentuar dhe 30.860 punëtorë ishin të larguar nga puna. Shpenzimet për pensionistët ishin rritur dhe buxheti do të arrinte deri 13%. E gjithë kjo analizë tregon se në të ardhmen në Republikën e Maqedonisë nuk mund të arrihet që pensionistëve të ardhshëm t'u paguhen pensionet në bazë të ligjit për pension; ky fenomen paraqet një destabilizim financiar (Xhumari, 2003: 154). Në këtë periudhë u paraqitën destabilizimet financiare në tregun shoqëror dhe në tregun social, Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar shprehen vullnetin për ta ndihmuar Republikën e Maqedonisë në procesin e reformës pensionale. Aktivitetet e para për reformën pensionale Banka Botërore i kishte filluar në vitin 1993 në bashkëpunim me Fondin e Sigurimit Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë, i cili i kishte vonuar pensionet. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore (BB) i vunë në presion qeveritarët për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjes së pensioneve me qëllim për të krijuar ekuilibrin financiar makroekonomik (Banka Botërore, Dokument për projekt kreditor për mbështetje të sektorit social të Fondit Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë: 1997, Banka Botërore - Raport për ndihmë teknike të reformës pensionale në Fondin Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë: 2002)

Ndryshimet e thella ekonomike dhe politike në Republikën e Maqedonisë në vitin 2000 e bënë të domosdoshme nevojën për reformë pensionale nga sistemi i tranzicionit ekonomik të veprimtarisë PAYG në sistemin e financimit kapital të sigurimit pensional. Kjo temë shpjegon arsyet kryesore të reformës pensionale dhe të krijimit të sistemit pensional të reformës. Për këtë qëllim në Republikën e Maqedonisë në vitin 2002 hyn në fuqi Ligji për Financimin e Obliguar Kapital të Fondit Pensional. Procesi i reformës pensionale në Republikën e Maqedonisë është burim i Bankës Botërore. Situata me të cilën është ballafaquar Republika e Maqedonisë i detyroj qeveritarët që të kërkojnë ndihmë nga shtetet e zhvilluara me qëllim të zgjidhjes së problemit dhe të stabilizimit financiar.

Sistemi pensional në Republikën e Maqedonisë ka vepruar pothuajse 50 vite; mirëpo, në kontinuitet ka patur ndërhyrje në ndryshimet ligjore në pensione dhe në tregun e punës, gjithmonë duke patur parasysh që këto ndryshime nuk kanë qenë të rastësishme. Në atë kohë ishin krijuar ndryshime për efikasitet të reformës pensionale invalidore të të siguruarve, por edhe ishin paraqitur si nevojë për ndryshim.

2.5. Tranzicioni pensional

Ekonomia në Republikën e Maqedonisë ka pasur shkallë të lartë të jostabilitetit financiar dhe me pakënaqësinë e efikasitetit në shërbime dhe produkte të përgjithshme, të cilët ofroheshin për resurse. Problemet ekonomike, politike, privatizimi i institucioneve si dhe ristrukturimi i tregut, e ngritën shkallën e intensitetit të procesit të tranzicionit, ku u ndje nevoja për zhvillim të institucioneve të tregut ekonomik, e në veçanti zhvillimit të tregut të punës dhe të tregut të kapitalit (*Klusev, Fiti, Petkovski, Slaveski, Filipovski,*

2002: 5-6). Sipas Raportit të Tranzicionit, i punuar nga Banka Evropiane për Ndryshim dhe Zhvillim (EBRD), i cili tranzicion u paraqit në vitin 1994 në Regjionin e Evropës Juglindore dhe atë të Evropës Qendrore u analizuan për 4 vite rresht dhe tranzicionin e quajten sikur tranzicioni është komandë e përparimit në drejtim të tregut orientues ekonomik (*Klusev, Fiti, Petkovski, Slaveski, Filipovski, 2002: 59*). Strategjia për pensione, dhe veçanërisht për reforma të pensioneve, është e varur nga situata gjithëpërfshirëse ekonomike, sociale dhe demografike, duke filluar nga fillimi i strategjive e deri në mundësinë ku mund të arrij ekonomia dhe shoqëria e vendit (*Dajmond, 2013: 2-3*). Për ta kaluar fazën e tranzicionit në Maqedoni nevojiteshin kushte, ndryshime rrënjësore, duke filluar nga tregu i punës përmes zhvillimit ekonomik, motivimit për lindje të reja si shkak i destabilizimit pensional nga aspekti demografik.

2.5.1. Borxhi i mbetur qeveritar

Përvoja ndërkombëtare tregon se vendet që e kanë implementuar reformën pensionale, në njërën anë janë ballafaquar me probleme të kostos së tranzicionit dhe borxhit të mbetur, përderisa reforma me faza mund ta zgjidh këtë problematikë. Borxhi i mbetur qeveritar është i rëndësishëm nga shkak se nëse në një shtet me borxh të madh pensionesh sistemi pensional PAYG kalon në sistemin shumëkolonësh, një pjesë e kontributeve zakonisht do të kalojë në llogarinë individuale të fondit privat, dhe kjo krijon një boshllëk financiar midis të ardhurave PAYG dhe shpenzimeve që nevojiten për të mbuluar borxhin e mbetur të pensioneve.

Borxhi i mbetur krijon përcaktimin e vlerës dhe të financimit të boshllëkut pensional përmes këtyre formave:

- Lëvizja e parë është reformimi i sistemit të vjetër, për të balancuar sistemin pensional, duke ulur përfitimet dhe duke rritur moshën e daljes në pension, lëvizje e

radhës është penalteti për dalje në pension të parakohshëm, shtrëngimi i të drejtave për përfitime individuale dhe ndryshimi i metodës së indeksimit pensional në indeksin.

- Emetimi i bonove ose premtimi i një pensioni kompensues, për çdo punonjës që kalon në sistemin e ri dhe bonot e thesarit nuk mund të konvertohen në para të gatshme derisa punëmarrësi të dalë në pension dhe pensioni kompensues do të paguhet gradualisht gjatë gjithë periudhës së pensionimit.

- Ruatje e kontributeve të të siguruarve në sistemin e vjetër. Një opcion i tillë do të bëjë që personave me më shumë vite pune do t'u mundësohet që të paguajnë në kolonën aktuale PAYG, ndërsa për dallim të rinjtë me më pak vite pune do të detyrohen të paguajnë kontribute në sistemin e ri (*Sigurimet Shoqërore në Shqipëri: impakt i ndryshimeve demografike në zgjedhjet individuale, temë doktorature e mbrojtur në UT më 2013-ën, kandidati Eglantina Hysa dhe udhëheqësi prof.dr Engëll Pere*).

2.6. Nevoja për ti reformuar pensionet

Sistemi pensional dhe nevoja për reformën pensionale, që pikërisht është e përqendruar në domethënien dhe në rolin e Fondit Pensional Invalidor dhe në jetën sociale shoqërore e politike në Republikën e Maqedonisë ishte e domosdoshme, sepse cilësia e jetës së një individi në vetvete përmban dimensione të shumta në të cilat siguria ekonomike përfshin qasjet e drejtpërdrejta deri tek mundësia e tregut të punës dhe qasja e drejtpërdrejtë në sistemin pensional efektiv (*Dajmond, 2013:25*). Të gjitha sistemet pensionale në rajon dhe në botë po ballafaqoheshin me rrezikun nga tronditjet makroekonomike, tronditjet demografike dhe ato politike. Vendet e zhvilluara e paraqitën si funksion të Shkallës së Parë sistemin pensional, i cili i siguron qytetarëve të ardhura të sigurta për pleqëri, me qëllim që të garantohet siguri sociale dhe materiale për gjeneratat momentale dhe

gjeneratat e ardhshme të pensionistëve me kohë të gjatë (Bogi, Dejvid: 2013). Planet financiare në sistemin pensional të Republikës së Maqedonisë po ballafaqohen me rrezikun plotësues, veçanërisht me rrezikun gjatë menaxhimit të mjeteve, rrezikun investues dhe rrezikun nga tregjet e anuiteteve (*Po aty*, 2013:125). Edhe sistemi pensional në Republikën e Maqedonisë pikërisht ishte i përfshirë nga situata ekonomike, sociale, dhe politike e shtetit. Në dekadën e fundit sistemi pensional në Republikën e Maqedonisë kishte shfaqur sinjalet e para të destabilizimit financiar, politik dhe atij pensional. Ndryshimet e para u shfaqën me ndërhyrjet ligjore, duke bërë ndryshime të shpeshta dhe vendime të shpeshta në aspektin social dhe në atë pensional. Shteti filloj të kufizojë ligjin për pensionim dhe gjithashtu që ky kufizim rezultoj edhe tek popullata. Republika e Maqedonisë filloj të ndryshojë moshën e pensionimit si dhe përllogaritjen e përqindjes së pensionimit. Të gjitha këto ndryshime kanë ndodhur si rezultat i kalimit nga sistemi pensional i tranzicionit në sistemin ekonomik të reformuar. Kjo është pothuajse një revolucion, ngaqë ndryshuan të gjitha elementet sociale, pensionale dhe instruksionet, që pas ndryshimit të transformimit vjen në shprehje evoluimi i sistemit pensional me kapital plotësisht të financuar dhe me fazat e implementimit të reformës pensionale.

Faktor shumë i rëndësishëm, i cili ka krijuar jostabilitet financiar, por që dukshëm kishte nevojë për reformë pensionale, ishte ai që i përkiste spektrit social në Republikën e Maqedonisë ku bën pjesë struktura e mplakjes së popullatës, që shoqërohet edhe me shfaqjen e krizës së pleqërisë, dhe që është edhe njëra nga karakteristikat kryesore demografike që sjell hapa konkretë dhe të nevojshëm për reformën pensionale, e cila është dhe amalgama e krizës pensionale. Problemi që shkakton rritje të shpenzimeve për pension është rezultat i trendeve afatgjate: jetëgjatësia më e madhe, norma e zvogëluar e natalitetit, pensione para kohe dhe kujdesi më i mirë mjekësor (*Dajmond*, 2013:3). Kjo

krizë pensionale nuk është e mundur të funksionojë në sistemet pensionale, për shkak të mungesës së shumë elementeve, të cilat nuk mund t'i përshtaten realitetit pensional (Dajmond, 2013: 3). Struktura e mplakjes së popullatës ka mvarshmëri të plotë nga nataliteti, mortaliteti, migracioni i popullatës dhe nga emigrimi. Duke përdorur këto elemente ka mundësi të përmirësohet jostabiliteti demografik si: ulja e mortalitetit, rritja e numrit të lindshmërive, ulja e përfshirjes së personave me moshë të vjetër në fuqinë punëtore, ulja e shpenzimeve pensionale (Dajmond, 2013: 4-5).

2.6.1. Problemet në realizimin e reformës së pensioneve

Eficienca dhe shpejtësia në realizimin e reformës pensionale në sistemin pensional luajnë rolë të rëndësishëm në procesin e transformimit nga sistemi *Pay-As-You-Go* në Kapitalin Financiar të Sigurimit Pensional (KFSP) me qëllim zhvillimin e tregut të kapitalit, zhvillim i cili është bazament i procesit të privatizimit të kompanive shtetërore (Sistemi i financuar në Shqipëri, Fatos Ibrahim, zëvendës guvernator i parë i Bankës së Shqipërisë: Drini Sallko anëtar i KM të Bankës së Shqipërisë: 231).

Që të realizohej reforma e pensioneve ishte e nevojshme që disa probleme duhet të merreshin në konsideratë. Problemet janë:

- Menaxhimi dhe funksionimi i tranzicionit;
- Kalimi në sistemin kapital financiar të siguruar pensional, sistem i cili kërkon burime shtesë;
- Financimi i buxhetit, premtimet e sistemit ekzistues PAYG janë bono formale të qeverisë. Në teori buxheti i çdo vendi reflekton jo vetëm në borxhin e tij formal, por edhe në borxhin e tij të nënkuptuar për pensionet PAYG dhe për premtimet e ngjashme. Qeveria mund ta financojë koston e tranzicionit duke kërkuar kredi në vend dhe jashtë

vendit, por duke pasur në konsideratë se edhe ky lloj i menaxhimit bartë në vete koston financiare;

- Rritja e masës së kontributeve për pension të një vendi, mund të kryejë përzgjedhjen e financimit të një pjese ose të gjithë koston së tranzicionit, duke e ngritur në total masën e kontributit. Ky lloj i menaxhimit ka pasur pasoja në rritjen e informalitetit në shumë vende, si rrjedhim i së cilës është kostoja e kolonës së dytë, e cila duhet të mbulohet brenda masës ekzistuese të kontributit;

- Reduktimi i shpenzimeve në kolonën e parë, pasojat e tranzicionit i bartin pensionistët dhe punonjësit më të moshuar, zakonisht ata të moshës më të moshuar për dalje në pension, tek të cilët indeksimi i pensioneve është më pak gjeneroz (*Xhumari, Trajektoret e pensioneve në Ballkanin Perëndimor, Studim: 57-58*).

2.6.2. Kreatorët e reformës pensionale

Reforma pensionale është mundësuar nga trupi ndihmës i formuar nga Komiteti për reformën pensionale në përbërje të anëtarëve dhe specialistëve nga Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, Fondit për Sigurim Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë, Ministrisë së Financave, Komisionit të Letrave me Vlerë, Bankaës Popullore dhe nga konsulentë ndërkombëtarë, anëtarë dhe ekspertë nga Banka Botërore. Komiteti i kishte të caktuara obligimet e tij e sidomos opsionin më të mirë për reformën pensionale duke i kryer matjet dhe duke parashikuar në mënyrë të drejtë rrezikun. Nga situata e paraqitur në Republikën e Maqedonisë, ku në tërësi shpenzimet tranzicionale pensionale gradualisht do të duhet të ndryshohen, Komiteti Social për Reformë Pensionale merr vendim për reformën pensionale, e cila paraqet bazën për ndryshimin e Ligjit për Pension dhe Sigurim Invalidor të vitit 2000 e në vazhdim.

Kreatorët e reformës pensionale për vënien në funksion praktik të kapitalit financiar të sigurimit pensional janë ekspertë të vendit, të cilët kanë njohuri për gjendjen financiare të sigurimit pensional dhe që njëkohësisht kanë përvojë edhe nga shtetet e tjera. Komiteti për Reformë kishte filluar me diskutimet për reformën e sistemit pensional nga disa organizata joqeveritare (SOZHM organizatë e gruas, ECE lobi i gruas, Organizata e Gruas Shqiptare, Organizata e Gruas Turke, Organizata e Gruas Sipërmarrëse, Instituti i Politikës Sociale dhe Fakulteti i Drejtësisë) pjesa më e madhe ka qenë mënyra e menaxhimit, e ruajtjes së mjeteve, ndarja e mjeteve në dy fondet pensionale, mënyra e tërheqjes së mjeteve (tërheqje e programuar apo me anuitet), garancia e kthimit të mjeteve. Diskutimi më i rëndësishëm ka qenë me Fondin për Sigurim Pensional Invalidor në Republikën e Maqedonisë (FSPIRM) rreth themelimit të shoqërisë që menaxhon fondet pensionale, diskutimi rreth depozitarit, shoqërisë së sigurimit dhe avokatit të popullit, me qëllim që qytetarëve duhet t'u ofrohet siguri pensionale me cilësi të lartë. Interesimi më i madh është i fokusuar në bankat depozitare, që njëherit do të menaxhojnë dhe do të investojnë mjetet e anëtarëve, kurse nga ana tjetër luan rol edhe Trupi Rregullator i Mbikëqyrjes së Fondeve Pensionale, Agjencia për Supervizion i Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional.

Pjesa praktike e reformës së pensioneve shoqërore si model është huazuar nga shtetet e tjera, të cilat vetëm e kanë aplikuar sistemin pensional në aspektin praktik, modelin e sistemit pensional me kapital financiar dhe që i njëjti model u ka sjellë përfitime sociale dhe pensionale. Pas të gjitha këtyre hapave për proces të implementimit të reformës pensionale vjen në shprehje funksionimi i plotë i reformës, edhe atë përmes mënyrës së edukimit të të punësuarve, trajnimit të grupit reformues, punës praktike, si dhe nëpërmjet programeve të veçanta kompjuterike, të cilat do t'i përpilojnë individë të sektorit të IT-

së, që janë të specializuar në fushën sociale, bankare dhe që kanë njohuri të përgjithshme për Trupin Rregullator dhe për funksionimin e supervizorëve.

KAPITULLI I III

REFORMA E PENSIONEVE ME KAPITAL FINANCIAR TË SIGURIMIT PENSIONAL

Në kapitullin e tretë trajtohet sistemi i reformuar pensional me kapital financiar i përbërë prej tre kolonave pensionale si dhe karakteristikat e secilës kolon pensionale veç e veç, qëllimet e pensioneve të reformuara, rëndësia e pensioneve të reformuara dhe tipologjia e pensioneve.

3.1. Kapitali financiar i sigurimit pensional

Republika e Maqedonisë krijoi sistemin e ri pensional të reformuar duke kërkuar që jetëgjatësia e tij të jetë afatgjatë dhe e qëndrueshme. Gjatë aplikimit u ndryshua mënyra e plotë e funksionimit, për bazë të funksionimit të sistemit të ri është marë modeli i pensioneve i përbërë prej kolonave kolonave. Komiteti për Reformë Pensionale kishte krijuar sistemin e ri me qëllim që administrimi pensional të përmirësohet pozitivisht, prandaj përforcoj institucionet, të përbëra me dy ose më tepër institucione, të cilat do të menaxhojnë mjetet e pensionistëve aktualë dhe të atyre të ardhshëm. Pjesëmarrës në pensionet e reformuara do të jenë të gjithë personat fizikë që kryejnë veprimtari të caktuara dhe kanë për bazë kapitalin financiar të fondit pensional dhe gjithashtu anëtarët, të cilët plotësojnë kushtet si sigurues, do të përfitojnë të drejtën dhe statusin pensionistë nga Fondi për Sigurim Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë, i cili është pjesë e sektorit shtetëror si dhe shtesën pensionale private të kursyer dhe të menaxhuar nga shoqëritë pensionale private, të cilat grumbullojnë mjetet e anëtarëve të transferuara në

fondet pensionale private dhe të njëjtat mjete i akumulojnë deri në kohën e pensionimit, të njëjtat kontribute janë shumëzuar kështu që tek anëtarët kthehet po e njëjta njësi, plus kompensimin e po atyre mjeteve që pensionistëve i sjellin pleqëri të siguruar, por dhe qytetarëve në përgjithësi.

Kapitali Financiar i Sigurimit Pensional rregullon kapitalin e pensioneve, menaxhimin e punës me fonde pensionale si dhe menaxhon shoqëritë dhe fondet pensionale private, të cilat janë pjesë e sistemit pensional dhe invalidor. Fondet pensionale në kapitalin financiar të sigurimit pensional themelohen me qëllim që të përfitojnë kontribute të të siguruarve për t'i investuar në instrumente financiare që në të ardhmen shpërndarja e mjeteve të kryhet në bazë të rregullit të akumulimit. Kapitali Financiar i Sigurimit Pensional siguron shkallë të lartë të transparencës, e cila është edhe njëra nga karakteristikat kryesore të kapitalit financiar të sigurimit pensional e invalidor (*Raport i kapitalit financiar të sigurimit pensional, 2013: MAPAS*). Transparenca pensionale në Kapitalin Financiar të Sigurimit Pensional ka për qëllim të pasqyrojë transaksione financiare të sakta, të cilat mund t'i nënshtrohen kontrollit të pavarur me qëllim të rritjes së krijimit të besimit dhe rritjes së besueshmërisë. Transparenca në operimet financiare paraqitet në mënyrën e komunikimit, në nevojën për ngritje permanente të cilësisë së saj, në funksionin e matjes së efikasitetit financiar dhe funksionimit efikas të sistemit pensional. Rëndësi të veçantë në transparencën e sistemit pensional me kapital financiar ka të kuptohet qartësia e operimit pensional dhe saktësia e operimit të saj. Përmes transparencës pensionale mundësohet zvogëlim i shanseve për mashtrime apo skandale korporative dhe transparenca shërben për përmirësimin e veprimeve ekonomike të sistemit pensional. Si proces i pasqyrimit të të dhënave, transparenca i bën publike zhvillimet operative duke përdorur mënyrën e komunikimit

për informimin e organeve përgjegjëse dhe informimin e publikut mbi gjendjen e llogarive individuale të fondeve pensionale si dhe investimin dhe kthimin e mjeteve nga ato, shumën totale të pasurive të fondeve pensionale etj. (*Global Pension Sistem and their Reform, Robert Holzmann, 2013: Eorldeide Drives, Trends and Challenges*).

Në Kapitalin Financiar të Sigurimit Pensional kontributet e anëtarëve financohen përmes aktivës financiare, për të cilët si kthim janë obliguar pjesëmarrësit në plan individual. Kur një sigurues - anëtar do të pensionohet, Fondi Pensional do t'i ruajë të gjitha kontributet e anëtarit të grumbulluara më parë, së bashku me interesin dhe dividendën për akumulimin e mjeteve dhe i paguan mjetet e tyre në mënyrë të anuiteteve, ose në mënyrë tjetër të programuar, varësisht nga përcaktimi i vetësiguruesit ose tatimpaguesit (*Dajmond, 2013: 35*).

Funksioni i ri i Sistemit të Reformuar Pensional dhe Invalidor me Kapital Financiar në Republikën e Maqedonisë përbëhet prej tri kolonave :

- *Kolona e Parë*- shtyllë e obliguar shtetërore pensionale, e menaxhuar nga Fondi Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë.
- *Kolona e Dytë*- shtyllë e obliguar me kapital financiar të sigurimit pensional, e menaxhuar nga Fondet dhe Shoqëritë Pensionale Private.
- *Kolona e Tretë*- kolona vullnetare e kursimeve pensionale e menaxhuar nga Fondet dhe Shoqëritë Pensionale Private.

Tabela nr. 1. Sistemi i reformuar pensional me kapital të financuar

	Pay-As-You-Go	Kapitali financiar
Pensionet e definuara	I– Kolona e Parë	
Kontributet e definuara		II- Kolona e Dytë III-Kolona e Tretë

Burimi: www.mapas.gov.mk

Për të funksionuar Sistemi Pensional me Kapital Financiar, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale është institucioni që është bartës i reformës pensionale dhe i aprovimit të Ligjit për Kapital Financiar të Sigurimit Pensional, e cila nënkupton që ky sistem pensional invalidor do t’u ofrojë qytetarëve siguri materiale dhe sociale përmes tre kolona:

1. Sigurim Pensional dhe Invalidor në bazë të solidaritetit të Gjeneratës së Parë-
Kolona I
2. Sigurim Pensional të Obliguar me Financim Kapital – *Kolona II*
3. Sigurim Pensional Vullnetar me Financim Kapital - *Kolona III*

Sigurimi pensional dhe invalidor i obliguar në bazë të solidaritetit të gjeneratave sipas principit PAY-AS-YOU-GO, nënkupton që personat e siguruar paguajnë pensionet aktuale. Përmes kësaj kolone sigurohet realizimi i të drejtave nga siguria pensionale dhe invalide në rast të mplekjes, invaliditetit dhe vdekjes, që do të thotë se pjesa e tyre paguhet. Sigurimi pensional i përbërë vetëm prej një kolone financohet prej dy sistemeve me DB (*përcaktim përfitimi DB*) dhe DC (*me përcaktim të kontributeve DC*). Ky lloj i sistemit pensional quhet monopillar (me një kolonë) dhe njihet si PAY-AS-YOU-GO. Sistemi shtetëror në bazë të tatimit vjetor ka përparësi të konsiderueshme, duke e përfshirë kapacitetin social, i cili shfaqet në sipërfaqe nga situata e parashikuar nga aktuarët për gjenerata. Pagesën e kontributeve për sigurim pensional invalidor e kryen i obliguari për pagesë të kontributeve në Fondin Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë,

i cili në afat prej 5 ditëve kryen transferin e mjeteve në shoqërinë pensionale. Në sistemin pensional njëkolonëshe, punëdhënësi paguan kontribute për sigurim pensional dhe invalidor për secilin punëtor në Drejtorinë e të Hyrave Publike (DAP), pastaj ato mjete i transferon në Fondin e Sigurimit Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë (FSPIM) dhe nga kontributet prej 21% të Fondit Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë tërheq vetëm 14% për llogarinë shtetërore dhe 7% transferohen në llogarinë individuale të anëtarit të Kolona e Dytë Pensionale Private, apo shoqëria pensionale. Pensionet në Republikën e Maqedonisë, analizohen sipas modelit të ciklit të jetës dhe të punës ku vazhdimisht kursehen mjete dhe kjo është forma e kursimit pensional e financuar nga punëdhënësi.

Karakteristikë e Kolonës së II-të *Pensionale* është se udhëhiqen privatisht, që nënkupton se kontributet investohen në shoqëri, e cila i menaxhon mjetet e Fondit Pensional dhe në këtë rast rritet strategjia investuese duke i investuar në limit të gjitha mjetet e grumbulluara me qëllim të përfitimit, e cila parashtron rrezik investues të sistemit pensional. Kontributet e të siguruarve, të cilët nuk janë të anëtarësuar në Fondin Privat Pensional, edhe pse kanë qenë obligues në të, ruhen në llogari të veçanta të Fondit Pensional deri në momentin kur i siguruari do të anëtarësohet vullnetarisht në Fondin Pensional Privat (Ligji për Kapital Financiar të Sigurimit të Obliguar Pensional, 07-1801/1/2002, neni 9). Agjencia për Supervizion i Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional (MAPAS) përkohësisht e sistemon këtë kategori të të siguruarve në Fondin Pensional të Kapitalit Financiar të Obliguar dhe Invalidor. Agjencia, gjatë sistemimit, siguron që numri i të siguruarve të jetë proporcional me vlerën e përgjithshme të mjeteve të secilit fond të veçantë pensional. Mjetet e anëtarëve shëndërrohen në njësi kontabël, në Mjete të Fondit Pensional që do t'i menaxhojë Shoqëria Pensionale. Kontributet paguhen

në të njëjtën mënyrë edhe për të siguruarit të cilët i takojnë vetëm Kolonës së I-rë, po edhe për anëtarët e sistemit pensional të Kolonës së II-të. Ajo çfarë i takon reformës është se ekzistojnë dy fonde pensione të obliguara private për anëtarët e të cilave sigurimi pensional dhe invalidor sigurohet njëkohësisht nga ana e Fondit Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë dhe nga fondi i zgjedhur pensional dykolonësh, ku nga 65% neto, 14% e mjeteve mbeten në Fondin Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë dhe nga 35% neto, 7% destinohen në llogarinë individuale në sistemin e zgjedhur pensional të obliguar. Kontributet e arritura grumbullohen, investohen në tregun financiar, akumulohen dhe shumëzohen deri në pikën e realizimit të së drejtës për pension dhe deri në fitimin e së drejtës për statusin pensionist. Të gjithë të siguruarit, të cilët janë punësuar pas 1 janarit të vitit 2003, kalojnë në sistemin e reformuar, dhe pikërisht në Kolonën e II-të Pensionale, ndërsa personat që janë punësuar para vitit 2003, kanë të drejtën e zgjedhjes se a do t'i bashkëngjiten sistemit të reformuar pensional apo do të anëtarësohen në Kolonën e II-të, apo do të qëndrojnë në sistemin e vjetër pensional, i cili nënkupton që ata individë në të ardhmen, me statusin pensionist, do të marrin pension vetëm nga Fondi Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë, Kolona e I-rë shtetërore, ndërsa për personat të cilët do t'i bashkëngjiten reformës nënkuptohet që në të ardhmen, me statusin pensionist, do të kenë mundësi të përfitojnë pension edhe nga Fondi Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë, Kolona e I-rë shtetërore, dhe do të përfitojnë pension nga Shoqëria Pensionale Private e cila mban përgjegjësi për Kolonën e II-të Pensionale Private të Kapitalizimit Financiar të Sigurimit Pensional.

Karakteristikë e veçantë e kësaj kolone është se fondet e grumbulluara nga popullsia aktive shfrytëzohen në të njëjtën kohë për financimin e pensioneve për popullatën pasive, siç njihet ndryshe solidariteti mes gjeneratave, që do të thotë se këto mjete nuk dedikohen

për investim. Kolona e II-të ka të bëjë me sistemin pensional të ndërmarrësisë; në këtë shtyllë financimi i fondeve bëhet kryesisht nga punëdhënësi dhe mjetet e grumbulluara nga këto fonde zakonisht janë të dedikuara për investim në tregun e kapitalit, ndërsa Kolona e III-të nënkupton që çdo person aktiv, vullnetarishtë kontribuon në financimin e pensionit të tij.

Sigurimi Pensional Vullnetar, me financim kapital, është sigurimi i mjeteve të kapitalizuara, mirëpo në bazë të mjeteve të investuara; një veçori e kësaj kolone është se këtu mund të anëtarësohen të gjithë personat që kanë vullnet për t'u siguruar. Çdo person, qoftë i punësuar apo jo, ka të drejtë anëtarësimi, duke filluar nga mosha 15 vjeç e deri në pleqëri, gjithmonë duke mos e pasur parasysh vlerën e investimit apo vlerën fikse. Te sigurimi vullnetar bëjnë pjesë grupe të veçanta sociale: persona që punojnë jashtë vendit, personat e papunë që kanë nevojë të sigurojnë pension në bazë të skemës së detyruar. Punëdhënësi, që të sigurojë të ardhura shtesë, krijon edhe skemën vullnetare ku paguan kontribute shtesë dhe shuma përcaktohet nga vetë punëdhënësi. Ky sistem i pensioneve mund të përdoret nga ana e personave të vetëpunësuar, nga punëtorë të cilët nuk janë vazhdimisht në punë dhe në tregun formal të punës si dhe për punëtorë të cilët dëshirojnë të paguajnë kontribute më tepër (*Dajmond, 2013: 228*).

Multipensionimi i përbërë prej tri kolonave është pikërisht ky i kapitalit financiar të sigurimit pensional, në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë: sistemi i përcaktuar, sistemi i përcaktuar në premiume nga paga, nga fondet e kapitalizuara, nga fondet vullnetare private dhe nga fondet e pensioneve profesionale. Për shkak të rrezikut pensional mirë është të shfrytëzohet kombinimi i pensioneve me financim ditor dhe me kapital financiar, nga shkak që rrezikut i përgjigjen kolonat e kombinuara pensionale. Kalimi drejt financimit për anëtarët do të thotë që kontributet e secilit anëtar janë të dedikuara për

pensionin e tij dhe se qeveria duhet t'i financojë pensionet e pensionistëve aktualë si dhe shpenzimet për pensionet e fituara në kuadër të sistemit të tranzicionit përmes punëtorëve momentalë (*Dajmond, 2013: 229*).

Fondi Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë do të vazhdojë të paguajë pension invalidor, pension familjar dhe pension minimal të garantuar, për të siguruarit pa dallim se në cilin sistem është i anëtarësuar individ apo i punësuar. Për dallim nga kolona e I-rë Pensionale, kolona e II-të Pensionale me kapital të financuar do të paguajë vetëm pensionin e pleqërisë për pjesën e investuar në kapitalin financiar të sigurimit pensional. E parë në tërësi, kjo formë e funksionimit ka përparësi, të cilën e ofron kapitali financiar i fondit pensional. Vënia në praktikë e sistemit të ri pensional me sigurim të kapitalit financiar do të ofrojë solidaritet edhe me të drejtën e pensionimit në kolonën e I-rë të Fondit Pensional në varshmëri nga paga dhe nga kontributet, gjegjësisht në pension të përcaktuar, dhe ndërsa kolona e II-të pensionale do të funksionojë në parim të kursimit përmes llogarisë individuale ku mjetet e investuara do të shumëzohen në varësi të normës së kamatës (norma minimale fillon nga 4%) me të drejtën e pensionimit që e quajnë kontribute të caktuara me efekte të kursimit për pension të pleqërisë. Kapitali Financiar i Sigurimit Pensional funksionon sipas parimit të kontributeve të caktuara me të cilat kuptojmë se pensioni i të siguruarve varet nga vlera e kontributeve të paguara dhe nga akumulimi dhe shumëzimi i tyre në llogaritë individuale, me qëllim të ruajtjes dhe sigurisë së mjeteve dhe sigurisë pensionale të kthimit të vlerës së kontributit. Sistemi Kapital Financiar Pensional i siguruar, është i lidhur ngushtë me tregun e kapitalit që do të thotë se mjetet e investuara tregtohen në tregun financiar deri në shumëzim, të cilët sjellin përfitime të larta dhe vjen deri te zhvillimi i tregut kapital gjithmonë duke e pasur parasysh riskun e mjeteve të investuara, të cilat mund të ngecin. Një mënyra e tillë e

menaxhimit është themeluar në parim të mjeteve të akumuluar, të cilat investohen dhe realizojnë interes nga investimi (*Raport i kapitalit financiar të sigurimit pensional: 2013: Agjencia për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional*).

3.2. Qëllimi i Reformës Pensionale me Kapital Financiar

Qëllimi i Sistemit Reformues Pensional me Kapital Financiar të Sigurimit Pensional të Obliguar dhe atij Vullnetar është alokimi i ndërtimit të sistemeve pensionale në Republikën e Maqedonisë, i cili paraqitet si segment shumë i rëndësishëm në tregun e sigurimeve pensionale - shoqërore ku nënsistem i rëndësishëm është buxheti i Republikës së Maqedonisë në lidhje të ngushtë me institucionet financiare dhe zhvillimin e tregut të kapitalit dhe të tregut financiar. Në këtë aspekt Reforma siguron përmirësimin e politikës ekonomike, bën rritjen e faktorit lokal, grumbullon informatat lidhur me zhvillimin ekonomik dhe inkuadron çështje vitale të reformës ekonomike.

Qëllimet e Sistemit Pensional me Kapital Financiar janë:

- Siguri që nënkupton të drejtën pensionale invalidore të të siguruarve;
- Siguri afatgjatë dhe afatshkurtër të Fondit Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë;
- Siguri maksimale dhe rrezik minimal;
- E drejtë e garantuar e kthimit të mjeteve të kursyera për të gjitha gjeneratat;
- Krijim i besimit dhe sigurisë për opinionin, ndaj reformës së sistemit pensional përmes arritjeve të tjera.

Të gjitha qëllimet e përmendura më lartë, të cilat janë aplikuar në tregun e sigurimeve pensionale, sociale dhe shoqërore, do të rezultojnë pozitivisht për funksionimin e plotë të sistemit pensional dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi, të cilët

ndikojnë në uljen e efekteve sociale negative (ekonominë e tregut) tek proceset e ristrukturimit të ekonomisë. Kalimi drejt financimit ka efekte pozitive ndërmjet gjeneratave, sepse financimi ka për qëllim të zmadhojë rritjen e prodhimtarisë në të ardhmen dhe shtimin e vlerës së kursimit në të tashmen. Pasiqë shtohet kursimi, duhet të zvogëlohet konsumi i punëtorëve momentalë përmes kontributeve më të larta, ose përmes zvogëlimit të numrit të të pensionuarve të tanishëm, përmes uljes së përfitimeve (*Po aty, 2013:189*).

Qëllimi i Reformës Pensionale është që të mundësojë që gjeneratat e ardhshme të përfitojnë pensione më të larta dhe nëse sistemi i ri është tërësisht i reformuar, motoja e vetme e tyre është se qytetarët meritojnë siguri në ditët e pensionimit dhe të pleqërisë, ashtu si edhe shteti që meritonte kontributet e tyre në kohën e veprimtarisë së tyre (*Vis, 2003: 18-22*). Vështruar edhe nga aspekti teorik dhe ai praktik, funksionimi i kolonës së II-të Pensionale, pensionet me kapital financiar prodhojnë efekte makroekonomike plotësuese të cilat përbëhen nga kursimet, akumulimi i kapitalit, nga blerja dhe shitja e aksioneve, ku një pjesë e konsiderueshme e tyre tregtohet në ekonominë e vendit, e cila do të luajë rol të rëndësishëm në drejtim të përhapjes së shpejtë të tregut të kapitalit vendor. Me praninë e shoqërive investuese shfaqen edhe shërbime të reja financiare, instrumente financiare, dhe kjo pjesë e funksionimit pensional është perfeksionuar falë sigurimit të të ardhura më të larta.

Qëllim i rëndësishëm në Reformë është mënyra e funksionimit pensional nga ekonomia e hapur dhe tregu financiar në Unionin European. Pikërisht financimi kapital përmes skemës pensionale të kombinuar prej tre kolonave, e cila ndikon në diversifikimin e të hyrave pensionale, por dhe siguron më tepër të hyra në potencialin e PAYG-së, ku të hyrat në këtë rast neutralizohen, gjithsesi tregu duhet të sigurojë skemën pensionale me

kapital të financuar dhe të mirëdizajnuar, e cila luan rol të rëndësishëm në opinionin e gjerë, në performancën investive dhe në motivimin e qytetarëve. Shoqëria pensionale dhe fondet pensionale, mjetet e grumbulluara të Kolonës së Dytë i investon në tregun financiar vendor me përqindje të caktuar me ligj në bono, depozita bankare, certifikata për depozita, aksione dhe në letra me vlerë dhe në total mund të investojë 80% të mjeteve, në tregun ndërkombëtar dhe vlerën e mbetur prej 20% e investon në bono të shteteve të Unionit European dhe Bankës Qendrore të Unionit European, në Japoni, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në aksione dhe letra me vlerë, të cilat tregtohen në shtetet e lartpërmendura nga shkaku se investimet e fondeve në Republikën e Maqedonisë për tregtinë financiare ndërkombëtare janë të kufizuara në vlerat e përqindjes si edhe nga kufizimi se në cilin shtetë investohen dhe tregtohen mjetet. Të gjitha këto kufizime janë të përcaktuara si shkakë i rrezikut ku për këto mjete jepet garanci. Me garanci pensionale nënkuptojmë siguri të shoqërisë për standard jete të caktuar, prandaj pensioni përbëhet nga dy komponentë: nga shuma bazë që e paguan Fondi për Sigurim Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë dhe nga shuma shtesë që paguhet nga shoqëria dhe nga fondi pensional privat (kursimorja). Pensionet në sistem bashkëkohor me kapital financiar të sigurimit pensional do t'iu sigurojë stabilitet afatgjatë të siguruarve dhe anëtarëve në ditët e pensionimit, në mënyrën e funksionimit të tyre, në ndarjen e mjeteve të fondeve pensionale private të shoqërisë, mjeteve të rojtarët (banka) e pasurisë së fondeve dhe investimit të mjeteve të Kolonës II-të dhe Kolonës së III-të Pensionale. Sistemi pensional i tre kolonave pensionale tenton të minimizojë rrezikun e humbjeve dhe stabilitetin ekonomik. Fondi për Sigurim Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë paraqitet si sigurues edhe në rast të mashtimit dhe humbjes, do të paguhet nga fondi (*Bogi Dejvis*).

Siguria pensionale dhe besimi i plotë i opinionit të cilët do të sigurojnë stabilitet afatgjatë, siguri në mjetet e investuara për pleqëri, që përfshijnë përcaktimin e saktë të investimit të mjeteve, kontroll të vazhdueshëm të institucioneve të sistemit pensional. Me reformën e re sistemi pensional i Kolonës së I-rë nuk garanton për kthimin e mjeteve të investuara përmes pagesës së kontributeve në Kolonën e I-rë Pensionale apo nga Fondi Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë, nëqoftë se nuk e plotëson kushtin bazë për periudhën e sigurimit mbi 15 vjet përvojë pune, për dallim nga Fondi Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë, fondet pensionale dhe financimi kapital i sigurimit pensional i obliguar, anëtarëve u siguron kthimin e mjeteve të kursyera për kohën që anëtari ka kryer veprimtari dhe ka investuar një pjesë të kontributeve në fondin pensional privat si bazë kursimi dhe në rastin kur fitohet statusi pensionist, anëtari gëzon të drejtën e plotë për t'i tërhequr kursimet e tij. Reforma e Pensioneve në Republikën e Maqedonisë ka parashtruar në hartimin e planit për ndryshim dhe reformë edhe mënyrën e pagesës së pensionit, e cila do të kryhet përmes bankës komerciale, sepse ajo ofron siguri më të lartë sesa pagesa² cash, ose tërheqja e pensionit përmes postës. Ky lloj i ndryshimit ofron siguri më të lartë të mjeteve pensionale dhe njëkohësisht ofron angazhimin e bankave komerciale në pagesat pensionale, të cilat do të ofrojnë oferta më të përshtatshme dhe më të kapshme me mundësi më pozitive për pensionistët. Ndryshimet pensionale përfshijnë bazën e mbrojtjes së anëtarëve të rinj, të cilët presin pensione në të ardhmen, të cilëve ua kanë mbrojtur shpenzimet fiskale të sektorit shtetëror përmes pagesës së pensioneve si dhe përfitimet në interesin vetjak gjatë procedurës së implementimit të sistemit të ri nga ana e shoqërisë pensionale private. Ky rezultat sjellë reformën sociale me shtesë të mënyrës së pagesës së pensionit me kapital financiar për siguri pensionale, e cila ka në

² Para të gatshme, autorja Vjollca Sulejmani Asani.

funkcion sektorin privat të udhëhequr nga shoqëritë pensionale private, të menaxhuara nga fonde pensionale private të ndryshme.

Është e rëndësishme edhe mashtrimi dhe vjedhja nga kontributet pensionale pasiqë janë risqe të veçanta për të gjitha sistemet e sigurimit shoqëror si edhe në atë pensional. Në sigurimet pensionale në përgjithësi ekzistojnë mashtrimet nga shkakut e pagesave të shumta dhe se mënyra e të paguarit nuk është e sigurtë, prandaj procesi i pagesës në bankë komerciale në kohën e sotme rritë sigurinë e të paguarit dhe në sigurimet pensionale private (*Arnot, Grinvold, Kanbur, Najlbaf, 2012: 127*)

Për siguri të plotë ekzistojnë mbikëqyrësit e Agjencisë për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional, të cilët kryejnë këto verifikime, si:

- Kontroll të vazhdueshëm për shoqëritë pensionale si dhe dënime me vlera të larta për punë të kryera në mënyrë joligjore nga ana e trupit rregullator;
- Kontroll të kapitalit financiar të fondit pensional të obliguar;
- Mbrojtjen e interesave të anëtarëve të fondit pensional;
- Sigurinë materiale të mjeteve dhe sigurinë sociale të të siguruarve në kapitalizimin e mjeteve vetjake;
- Krijimin e varshmërisë dhe të drejtave investuese;
- Sigurinë e mjeteve të fondit pensional;
- Diversifikimin investues të fondit pensional etj.

3.3. Rëndësia e pensioneve të reformuara

Ajo çfarë është e rëndësishme në sistemin pensional të Republikës së Maqedonisë është se shteti po aprovon sistem të shkëlqyeshëm pensional të sigurimit invalidor, i cili është i ngjashëm në disa shtete të Europës. Mirëpo ky sistem pensional punon në regjim të pensioneve të përcaktuara. Sistemi pensional ka funksionuar dhe funksionon në bazë të gjeneratave solidare, që domethënë se personat e siguruar dhe që janë të punësuar paguajnë për pensionet e pensionistëve aktualë, duke shpresuar që në të ardhmen atyre do t'ua paguajnë individë ose persona të siguruar dhe të evidentuar në Fondin Invalidor Pensional të Republikë së Maqedonisë. Solidariteti paraqet përgjegjësi të ndërsjellë që anëtarët e një grupi social përgjigjen për njëri-tjetrin dhe për veprimet e tyre që i kryejnë në bazë të nevojës. E rëndësishme është se çdo pensionist do të përfitojë pension prej PAYG, Kolonës së Parë shtetërore nga Fondi për Sigurim Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë dhe pension nga llogaria e kursimeve të distribuara nga përqindja e kontributeve, pikërisht Kolona e Dytë e sigurimit pensional privat me kapital të financuar, që përmes llogaritjes së plotë nga ekspertë të vendit, aktuarë të punësuar në Fondin për Sigurim Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë dhe shoqëri pensionale si dhe ekspertë të huaj. Ky sistem pensional i reformuar do të funksionojë në mënyrë të plotë pas 50 viteve, që nënkupton se kjo pjesë e anëtarëve do të financohet jo vetëm nga pensionet minimale, por edhe një shtesë të financimit kapital do ta përfitojnë mes pensionimit dhe do të përfitojnë multipension. Ndryshimet socio-ekonomike kanë ndikuar që sistemi të jetë efektiv dhe efikas gjithashtu dhe i adaptueshëm për popullatën. Funksionimi i Kolonës së Dytë Pensionale ka nxjerrë efekte makroekonomike nga implementimi i tij në bazë të kursimit financiar të tregut në ekonominë e Republikës së Maqedonisë dhe në kontinuitet do të vijë dukshëm përsheptimi i ekuilibrit ekonomik të

vendit. Përlllogaritjet e aktuarëve japin konkluzionin se shpenzimet për Kolonën e Parë shtetërore pensionale gradualisht do të zvogëlohen, nga shkaku që një pjesë e konsiderueshme e kontributeve, që do të paraqitet si tepricë e mjeteve në bilancin e Kolonës së Parë shtetërore, mund të shërbejnë për shlyerjen e borxhit i cili është shfrytëzuar për obligimet ndaj pensioneve dhe për obligimet e tjera në tranzicionin pensional.

3.4. Rreziku social ekonomik, ku kapitali njerëzor fizik nuk mund të tregtohet

Trendet ekonomike bashkëkohore kanë kryer analiza të ndryshme në lidhje me rrezikun social, i cili paraqitet si shkak i mostregtimit fizik. Analizat janë bërë në lloje dhe mënyra të ndryshme, mirëpo nëqoftëse do të kishte ekzistuar një lloj i tillë i tregtimit do të paraqiteshin shumë probleme ekonomike e sociale; por, gjithashtu edhe nuk do të ishte e nevojshme të krijohesh reforma e re e pensioneve. Kjo ishte edhe njëra nga dilemat kryesore në të cilën Republika e Maqedonisë gjatë fazës përgatitore për reformë pensionale e ka pasur të nevojshme që të konsultohet me ekspertë nga shtete të huaja, të cilët jo vetëm që e kanë aplikuar këtë lloj të sistemit pensional me vite të tëra, por njohuritë e tyre teorike dhe praktike si dhe eksperiencën e tyre e kanë transferuar edhe në shtete të tjera, të cilat e kanë pasur të domosdoshme të konsultohen me këta ekspertë dhe njëkohësisht kanë qenë pjesë në procedurën e aplikimit të sistemit pensional. Konsultantët e huaj pastruan dhe argumentuan dilemën se kapitali fizik njerëzor nuk mund të tregtohet. Ai mund të tregtohet vetëm përmes një arsyeje, e cila kupton që një treg bashkëkohor i përkryer do të ishte ai treg i cili siguron ekuilibrin e shpenzimeve me kapitalin financiar të tyre (Komiteti për reformë pensionale në Republikën e

Maqedonisë), P.sh. Një portfolio është e krijuar nga kursimet e personave fizik, të cilët kursimet e tyre që nga faza e parë e rritjes i investojnë në shoqëri investimi, por që në të ardhmen ato kursime shumëzohen deri në kohën e transferimit të tyre; kjo nënkupton kapital ngaqë ato kursime investohen në letra me vlerë, fletobligacione, depozita etj, të cilat edhe mund të sjellin rrezik në kohën e kthimit të tyre. Është e saktë se këtu bëhet fjalë për tregti, mirëpo këtu tregtohen vetëm kursimet e personave fizik dhe krijohet kapital dhe bie poshtë që personat fizik tregtohen dhe parandalojnë rrezikun social të sigurimit pensional, me funksionimin e kapitalit njerëzor, i cili do të tregtohej. Këtu flitet për aspektin e transferit të kontributeve, në të cilin është edhe i dizajnuar sistemi i ri pensional, ku pagesa e një tatimpaguesi do të shlyejë një pension të pleqërisë ose një pension të rëndomtë e këtu mund të themi se i përafrohet termi tregti, tregti kapitale njerëzore, por në aspektin e funksionimit të *Pay-As-You-Go* (kontribute-pension) e cila është në raport 1:1 dhe në kuptim të plotë mund të themi që krijohet ekonomia e tregut social e cila do të mbrojë rrezikun përmes tregtimit të kapitalit individual.

Duke e parë rrezikun nga aspekti social i kontribuar, në të cilin është paraparë reforma me kapitalin financiar të sigurimit pensional, këtu vjen në konsideratë përgjysmimi i rrezikut social, rrezik të cilin në vete do ta bartë Fondi i Sigurimit Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë - Kolona I-rë Pensionale dhe pjesa e dytë do t'i bartet si obligim Fondi për Sigurim Pensional me Kapital të Financuar – Kolona e II-të Pensionale, të cilën e menaxhojnë shoqëritë pensionale private në Republikën e Maqedonisë.

3.5. Institucionet e reformës pensionale me kapital financiar

Institucionet e sistemit të reformuar pensional me kapital financiar janë Agjencia për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, Depozitarët Bankarë dhe Fondi për Sigurim Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë.

3.5.1 Agjencioni për Supervizion i Kapitalit Financiar të Fondit Pensional

Është themeluar për të kryer supervizion në punën e shoqërive për udhëheqjen e fondeve pensionale dhe fondeve pensionale me qëllim që të mbrojnë interesat e anëtarëve të fondeve pensionale. Agjencia luan rolin e personit juridik dhe njëkohësisht është edhe trup rregullator që ka përgjegjësi për dhënien dhe tërheqjen e licencës për formimin e shoqërive, njëkohësisht mund të bëjnë edhe tërheqjen e licencës në fondet e obliguara pensionale dhe të atyre vullnetare, në rastet kur nuk e ndëshkojnë Ligjin dhe Rregulloren e Financimit Kapital të Sigurimit Pensional, Agjencia kryen supervisionin edhe të rojtarëve të pasurisë apo të bankës të cilët ruajnë pasurinë e fondeve të obliguara dhe atyre vullnetare. Agjencia promovon, organizon dhe nxit zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital të Republikës së Maqedonisë. Bashkëpunimi i Trupit Rregullator për Supervizion është i ndërsjellët me Ministrinë e Financave, Komisionin e Letrave me Vlerë me qëllimin që të sigurohet efikasiteti i sigurimit pensional. Rol tjetër i Agjencisë është të mbikëqyrë edhe raportin vjetor për gjendjen e Sistemit Pensional me Financim Kapital, me çka fitohet një transparencë në sigurimet pensionale të obliguara. Supervizioni është i nevojshëm për të mbikëqyrur ligjet dhe rregullat e sistemit pensional,

mbikëqyrje dhe vlerësim të punës si dhe propozim të akteve të përmbushjes në bazë të rregullave sociale dhe financiare. Supervizioni luan rolin preventiv të fondit pensional, por dhe mbron interesat e siguruesve të anëtarësuar në sistem.

Agjencioni për Supervizionin e Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional për punën e tij përgjigjet para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë si dhe për ndryshimet ligjore bashkëpunojnë me Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale dhe Ministrinë e Financave, ndërsa këshillin e ekspertëve e emëron me mandat 5-vjeçar Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Agjencia për Supervizionin e Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional është formuar si institucion që ka për obligim të sigurojë mirëqenien sociale e shoqërore të qytetarëve dhe që kanë varshmëri prej tyre. Shumë njerëz nuk u besojnë institucioneve si dhe organeve të tjera të shërbimeve publike. Ata dyshojnë për menaxherët që drejtojnë institucionet duke supozuar që këto institucione kanë për qëllim vetëm interesin vetjak të tyre dhe nuk kujdesen për mirëqenien e klientëve të tyre. Supervizorët janë themeluar pikërisht për pastrim të kësaj dileme, që edhe të sigurojnë se ata janë institucion i cili vepron në mënyrë të hapur dhe të ndershme duke i vendosur klientët në qendër të vëmendjes, që domethënë se sasia e investuar në kostot administrative dhe rekrutimi i personelit është i përshtatshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj dhe nuk e tejkalon masën. Kujdesi, të cilin e kryen Agjencia për përdorim të burimeve, është i vërtetë dhe është i dukshëm për të gjithë anëtarët. Kontrollon institucionin se sa i hapur është me strukturën, e cila është përgjegjëse për pagat e punëtorëve në shoqëri dhe për fonde pensionale, kujdes të veçantë i kushton rekrutimit të personelit dhe politikës së promovimit të shoqërisë si dhe bën kujdes edhe për të punësuarit dhe numrin e të punësuarve. Tek të punësuarit Agjencia verifikon edhe mënyrën se si menaxherët dhe shoqëria vlerësojnë personelin dhe se si i ngre në detyrë të punësuarit, verifikon mënyrën

e trajtimit të të punësuarve dhe kontrollon edhe vizitat studimore. Ajo çfarë është e rëndësishme tek Agjencia për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional është se gjatë punës në terren përveç se kontrollon llogaritë e anëtarëve dhe mbrojtjen e mjeteve të anëtarëve, kontrollon edhe strukturën organizative në përgjithësi si dhe vendimet për investime kapitale. Në shumë shtete të cilat e kanë reformuar sistemin pensional gjatë kryerjes së këtyre politikave kanë hartuar këtë lloj të kontrollit, mirëpo meqë është sistem i ri për funksionimin në kontinuitet po përmirësohet mënyra e kontrollit. Ky rast sjell nevojën për Këshillin e Ekspertëve që të punojnë intensivisht me homologët e tyre, me institucionet e tjera dhe në Qeveri me qëllim përmirësimin e standardeve në përgjithësi (*ONP-drejtimi i sigurimeve shoqërore: 83-84*).

Agjencia për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional kryen këto funksione:

- Licencon (jep të drejtën) shoqëritë pensionale për themelim;
- Tërheq licencën (të drejtën) e shoqërive pensionale në rast të ndëshkimit ligjor;
- Kryen supervizion të punës si dhe i kontrollon në mënyrë interne dhe eksterne shoqëritë pensionale;
- Kryen supervizion të personave juridikë dhe të depozitarit (bankës) të pasurisë i cili ruan dhe investon mjetet e fondit të obliguar pensional dhe atij vullnetar;
- Kryen promovimin dhe njohjen e opinionit dhe të rolit të shoqërive pensionale;
- Ngrit vetëdijen e anëtarëve për kapitalin financiar të fondit pensional;
- I dënon shoqëritë pensionale nëse shkelin ligjin dhe dëmtojnë anëtarët;
- Udhëheq regjistrin e agjentëve si dhe të anëtarëve;
- Kontrollon agjentët në teren;
- Mbikëqyr raportin financiar ditor;

- Bën vlerësim ditor të instrumenteve të investuara në tregun financiar vendor dhe në atë ndërkombëtar;
- Bashkëpunon me Fondin për Sigurim Pensional Invalidor në Republikën e Maqedonisë;
- Mbron të dhënat personale të anëtarëve në bazë të nevojës;
- Sjell ndryshime në Ligjin e Kapitalit Financiar të Fondit Pensional.

Supervizorët kanë parimet e tyre themelore për themelimin dhe për veprimtari të shoqërisë pensionale që janë shumë të rëndësishme: Banka duhet të posedojë proces për vlerësimin e kapitalit të duhur në profilet e rrezikut, banka duhet të posedojë strategji për mbajtjen e nivelit të tyre të kapitalit, supervizorët duhet të kontrollojnë dhe të bëjnë vlerësimet e brendshme për përshtatshmëri kapitale, për strategjitë e bankave dhe të shoqërive pensionale, gjë që nuk i lejon të marrin veprime e duhura nëse nuk janë të kënaqur me proceset, supervizorët presin që të operojnë mbi kapitalin minimal dhe kërkojnë nga kapitali, kapital mbi kapitalin, supervizorët kërkojnë të ndërhyhet te gabimet në fazën e hershme me qëllim që të parandalohet rënia e kapitalit (*Hall, 2012: 240-241*).

3.5.2 Depozitari bankar i mjeteve të fondit pensional privat

Depozitari i mjeteve dhe i kapitalit është institucioni financiar, të cilit i besohet përgjegjësia për ruajtjen e mjeteve të fondeve pensionale dhe detyrat e tyre janë të përcaktuara në Ligjin për Sigurim Pensional të Obliguar me Financim Kapital. Të gjitha instrumentet financiare dhe mjetet ku janë të investuara mjetet e sigurimit pensional, duhet të ruhen nga banka që luan rolin e depozitarit të pasurisë. Të drejtën për depozitar

të pasurisë e kanë bankat komerciale. Kjo e drejtë u jepet nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë.

Kushtet të cilat duhet të plotësohen për të fituar të drejtën për depozitar bankar të pasurisë së fondeve pensionale private janë:

- Të përmbushet minimumi i kapitalit vetanak në bazë të Ligjit për Kapital të Financuar,
- Të mos jenë aksionerë në menaxhimin e fondeve të shoqërisë, duke filluar nga të punësuarit e deri tek anëtarët e këshillit udhëheqës dhe mbikëqyrës nuk u lejohej të drejta familjare apo marrëdhënia e afërt me personat e shoqërisë.

Në fillim të reformës Banka Popullore ka kryer detyrën e shoqërisë pensionale të obliguar dhe të depozitarit të pasurisë deri në momentin kur janë licencuar shoqëritë pensionale për menaxhim të fondeve të obliguara dhe për menaxhim të fondeve vullnetare pensionale. Pastaj më vonë u licencuan bankat komerciale, të cilat do ta kryejnë detyrën e depozitarit të pasurisë. Shoqëria KB dhe NLB bëjnë përzgjedhjen e dy depozitarëve të ndryshëm të pasurisë që janë: Tutunska Banka dhe Banka Komerciale. Në rastin kur shoqëritë pensionale zotërojnë aksione dhe bono jashtë vendit atëherë banka ka të drejtë të autorizojë bankën në vend të huaj, që e quan sub-depozitarët, i cili kryen punën e depozitarit të pasurisë me qëllim të sigurimit të kapitalit dhe mbron rejtingun e kredisë.

Funksionet e depozitarit të pasurisë (bankës) janë:

- Të sigurojë ruajtjen e letrave me vlerë,
- Letrat me vlerë t'i mbajë në llogari të veçanta si depozita,
- T'i arkivojë dokumentet e shitblerjes nga llogaria bankare te fondi pensional,
- Të kryejë pagesën e kamatës dhe të dividendës,
- Të bashkëpunojë me sub-depozitarin e pasurisë,

- Të kryejë përlllogaritjen e tatimit dhe ta paguajë atë;

Vendi në cilin depozitari i pasurisë kapitale i tregon investimet janë:

- transaksione të tregut: blerja e aksioneve;
- blerje me ndërmjetësim: depozita në banka ose në ndërmjetësues financiarë, të cilët pastaj i investojnë mjetet;
- blerje të aksioneve dhe bono në tregun ndërkombëtar;
- financim i investimit të drejtpërdrejtë (*Po aty, 2013: 101*).

Depozitari i pasurisë është përgjegjës për dëmet që shkaktohen si pasojë e pakujdesisë dhe neglizhencës dhe përgjigjen para Agjencisë për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional, ku shkeljet ligjore dhe dëmet e të siguruarve gjobiten me gjoba të shumave të larta dhe po të njëjtat gjoba paguhen nga shoqëritë pensionale të fondit të obliguar dhe atij vullnetar. Depozitarët bankarë duhet të japin mundësi për organizim të sektorit financiar për sistem efikas kredidhënës. Investitorët financiarë duhet të jenë subjekte të cilave u nevojiten dhe i plotësojnë kushtet për kredi dhe kapital dhe të gjitha aktivitetet zhvillohen në bazë të konkurrencës stabile, infrastruktura e të cilëve është në përshtatshmëri me standardet ndërkombëtare.

3.5.3 Fondi për Sigurim Pensional Invalidor në Republikën e Maqedonisë (FSPIRM)

Të drejtën për pensionim e përcakton dhe e realizon Fondi për Sigurim Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë, por me reformimin e ri të sistemit pensional me kapital financiar, bazën e kontributet me vlerë prej 7% e transferon për sigurim pensional në fondin e obliguar të Kolonës II-të dhe për transferin e kontributeve-mjeteve e njofton

shoqërinë pensionale private përmes komunikimit elektronik, ndërsa pjesën tjetër të ngelur nga kontributet prej 14% e mban në llogaritë e buxhetit shtetëror. Pas procesit reformues, 1/3 e kontributeve të sigurimit pensional do të transferohet në llogarinë individuale të Kolonës II-të (ky transfer sigurisht që do t'i zvogëlojë të ardhurat në shtyllën shtetërore pensionale). Avantazh i Reformës është që 2/3 e pjesës së kontributeve të paguara mbetet në buxhetin e shtetit dhe pikërisht në Shtyllën I-rë Shtetërore të Fondit Pensional Invalidor në Republikën e Maqedonisë.

Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë ka përfituar funksionin e ri dhe shumë të rëndësishëm që në procedurën e vetme të grumbullojë dhe të shpërndajë kontributet e llogaritura, të njëjtat kontribute i kontrollon, ndërsa mjetet e paguara për kontribute i shpërndan veçmas për çdo të siguruar dhe për këtë mban evidencën përkatëse të pensionit.

Fondi korrespondon me të dhëna për çdo të siguruar nga faza e parë e punësimit përmes agjencisë për punësim deri te ndërprerja e punës. Fondi Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë posedon informacione të sakta për stazhin e sigurimit pensional dhe invalidor, për lartësinë e bazës së tij të sigurimit si dhe për kontributet e paguara. Ajo çfarë është e rëndësishme është që Fondi Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë në veprimtarinë e tij dhe në përgjegjësinë që ka ndaj anëtarëve, mban evidenca për të siguruarit lidhur me sigurimin e anëtarëve dhe me anëtarësimin në fonde private, për lartësinë e mjeteve të tyre të transferuara në fondin pensional privat ku edhe vetë i siguruari është anëtar.

3.5.4 Ministria për Punë dhe Politikë Sociale (MPPS)

Ministria për Punë dhe Politikë Sociale është obligues i shtetit, i cili paraqitet si bartës i sistemit pensional dhe që bart përgjegjësitë për krijimin e politikës së sigurimit invalidor dhe për kryerjen e mbikëqyrjes dhe kontrollit gjatë zbatimit të kësaj reforme të ndërmarrë. Ministria për Punë dhe Politikë Sociale kontrollon ligjshmëritë e Agjencisë për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional dhe Fondit për Sigurim Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë

3.5.5 Shoqërit Pensionale Private në Republikën e Maqedonisë

Nga shkak i kërkesës së madhe për hyrje në tregun financiar dhe shkak i një numri të madh të anëtarësimit të të siguarve në sistemin pensional të Republikës së Maqedonisë është e domosdoshme që të kufizohet hyrja në tregun pensional, nga shkak që është shumë ndjeshme pjesa e menaxhimit të mjeteve pensionale. Agjencia për Supervizion i Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional, shpall tenderin me ofertën e përcaktuar në bazë të kushteve legjislative të përcaktuara në Ligjin për Kapital Financiar të Fondit Pensional. Më datë 04.04.2005 Agjencia për Supervizion i Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional shpallë rezultatin e shoqërisë së licencuar për punë dhe hapjen e shoqërisë pensionale, e cila menaxhon kapitalin financiar të fondit pensional me çka fitues ishin dy shoqëri pensionale “FOND I RI PENSIONAL” dhe “KB FOND I PARË I HAPUR I OBLIGUAR PENSIONAL”, ku nga viti 2005 veprojnë dy shoqëritë e vetme pensionale të licencuara nga trupi rregullator MAPAS, që në të njëjtën kohë menaxhojnë fondin e detyrueshëm të kapitalit financiar të fondit pensional dhe fondin vullnetar të kapitalit financiar. NLB në

themelim ka 51% të aksioneve në Republikën e Sllovenisë dhe 49% Tutunska Banka Shkup me vlerë prej 2.000.000 euro. KB në themelim 51% të aksioneve i posedon Republika e Sllovenisë dhe 49% i posedon Banka Komerciale Shkup, e cila në themelim kishte 1.800.000 Euro.

Agjencia për Supervizion i Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional përveç se i licencon shoqëritë pensionale që nga themelimi i tyre, gjithashtu luan rol vendimmarrës edhe në ndryshimet e aksionerëve, tek anëtarët e këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës. Një shoqëri pensionale e ka të ndarë në nëndegë menaxhimin e fondit pensional dhe secilën degë e quan shoqëri në vete.

Ekzistojnë dy lloje të shoqërive pensionale private: Shoqëria për udhëheqjen me fondet pensionale të obliguara, ku themeluese janë institucionet financiare me kapital të cilat udhëheqin me mjetet e fondeve pensionale të obliguara. Shoqëria për udhëheqjen në fondet pensionale vullnetare - udhëheq me mjetet e fondeve financiare vullnetare. Shoqëria për udhëheqjen me fonde pensionale të obliguara dhe vullnetare-udhëhiqet me mjetet e fondeve të obliguara dhe atyre vullnetare.

Tabela nr. 2 Shoqëritë pensionale private në Republikën e Maqedonisë

Shoqëria e cila udhëheq fondet pensionale	Shoqëria aksionare e cila udhëheq fondet pensionale “Fondi pensional NOV” Shkup	KB shoqëria e parë për menaxhim të fondeve pensionale A.D. Shkupë
Fondi pensional	Fondi pensional NOV- fond i hapur pensional	KB fondë i parë i hapur pensional – Shkupë
Themelues	Tutunska banka , AĐ, Shkupë, R e M-së dhe Banka e Re e Lubljanës, DD, Republika e Sllovenisë	Banka Komerciale, AD, Shkup, R e M-së dhe shoqëria e parë , DD, Ljubjanë, Republika e Sllovenisë

Burimi: www.mapas.gov.mk

Që të jetë një institucion i qëndrueshëm pensioni, janë paraparë disa kritere: baza e parave, e cila është 1.500.000 Euro në kundërvlerë të denarit në bazë të kursit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, shoqëria e cila menaxhon vetëm fondet vullnetare duhet të posedojë bazën minimale 500.000 euro në kundërvlerë të denarit³. Në rast të rritjes së vlerës bazë, shoqëria që menaxhon fondet duhet të informojë Agjencinë për supervizion të kapitalit financiar të sigurimit pensional me qëllim të respektimit të ligjit. Kjo paguhet vetëm në formë të parave me qëllim që të rritet fuqia financiare e fondeve pensionale. Shoqëria pensionale është e obliguar që në çdo kohë të mbajë rezervën e detyrueshme të përcaktuar me ligjë, e cila është gjysma e bazës së formuar që nënkupton 50% të vlerës totale të mjeteve të grumbulluara. Qëllimi kryesor i themeluesit të fondit pensional është të sigurojë dhe të ofrojë menaxhim të fondit të obliguar pensional kapital financiar, fondit vullnetar të kapitalit financiar si dhe menaxher me të cilin udhëhiqen shoqëritë pensionale. Në bazë të Ligjit për Kapital Financiar të Fondit Pensional, personat fizikë nuk kanë të drejtë të jenë themelues, ndërsa personat juridikë kanë të drejtën ligjore të jenë pjesë themelore dhe themeluese mund të jenë persona juridikë të vendit dhe të huaj (*Po aty*, 29.).

Kushtet e themeluesit të shoqërisë pensionale private janë:

- Themeluesi, i cili ka 51% të bazës financiare duhet të jetë banka, shoqëritë që udhëheqin fondet investive, shoqëritë e huaja, të cilat udhëheqin fondet pensionale private, shoqëritë pensionale, institucionet financiare etj;
- Në bazën financiare duhet të posedojë më së paku 2.000.000 Euro në kundërvlerë të denarit në bazë të kursit të valutës kombëtare të përcaktuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë;

³ Valuta kombëtare e Republikës së Maqedonisë-autorja V.S-A.

- Të ekzistojë më së paku 3 vite;
- Të jetë në kontinuitet me punën e shoqërive pensionale në Republikën e Maqedonisë dhe të jetë fleksibil në tregë;
- Të posedojë një grup të menaxherëve të kompletuar dhe persona të profesionalizuar dhe me përvojë në institucione financiare dhe në shoqëri pensionale.

Me plotësimin e këtyre kushteve ligjore shoqëria pensionale fiton të drejtën e veprimtarisë dhe i jepet licenca e menaxhimit të fondit pensional të obliguar dhe atij vullnetar. Fondet e obliguara pensionale kanë të drejtë të bashkohen me një fond tjetër pensional të po të njëjtit lloj, me qëllim që të krijojnë konkurrencë në tregun pensional. Të drejtën për t'u bashkuar fondet pensionale njëri me tjetrin ia jep Agjencia për Supervizion i Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional me qëllim që të sigurojë ndryshimet e aksionerëve dhe të mbikëqyrë plotësimin e kushteve për aksionerë dhe mbrojtjen e anëtarëve të anëtarësuar në fondin pensional të obliguar. Në këtë rast Agjencia luan rolin preventiv edhe të të siguruarve, por edhe të shoqërisë pensionale në përgjithësi.

Shoqëria mban përgjegjësi para anëtarëve të saj në detyrimet e anëtarëve, informimin e tyre, në dëmet që shkaktohen si rezultat i mospërbushjes së detyrimeve ligjore dhe kontraktuale. Fondi menaxhues i shoqërisë pensionale është i obliguar që mjetet e fondit pensional të krijuar nga kontributet e anëtarëve të obliguar me kapital të financuar dhe vullnetar t'i investojë në pajtim me dispozitat ligjore dhe në pajtim me strategjinë investuese, me qëllim të realizimit të kontributit më të lartë në dobi të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit të detyrueshëm pensional dhe të mundësojë analizë të detajuar financiare, por edhe të minimizojë rrezikun nga faza e falimentimit të shoqërisë

pensionale (*Po aty*, 32). Në përgjegjësitë e shoqërive pensionale private ekziston frika nga rreziku i cili ka mundësi të paraqitet në shoqëritë pensionale private si shkak i mospagesës së pensionit nga pala kontraktuese, jostabiliteti i tregut financiar vendor dhe atij ndërkombëtar, rrezik i cili paraqitet nga vlera reale e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional si shkak i inflacionit dhe nga shitja e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional për sigurimin e likuiditetit të fondit të detyrueshëm pensional.

Shoqëria pensionale ka për detyrë të mbajë evidencë të saktë për anëtarët e siguruar, për anëtarët vullnetarë dhe për skemën e krijuar vullnetare nga ana e punëdhënësit me qëllim investimin e mjeteve dhe sigurimin e pleqërisë si edhe për tërheqjen e pensionit nga të tri kolonat ose për pension të kombinuar në këto tri kolona.

Shoqëria pensionale është e obliguar t'i arkivojë dhe t'i evidentojë këto të dhëna: Të dhënat nga anëtarët e mëparshëm: emri, mbiemri, adresa dhe numri amë si dhe shumën totale të mjeteve të grumbulluara deri në ditën që janë paguar kontribute për të siguruarin; Ta informojë të siguruarin për të gjitha instrumentet dhe aksionet e blera dhe të shitura me të cilat menaxhon fondi pensional, si dhe për realizimin e tyre dhe për periudhën kohore të realizimit; Shoqëria pensionale ka për detyrë që në çdo kohë t'i bëjë ftesë të siguruarve për t'i ripërsëritur të dhënat e tyre; Shoqëria pensionale ka për detyrë që të siguruarve t'u sigurojë mbrojtjen e të dhënave personale në bazë të ligjit për të dhëna personale.

Të siguruarve dhe anëtarëve në fondin pensional të obliguar dhe atij vullnetar iu jepet mundësia t'i shohin rezultatet e fondit në bazë të të hyrave të fondit që përlllogariten nga vlera totale vjetore. Shoqëria pensionale është e obliguar të autorizojë të punësuar që do të kryejnë revizion intern (të brendshëm), të cilët për punën e tyre të përditshme të bëjnë kontroll të ligjit me qëllim mbrojtjen paraprake para ndëshkimit të ligjit, punën e

përditshme të shoqërisë pensionale, mbrojtjen e të dhënave personale të të sigurve dhe anëtarëve etj. Obligimi vjen për shkak të penalteteve dhe gjobave me shuma të larta nga Agjencia për Supervizion e Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional. Këshilli drejtues i ekspertëve të shoqërive pensionale është përgjegjës për strukturën organizative të shoqërisë pensionale si dhe për përcaktimin e mënyrës më të mirë të mundshme për të udhëhequr. Këshilli drejtues përcakton mënyrën e udhëheqjes, procedurat, personat e autorizuar dhe të emëruar për udhëheqje si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë implementimit të detyrës së dhënë.

Qëllimi kryesor për udhëheqje kooperative është përgjegjësia, transparenca si dhe besimi ndërmjet subjekteve mbikëqyrëse si dhe arritja e efikasitetit të fondit pensional. Personat e autorizuar për mbikëqyrje dhe udhëheqje të fondit nga ana e përzgjedhur e këshillit të ekspertëve duhet ta kuptojnë rolin dhe rëndësinë gjatë kryerjes së obligimeve të ngarkuara, me qëllim sigurimin e efikasitetit të procesit të punës dhe të arritjes së suksesshme gjatë revizionit të brendshëm (intern) dhe atij të jashtëm (ekstern). Këshilli i ekspertëve duhet të koeprojë me sukses në fushën e konkurrencës lojale dhe të ketë krijuar politikë lojale brenda shoqërisë pensionale. Kooperimi më i mirë i mundshëm do të ishte vlerësimi dhe matja e drejtë e rreziqeve të punës te Fondi i Sigurimit Pensional me të cilët njëherit edhe do të ketë efikasitet më të lartë (*Po aty*, 33).

3.5.5.1 Fondi Pensional i Obliguar dhe Fondi Pensional Vullnetar

Fondet pensionale e kanë të përcaktuar statusin e tyre, gjë të cilën e përcakton Agjencia për Supervizion e Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe si trup rregullator që ka të përcaktuar ligjshmëritë e funksionimit dhe të veprimtarisë së shoqërive pensionale.

Parë nga llojshmëria ekzistojnë dy lloje të fondeve private pensionale:

1. Fondi pensional i obliguar dhe
2. Fondi pensional vullnetar.

3.5.5.1.1. Fondi Pensional i Obliguar

Fondi pensional i obliguar është themeluar dhe udhëhequr nga shoqëria pensionale që përfaqëson fond të obliguar të personave të tretë. Fondet pensionale të obliguara me kapital financiar pensional dhe invalidor menaxhojnë kapitalin financiar, i cili dallon në mënyrë radikale nga sistemi i tranzicionit pensional me financim ditor për sa i përket aspektit të evidentimit të kontributeve të paguara, por edhe për mënyrën dhe vlerën e pagesës së pensionit. (Raport i kapitalit financiar të sigurimit pensional: 2013: Agjencia për supervizion i kapitalit financiar të sigurimit pensional) Fondi pensional i obliguar me kapital financiar menaxhon mjetet e grumbulluara të anëtarëve dhe pensionet e anëtarëve që do të realizohen në të ardhmen (Po aty.).

I siguruari mund të anëtarësohet në dy mënyra në fondin e obliguar pensional:

- me nënshkrim të kontratës për anëtarësim në fondet e obliguara pensionale;
- me zgjedhje të rastësishme nga ana e Agjencisë për supervizion të kapitalit financiar të sigurimit pensional, ku i siguruari në periudhën prej 90 ditësh nuk bën përzgjedhjen e anëtarësimit në fondin pensional, atëherë e përcakton fondin agjencia

përmes zgjedhjes së rastësishme. Kjo mënyrë përdoret me qëllim që të sigurohet investimi i mjeteve të të siguruarve dhe shumëzimi i mjeteve për këtë kohë (*Po aty*, 43).

Marrëveshja për anëtarësim duhet të jetë e përpiluar dhe e nënshkruar në formë standarde ku shoqëria përcakton një shifër prej 9 numrash ku 2 numra prej shifrave të para i përcakton agjencia. Në rast të mospërmbushjes së këtyre kushteve, atëherë ky lloj i kontratës është i pavlefshëm. Kontrata duhet të jetë e nënshkruar nga vetë anëtari përmes agjentit të shoqërisë ku detyra e agjentit është të kontrollojë identitetin dhe një dokument identifikues të anëtarit. Në kontratë shkruhet data, muaji dhe viti dhe do të nënshkruhen dy kopje, ku njëra i jepet anëtarit e tjetra mbetet në fond. Në rastet kur i siguruari ka nënshkruar kontratë anëtarësimi në fondin e obliguar pensional, ai ka të drejtë për ndërprerje të kontratës në afatin prej 90 ditësh. Në këtë rast anëtari nënshkruan dy kopje për ndërprerje të kontratës te fondi dhe fondi pensional e informon Agjencinë për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional. Egziston mundësia kur anëtari dëshiron të transferohet nga njëri fond pensional në tjetrin fond, atëherë ai shtron kërkesë deri tek fondi ku është përcaktuar për të qenë pjesë e anëtarësisë, nënshkruan kontratën për anëtarësim vetëm me procedurë të transferit nga fondi tjetër dhe për obligim ka që fondi i obliguar ta informojë agjencinë MAPAS për transferimin e anëtarit nga njëri fond në tjetrin. Agjencia MAPAS në afat prej 8 ditësh informon anëtarin për transferin e tij dhe e njofton për kushtin e radhës, që në afat prej 24 muajve nuk ka të drejtë të kthehet në fondin tjetër dhe që i ndalohet e drejta për transfer në këtë periudhë, gjithashtu për kontributet e grumbulluara dhe për kompensimin e këtyre mjeteve kujdeset agjencia ku në rast transferi i transferon edhe mjetet. Që nga momenti kur i siguruari nënshkruan kontratë për anëtarësim në regjistrin e Agjencisë ai paraqitet si anëtar, një herë ka të drejtë të kryejë transfer në mes të fondeve për shkak se mund të vijë në konsideratë humbja e të

dhënave dhe eliminimi i mjeteve të grumbulluara dhe agjencia si supervizor ka të drejtë ta ndëshkojë dhe ta largojë të siguarin nga libri i regjistrit të të siguarve. Në rastin kur i siguari nënshkruan kontratën e anëtarësimit dhe nuk ka ndryshuar fondet nga njëri tek tjetri. Gjatë kontrollit të përditshëm nga agjencia, shohim që i siguari ende është aktiv në po të njëjtin fond dhe figuron si sigures (*Po aty, 44-45*).

Përderisa Agjencia luan rolin mbrojtës të anëtarëve, fondet pensionale do të ndëshkohen me ligjë dhe do të sanksionohen në qoftë se kanë kryer anëtarësim pa i informuar të siguarit dhe kanë plotësuar formularë kontrate pa praninë e të siguarit, me të dhëna jo të sakta.

Anëtarësimi në Fondin e Obliguar Financiar Kapital të Sigurimit Pensional është i obliguar nga shkaku që një numër i konsiderueshëm i të punësuarve nuk do të mund të krijojnë një fond individual ku do t'i investojnë kontributet e tyre në para të kursyera. Për atë edhe ekspertë të huaj dhe komiteti për reformë kanë propozuar që me reformën e sistemit pensional me automatizëm të anëtarësohen të punësuarit, të cilëve do t'iu sigurohet kursim i kombinuar në pleqëri nga dy sektorët: nga ai shtetërorë dhe nga ai privatë. Kjo mënyrë e funksionimit të sigurimit pensional social është e arsyeshme jo për përgjegjësinë e popullatës ose mosinformimin e anëtarëve për përparësitë e sistemit të reformuar, por pikërisht për të ardhurat individuale dhe pagës së paguar. Këtë mënyrë të funksionimit do ta zbatonte çdo shtetë nga shkaku që mbrohen të tria palët, nga njëra anë mbron kursimet e anëtarëve me qëllim të sigurimit të pensionit shtesë të pleqërisë, në anën tjetër mbrohen interesat e shoqërive pensionale private dhe pala e tretë, shteti, të cilët në vazhdimësi përfitojnë nga dividenda e shoqërisë pensionale private, nga tregtimi i letrave me vlerë, aksionet, letra me vlerë të tregut ndërkombëtar si dhe përfiton nga zgjerimi i tregut të kapitalit (*Po aty, 48*). Mjetet e grumbulluara në Kolonën e II-të

Pensionale të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional nuk mund të shfrytëzohen deri në momentin e përfitimit të statusit pensionist. Shoqëria e sigurimit dhe shoqëria pensionale, pensionin e Kolonës II-të e paguan vetëm me shfrytëzimin e një prej llojeve të pagesës në vijim, me zgjedhje të anëtarit të fondit pensional.

Është shumë i rëndësishëm ky lloj i kursimit pensional nga shkak që një lloj i kursit të tillë është kursim afatgjatë dhe në kontinutet rriten kursimet për shkak se anëtari, kur është në moshën e re, kursimet janë më të ulëta, ndërsa në moshë më të mplakur ose të përafruar të pensionit, kursimet rriten (*Raport i kapitalit financiar të sigurimit pensional: 2013: MAPAS*).

Tipologjia e pagesës së pensioneve në shtyllën II:

- Anuitet i drejtpërdrejtë i përhershëm;
- Tërheqje e programuar;
- Tërheqje e programuar e përkohshme në kombinim me anuitet të prolonguar të përhershëm (*Po aty.*).

Polisa për anuitet është marrëveshje e pashkëputur, shoqëria e sigurimit nuk ka të drejtë të ndërpresë polisën për anuitet edhe në rast të pëlqimit nga shfrytëzuesi i pensionit (*Po aty, neni 41*). Shfrytëzuesi i pensionit mund ta zëvendësojë tërheqjen e përhershme të programuar, të siguruar nga një shoqëri pensionale dhe me shfrytëzimin e mjeteve të mbetura në disponim nga llogaria individuale, për blerjen e tërheqjeve të përhershme të programuar nga shoqëria tjetër pensionale, kryen blerjen e anuitetit të përhershëm nga shoqëria e sigurimit ose blerjen e tërheqjeve të përkohshme të programuar dhe të kombinuar me anuitet të përhershëm e të prolonguar (*Po aty, Neni 42*).

Në rastet kur shfrytëzuesi i pensionit ka përcaktuar tërheqje të programuar në kombinim me anuitet të përhershëm të prolonguar, në çdo moment ka të drejtë të

zëvendësojë tërheqjen e përkohshme të programuar të siguruar nga një shoqëri pensionale, me shfrytëzimin e mjeteve të mbetura në disponim nga llogaria individuale me qëllim të blerjes së tërheqjes së përkohshme të programuar nga shoqëria tjetër pensionale për periudhën e mbetur (*Po aty*, 43).

- Anuitet i garantuar është një lloj i pensionit, të cilin i siguruari e shfrytëzon deri në vdekje dhe pas vdekjes së tij, pensionin për periudhën e garantuar të anuitetit e shfrytëzojnë trashëgimtarët; kohëzgjatja e këtij lloj pensioni është deri në 240 muaj ose 20 vite pension (*Po aty*, neni 5);

- Anuitet fiks i harmonizuar me shpenzime për jetesë- shoqëria e sigurimit është e obliguar të bëjë harmonizimin periodik të lartësisë së pensionit me anuitet fiksë të harmonizuar me shpenzime për jetesë përmes dy mënyrave;

- Anuitet i caktuar sipas rritjes së indeksit të shpenzimeve për jetesë, në gjysmëvjetorin paraprak në raport me gjysmëvjetorin që i paraprin indeksit të shpenzimeve në Republikën e Maqedonisë, 1 Janar dhe 1 Korrik;

- Harmonizim nominal fiks, i përcaktuar nga Agjencia për Supervizion të Sigurimeve me pëlqim të Agjencisë për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional, ku përcaktohet përqindja minimale e harmonizimit nominal për anuitet fiksë të cilët do të shiten vitin e ardhshëm. Përqindja e harmonizimit caktohet në ditën e blerjes së polisës për anuitet dhe është e pandryshueshme gjatë kohëzgjatjes së polisës (*Po aty*, neni 6);

- Poliset për anuitet në Kolonën e II-të shiten nga Shoqëria e Sigurimit përmes përfaqësuesit në sigurim, shoqëria për përfaqësim në sigurim dhe prej shoqërisë brokere të sigurimit. Të gjitha shoqëritë nuk posedojnë të drejtën ligjore që t'i kthejnë kapitalin në para. Shumën për provizion të anuitetit e cakton shoqëria e sigurimit pensional përmes

tabelës së vdekshmërisë. Si parakusht në këtë tabelë është shkalla e lartë e kamatës, shpenzimet për menaxhim etj (*Po aty, neni 9*);

- Për lartësinë e pensionit përmes anuitetit fiks me pjesëmarrje në fitim, shoqëria e sigurimit është e obliguar që gjatë përlllogaritjes së pensionit me anuitet fiks të shfrytëzojë stimuj dhe projeksione me parametra të lejuar. Agjencia për Supervizion i Sigurimeve me pëlqim, i Agjencisë për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional, cakton parametrat e lejuar duke pasur parasysh përqindjen e pjesëmarrjes në fitim, të ardhurat, si edhe ndërmjetësuesit (*Po aty, neni 11*).

Kapitali Financiar i Sigurimit Pensional me tërheqje të pensionit të programuar ofron këto lloje të pensionit: Tërheqje e programuar e përhershme, produkt i pavarur; Tërheqje e programuar e përkohshme, kombinim i anuitetit të prolonguar nga shoqëria pensionale (*Po aty, neni 14*).

Shoqëria pensionale gjatë përlllogaritjes së shumës pensionale i shfrytëzon këto parametra si:

- shumën e përgjithshme të mjeteve në llogarinë individuale;
- faktorin e anuitetit për pension individual;
- moshën e shfrytëzuesit të pensionit dhe shkallën e tregut të të ardhurave (*Po aty, neni 16.2*).

Gjatë rillogaritjes në rast nevojë ose në rast kërkesë nga anëtar, shoqëria pensionale është e obliguar t'i shfrytëzojë këto parametra:

- shumën e re të mjeteve në llogari individuale;
- faktorin e ri të anuitetit për pension individual;
- moshën e re të shfrytëzuesit të pensionit dhe kushtet e reja për shkallën e tregut të të ardhurave.

$$Pension_t = (shuma_e\ përgjithshme_t / Njësia_t) / 12$$

Ku:

Shuma_e përgjithshme_t= shuma e përgjithshme e mjeteve në llogarinë individuale të shfrytëzuesit të pensionit në muajin t.

Njësia_t= kapitali i nevojshëm për njësinë e pensionit në muajin t.

Pensioni_t= pension mujor që paguhet nga muaji t deri në muajin t+11. (Po aty, neni 16.2).

Llogaritja e pensionit mujor përmes tërheqjes së programuar të përhershme për muajin t, paguhet gjatë 12 muajve të rregullt dhe bazohet në pjesëtimin e shumës së përgjithshme të mjeteve në llogarinë individuale të shfrytëzuesit të pensionit me faktorin që paraqet kapitali i nevojshëm për njësinë e pensionit dhe kjo shumë pjesëtohet me 12 muaj (*Po aty*).

Pension i kombinuar i tërheqjes së programuar të përkohshme dhe anuitet i prolonguar i përhershëm. Shoqëria pensionale gjatë vlerësimit të pensionit kontrollon shumën e pensionit të përcaktuar përmes tërheqjes së programuar të përkohshme të pensionit të Kolonës I-rë nga shkak që vlera e pensionit nuk ka të drejtë të jetë më e ulët se pensioni minimal i përcaktuar me ligj (*Po aty, neni 20*).

Pensionisti ka të drejtë t'i shfrytëzojë mjetet e akumuluar në llogarinë individuale për tërheqje të dy pensione në kombinim:

- tërheqja e programuar e përkohshme dhe
- anuitet i prolonguar i përhershëm.

Mjetet e pensionit të tërheqjes së programuar të përkohshme dhe shumës së pensionit përmes anuitetit të prolonguar caktohen përmes kuotimit për anuitete nga ana e shoqërisë së sigurimit duke pasur parasysh shumën e përgjithshme të mjeteve në llogarinë

individuale, kohëzgjatjen e periudhës së prolongimit dhe të niveleve relative të të dyja pensioneve. Shoqëria e sigurimit pas kuotimit ofron oferta të caktuara për shoqëritë pensionale, nga e cila mund të sigurohet tërheqja e programuar e përkohshme (*Po aty*).

3.5.5.1.2. Fondi Pensional Vullnetar

Fondi Pensional Vullnetar me Financim Kapital paraqet sigurim pensional në bazë vullnetare të financuar në kapitalizimin e mjeteve. Në këtë sigurim përfshihen persona që nuk janë përfshirë në sigurimin e obliguar pensional dhe persona që janë përfshirë në sigurimit pensional me kapital financiar, me qëllim realizimin e të hyrave plotësuese. Në fondet pensionale vullnetare paguhen kontribute vullnetare nga persona punëdhënës dhe shoqata të qytetarëve që do të zgjedhin për të kontribuar në këto fonde pensionale, mjetet e të cilëve investohen dhe shpërndahen në pajtim me ligjin.

Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare themelohet Shoqëria Pensionale në bazë të licencuar nga Agjencia për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional dhe pas themelimit merr licencën për udhëheqje me Fondin Pensional Vullnetar. Në regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë kryhet regjistrimi i shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare. Në Agjencinë për Supervizion Kapital të Sigurimit Pensional dorëzohet dokumentacioni i shënuar me nr. 39 dhe Plani Afaristë, i cili përmban hollësitë për të gjithë kompensimet dhe provizionet që do të arkëtohen në pajtim me ligjin për kapital financiar të sigurimit pensional vullnetar.

Fondi Pensional Vullnetar është i themeluar dhe i udhëhequr nga Shoqëria Pensionale e cila përfaqëson Fondin Vullnetar Pensional të personave të tretë. Anëtar në Fondin Vullnetar Pensional ka të drejtë anëtarësimi çdo person që ka mbushur 15 vite moshë, që ka të hapur xhirollogari individuale pensionale, përveç personave me moshë

mbi 70 vjeç që nuk kanë të drejtë anëtarësimi. Një anëtar mund të jetë aktiv vetëm me një xhirollogari individuale pensionale dhe me një xhirollogari profesionale përmes skemës profesionale, e cila është aktive nga momenti që paguhen kontributet.

Fondet Pensionale Vullnetare i menaxhon shoqëria pensionale, shoqëria për udhëheqje me Fondet Pensionale Vullnetare është shoqëri aksionare që është e themeluar dhe e autorizuar që të udhëheqë fondin pensional vullnetar. Veprimtaria e vetme e shoqërisë për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare është udhëheqja me fonde pensionale vullnetare, me përfaqësim para personave të tretë si dhe me veprimtari të tjera të lidhura me udhëheqjen e fondeve pensionale. Shoqëritë e Fondeve Private Vullnetare janë përgjegjëse para anëtarëve të Fondit Pensional Vullnetar për dëmet që shkaktohen si rezultat e moskryerjes së rregullt ose kryerjes së obligimit në mënyrë të papërgjegjshme, si p.sh. të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara në Rregulloren e Punës. Përgjegjësia e Shoqërisë Pensionale paraqitet në rastet kur kemi rezultate të dobëta ose jopërkatëse, kështu që këto rezultate i përkasin rrethanave në të cilat shoqëria nuk ka mundur të ndryshojë mënyrën e menaxhimit.

Anëtarësimi në Fondin Vullnetar kryhet me ndërmjetësimin e agjentit të licencuar. Agjenti i shoqërisë pensionale private para personit fizik parashtron kushtet e anëtarësimit, promovon produktin e shoqërisë pensionale, bën shpjegimin e avantazhit pensional dhe është përpikshëmrisht i obliguar të bëjë shpjegimin dhe mënyrën nga faza e anëtarësimit e deri në fazën e fundit të pensionimit. Anëtari duhet të posedojë dokument identifikimi, ndërsa agjenti duhet të ketë dy kopje të kontratës dhe numrin e kontratës të cilin e cakton shoqëria, ku dy prej tyre i cakton Agjencia për supervizion i kapitalit financiar të sigurimit pensional. Në rastet kur anëtari i njëjtë, me të dhëna të njëjta është

anëtar i dy shoqërive pensionale private, atëherë merret në konsideratë data e parë e anëtarësimit.

Mashtrime të shumta mund të ndodhin nga agjentët e shoqërisë pensionale për qëllime personale përfituese, mirëpo në vazhdimësi agjentët e shoqërive pensionale kontrollohen në teren nga Agjencia për Supervizion i Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional dhe ndëshkohen sipas Ligjit për Larjen e Parave në Republikës e Maqedonisë.

Shoqëritë Pensionale Private janë të obliguara t'i trajnojnë agjentët e tyre në teren dhe t'i këshillojnë për mënyrën e drejtë të kontraktimit, ndërsa një mënyrë tjetër këshilluese duhet të bëhet edhe për ruajtjen e të dhënave personale të anëtarëve si dhe për anëtarësimin e anëtarëve të rrejshëm, me të dhëna jo të sakta që janë anëtarësuar nga persona të tretë. Në rast se i siguruari nuk dëshiron të anëtarësohet përmes agjentit, sepse ka humbur besimin dhe për shkak të keqpërdorimit të të dhënave, ai ka të drejtë që anëtarësimin ta kryejë në hapësirën e bankës rojtare dhe në fondin pensional.

Fondi Pensional Vullnetar funksionon me standard ndërkombëtar sepse mjetet e grumbulluara nga Kolona II-të dhe Kolona e III-të Pensionale mund të ruhen përveçse në Republikën e Maqedonisë edhe në shtete të tjera.

Evidentimin për anëtarët e Fondit Pensional Vullnetar e udhëheq Shoqëria Pensionale, e cila është e obliguar që në një afat prej 90 ditëve të dorëzojë listën e evidencës deri tek Agjencia për Supervizion i Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional, Agjencia grumbullon të dhënat e evidentuara, i kontrollon dhe në rast se anëtari i plotëson apo nuk i plotëson kushtet për anëtarësim është agjencia ajo që ka të drejtë të bëjë shlyerjen e anëtarëve në rast se anëtari është i vdekur, është mbi 70 vjeç, ka më pak se 15 vite, është i pensionuar etj.

Funksionet kryesore në të cilën kryhen investimet pensionale vullnetare me kapital financiar janë:

- Siguria e mjeteve plotësuese në rast pleqërie;
- Anëtarësimi në fondin pensional vullnetar në bazë vullnetare;
- Sigurimi pensional vullnetar me financim kapital, i bazuar në kontributet e caktuara, ndërsa kompensimet kanë varësi prej kontributeve të paguara dhe prej shtimit të tyre;
- Siguria e mjeteve për sigurim material të anëtarëve duke shtuar mjetet përmes investimit;
- Investimi i mjeteve në bazë të sigurisë, diversitetit të rrezikut dhe mbajtjes së likuiditetit të duhur.
- Gjatë investimit të fondeve pensionale duhet të rritet siguria dhe të mbahet likuiditeti i duhur i mjeteve si dhe investimi i tyre në instrumente të ndryshme me rrezik të ndryshëm;
- Transparencë, e cila anëtarët e fondeve pensionale pranojnë raporte të rregullta dhe të detajuara për mjetet e tyre.

Shoqëria Pensionale Private nuk ka të drejtë për t'i shfrytëzuar mjetet e anëtarëve, në këtë mënyrë: Shfrytëzim i mjeteve për fitim dhe marrje të aksioneve dhe letrave me vlerë ose depozitave në personat e tjerë juridikë, të drejtë fitimi kanë vetëm në bono shtetërore të emetuara nga Republika e Maqedonisë, Mjetet t'i jep hua dhe sigurim të garancës, përveç atyre që janë caktuar me ligjë; Mjetet e anëtarëve t'i merr dhe t'i jep për shfrytëzimin e kredive dhe për emetimin e obligacioneve, bonove në vlerë të përgjithshme, që e tejkalon përqindjen e caktuar nga kapitali i tyre; Blerjen dhe shitjen e letrave me vlerë, nëse me një tregti të tillë do të pamundësohet blerja dhe shitja e letrave me vlerë nga mjetet e

fondit pensional me të cilin udhëheq shoqëria; Shoqëria është e obliguar që të arkivojë dhe t'i ruajë të gjitha dokumentet dhe evidentimin e anëtarëve me të dhënat e anëtarëve; Evidencë për mjetet e blera dhe të shitura për fondin pensional, datën e transaksioneve, identitetin e palës kontraktuese dhe çmimin e realizuar; Shoqëria pensionale e cila menaxhon fondin vullnetar pensional është e obliguar të posedojë njësi të veçantë organizative për revizion të brendshëm. Njësia organizative kontrollon zbatimin e dispozitave, zbatimin e politikave dhe të procedurave të brendshme dhe kryen vlerësimin e efikasitetit të punës së përgjithshme, të punës së shoqërisë (*Ligji për kapital financiar të sigurimit pensional vullnetar, 07-115/1/2008, neni 20*); Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale vullnetare mund të bashkohet vetëm me shoqëri për udhëheqje me fonde pensionale vullnetare neni 52, me bashkimin e njërit fond me tjetrin fond pensional vullnetar, anëtarët me llogaritë e tyre individuale dhe llogaritë profesionale barten në fondin pensional në të cilin bashkohen (*Po aty, neni 39 dhe 52*); Të gjitha ndryshimet, duke filluar nga ndryshimet e aksioneve, anëtarëve të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës, personave përgjegjës ose ndryshimet dhe plotësimet e dokumenteve dhe të dhënave të shënuara i nënshtrohen pëlqimit paraprak nga ana e agjencisë MAPAS.

Tipologjia e kompensimit pensional vullnetar - shoqëria e sigurimit dhe shoqëria pensionale kompensimin pensional e paguan me shfrytëzimin e një prej këtyre llojeve të pagesave sipas zgjedhjes së anëtarit të fondit pensional: pagesë anuiteti; tërheqje e programuar; pagesë e shumëhershme dhe kombinim i tri rasteve të lartpërmendura. (*Po aty, 68*).

Ekzistojnë këto lloje të anuiteteve pensionale vullnetare: Anuitet individual dhe i përbashkët, Anuitet i përhershëm dhe i përkohshëm, Anuitet i drejtpërdrejtë dhe i

prolonguar, Anuitet me periudhë të garantuar dhe anuitet me periudhë jo të garantuar, Anuitetë fiks, i ndryshueshëm dhe anuitet fiks me pjesëmarrje në fitim (*Po aty, neni 52*).

Gjatë përcaktimit të shumës së kompensimit pensional të paguar përmes anuitetit variabël dhe atij fiks me pjesëmarrje në fitim, shfrytëzohen simulime, projeksione me parametra dhe parakushte të lejuara. Në këtë përllogaritje përfshihen kompensimet, provizionet dhe shpenzimet, të cilat janë të shënuara në polisën e të siguruarit (*Po aty, 58*). Shfrytëzuesi i pensionit në rast të kompensimit pensional të kombinuar vendos për sa lloje të kompensimeve pensionale do të ndahen mjetet nga llogaria e tij individuale dhe e cakton secilin nga llojet (*Po aty, neni 55*).

Polisat për anuitet për Kolonën e Tretë Pensionale Vullnetare i shesin shoqëritë e sigurimit, të njëjtat i shesin me ndërmjetësimin e përfaqësuesit në sigurim, shoqërisë për përfaqësim në sigurim dhe shoqërisë brokere. Gjatë shitjes së anuiteteve nuk lejohet të privilegjojnë anëtarët e fondit pensional përmes kanaleve të ndryshme të lidhjes (*libido aty*).

Pension i programuar i Kolonës së Tretë Pensionale- shoqëria pensionale i ofron këto lloje të pensionit të programuar: tërheqje e programuar e përhershme dhe tërheqje e programuar e përkohshme. Vlera e përllogaritjes nga shoqëria pensionale paguan kompensimin pensional përmes tërheqjes së programuar në bazë mujore përmes bartjes së mjeteve në llogari transaksioni, i cili është përcaktuar nga shfrytëzuesi i kompensimit pensional (*Po aty, 60*).

Anëtari i Fondit Pensional dorëzon kërkesë për marrjen e së drejtës së kompensimit pensional tek shoqëria pensionale që menaxhon me fondin pensional, ku ai posedon llogari individuale ose profesionale, nëse anëtari posedon llogari individuale vullnetare dhe profesionale ka të drejtë t'i bashkojë mjetet nga dy llogaritë dhe e drejta e anëtarit

është për t'i kuotuar mjetet ose për moskuotim. Në rastet kur mjetet nuk kuotohen, parashtrohet kërkesë në fondin pensional për pagesë të mjeteve përmes tërheqjes së programuar të njëhershme ose të shumëhershme (*Po aty, neni 73*).

Shoqëria Pensionale ka për obligim të kryejë transferin e kapitalit nga Shoqëria e Sigurimit në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së polisës për anuitet dhe marrëveshjes me shoqërinë pensionale. Shuma e mjeteve të grumbulluara ka raste edhe kur është më e lartë nga shuma e shfrytëzuar në kuotë, në ato raste anuiteti proporcionalisht rritet, ndërsa në rastet kur shuma e mjeteve të shfrytëzuar në kuotë është zvogëluar, atëherë anuiteti proporcionalisht zvogëlohet (*Po aty, neni 74*). Nëse anëtari i Fondit Pensional Privat nuk përcaktohet për llojin e kompensimit pensional, konsiderohet se ka përcaktuar pagesë të njëhershme nga shoqëria pensionale që menaxhon Fondin Pensional Privat ku anëtari posedon llogari individuale vullnetare dhe profesionale, ku pagesa kryhet në llogarinë e tij të transaksionit (*Po aty, neni 73*)

Shoqëritë për udhëheqje me fonde pensionale të obliguara dhe vullnetare, për t'u bashkuar duhet të posedojnë këto dokumente:

- Vendimin nga bashkimi i dy fondeve, vendim i marrë nga organi kompetent i secilit nga shoqëritë;
- Marrëveshje për t'u bashkuar me shoqëritë pensionale private;
- Plan organizativ dhe financiar për implementimin e shoqërisë së re;
- Emërtimi i shoqërisë së re;
- Informacione për aksionarët;
- Dokument për gjendjen financiare të aksionarëve;
- Prospekt i reviduar informativ për fondet e reja;

- Projektstatutin e fondeve të reja pensionale në të cilin janë paraqitur kompensimet;
- Emrat e propozuar për anëtarët e këshillit administrativ dhe mbikëqyrës;
- Program për strategjinë investuese të fondeve të reja pensionale (*Po aty, neni 52*).

3.5.5.2. Skema Pensionale Profesionale

Ky trend i skemës profesionale pensionale është mjaft i përhapur, por më shumë te firmat private, bizneset familjare dhe organizata të ndryshme joqeveritare. Në shumë shtete ka ekzistuar skema pensionale profesionale, edhe në Republikën e Maqedonisë me reformën e re pensionale është përcaktuar ky lloj i pagesës së kontributeve shtesë, që janë shumë të rëndësishme edhe për të siguruarit, por edhe për shoqërinë (*Po aty, 58*). Punëdhënësi mund të organizojë dhe të financojë skemën pensionale profesionale vetëm për të punësuarit e tij, siguruesi nënshkruan marrëveshje për organizimin dhe financimin e skemës pensionale profesionale me anëtarët e tij dhe pastaj nënshkruan marrëveshje me shoqërinë që do të udhëheqë me fondin pensional vullnetar. (*Ligji për Kapital Financiar të Sigurimit Pensional Vullnetar: 07-115/1/2008: neni 84*). Punëdhënësi i paguan kontribut shtesë të punësuarve me krijimin e skemës profesionale që në të ardhmen apo në kohën e pensionimit, pensionistët do të tërheqin pension nga tri kolona pensionale apo do të tërheqin pensionin e kombinuar treshtyllor. Pagesa e kontributeve vullnetare në fondin pensional nuk lejon të kryhet pagesë në emër dhe për llogari të personit, i cili ka realizuar të drejtën e pensionit të pleqërisë ose invaliditetit. (*Po aty.*)

Ajo çfarë është e rëndësishme është që punëdhënësi nuk është i obliguar të krijojë skemë pensionale për të punësuarit dhe të paguajë kontribut mujor, por ajo është nga

vetëvullneti dhe dëshira e tij, norma e kthimit të këtyre mjeteve varion nga 1% deri 12% dhe vetë punëdhënësi është ai i cili e përcakton vlerën të cilën do ta paguajë. Ka raste edhe kur punëdhënësi 1 muaj paguan kontribut vullnetar për anëtarët, ndërsa në muajin tjetër nuk paguan. Punëdhënësi në momentin e kontraktimit e ka të drejtën që të bëjë përzgjedhjen, llojin, mënyrën e pagesës si dhe të bëjë seleksionimin e anëtarësimit në skemën pensionale profesionale, sepse mund të mos jenë të gjithë të punësuarit të kyçur në skemën profesionale, gjithashtu punëdhënësi përcakton shkallën e kontributit, të cilën do ta paguajë për çdonjërin nga ata. Në rast se njëri nga anëtarët e skemës profesionale largohet nga puna apo vullnetarisht tërhiqet nga ai vend pune, punëdhënësi e ka për obligim të informojë shoqërinë pensionale, atëherë shoqëria pensionale në afat prej 90 ditëve i jep të drejtën për anëtarësim; në rast të punësimit vlera e mjeteve të grumbulluara shumëzohet për atë periudhë në bazë të normës së caktuar, në rast të mospunësimit skadon afati, atëherë bëhet shkëputja e një anëtari nga skema profesionale pensionale. (*Po aty, Neni 84*). Në rast të mosanëtarësimit e gjithë përgjegjësia i mbetet shoqërisë pensionale, e cila ka për obligim të kryejë verifikimin e anëtarit në lidhje me xhirollogarinë individuale vullnetare, nga shkak që mjetet e grumbulluara nuk mund të shkëputen individualisht dhe nuk lejohet shkëputje individuale në skemë, atëherë shoqëria informon Agjencinë për supervizion të kapitalit financiar të sigurimit pensional dhe kërkon të dhëna për anëtarin, agjencia siguron të dhënat, hap xhirollogari individuale vullnetare dhe bën tërheqjen e mjeteve të grumbulluara, të cilat do të pushojnë nga shumëzimi i tyre. Në këtë rast Agjencia për Supervizion i Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional me të dhënat që ka, dërgon letër deri tek anëtari dhe e informon për gjendjen financiare në përpikshmëri dhe mënyrën e funksionimit të mëtejshëm deri në ditën e tërheqjes së parave të gatshme.

Përparësi e skemës profesionale pensionale është se mjetet e grumbulluara nga kontributet shtesë mund të tërhiqen 10 vite para pensionimit, që domethënë meshkujt 54 vite dhe femrat 52 vite. Në rast të vdekjes, mjetet e grumbulluara i takojnë trashëgimtarëve të parë ose në bazë të ligjit për pension familjar të trashëguar (*Po aty.*).

Rregullat për skemën pensionale profesionale detyrimisht duhet të përmbajnë:

- Emrin e skemës pensionale profesionale;
- Emërtimin e fondit pensional vullnetar në të cilën është e përfshirë skema pensionale;
- Kontributet të cilat siguruesi do ti paguajë në skemën pensionale;
- Kushtet për fitimin e së drejtës për pjesëmarrje në sigurimin pensional profesional;
- Të dhënat për kompensim pensional (*Po aty, neni 84*).

Gjatë përpilimit të skemës profesionale individuale nga vullneti i vet të siguruarve, duhet të respektohen parimet dhe rregullat në vijim:

- Segmentimi i mjeteve të pensioneve të cilët do të duhet të mbahen në llogari të veçanta prej mjeteve që iu takojnë aktiviteteve të biznesit të sigurimit të pensionit, depozitarit të mjeteve, menaxherëve të mjeteve të kontabilitetit, kontrollit dhe investimet;
- Implementimi i sistemit financues është sistem i financuar nga kontributet shtesë të individëve dhe fitimi i investimeve që kanë derivuar nga ato. Fondi duhet të lejojë të akumulojnë në atë mënyrë mjetet me qëllim që të paguajë në mënyrë adekuate për premtimet e pensionit;
- Përkrahja dhe transparenca, siguruesi i pensionit duhet të mbështetë objektivat e programit të tyre të pensionit dhe mjetet e pensionit që janë investuar për të përkrahur objektivat e pensionit;

- Mbikëqyrja, investimet, kujdestaria dhe shfrytëzimi i mjeteve të pensionit i nënshtrohen mbikëqyrjes së mjeteve të pensioneve që shfrytëzohen vetëm për pagat e pensioneve (*Rregulla 13 mbi themelimin e pensionit suplementar individual nga siguruesi i pensionit, korrik 2002*).

I siguruari që është qytetar i Republikës së Maqedonisë dhe me veprimtari në shtetë tjetër që është anëtarë në Unionin European, ka të drejtë të organizojë skemë pensionale profesionale e cila do të përfshihet në fondin privat vullnetar, me të cilin udhëheq shoqëria me seli në Republikën e Maqedonisë (*Ligji për kapital financiar të sigurimit pensional: 07-115/1/2008: neni 102*). Agjencia për Supervizion i Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional e përcakton mënyrën e përfshirjes në skemën pensionale profesionale të organizuar dhe të financuar nga sigurues, i cili gjendet në territorin e shtetit tjetër, anëtarë i Unionit European për përfshirje në fondin pensional vullnetar (*Po aty, neni 102*).

Shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë pensionale, të cilat paguajnë pensione të Kolonës së Dytë dhe Kolonës së Tretë themelojnë Qendrën për Sistem Elektronik për Kuotë. Qendra për Kuotë themelohet si subjekt jofitimprurës, paraqitet si subjekt juridik dhe miraton statusin e Agjencisë për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional (*Po aty, neni 23*). Qendra për Kuotë financohet nga shoqëritë, ajo përpilon raporte vjetore, dokumente të kontabilitetit dhe përpilon llogari vjetore dhe raporte vjetore për vitin afarist, të njëjtat i dorëzon në afat deri më 31 Mars të vitit të kaluar (*Po aty.*).

Veprimtaria të cilën e kryen qendra për kuotë në vete ngërthen:

- Vendos dhe mirëmban *software* për lidhje elektronike të të gjitha shoqërive të sigurimit dhe shoqërive pensionale;
- Pranon dhe evidenton oferta - kërkesa për kuotë të dorëzuar në formë elektronike nga shoqëria pensionale;

- Pranon dhe evidenton oferta për anuitete dhe tërheqje të programuar të dorëzuar nga shoqëria e sigurimit dhe shoqëria pensionale;
- Miraton tabela përmbledhëse me të gjitha ofertat e pranuar për anëtarin/en, i cili/e cila ka dorëzuar kërkesën për kuotë;
- Kryen veprimtari që janë në interes të përbashkët të shoqërisë së sigurimit dhe shoqërisë pensionale;
- Miraton kodeks të sjelljes të shoqërive për sigurim dhe shoqërive pensionale në procesin e kuotimit;
- Bashkëpunon me Agjencinë për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional dhe Agjencinë e Sigurimeve për vlerën e realizimit të pensioneve të Kolonës së Tretë (*Po aty.*).

3.5.5.3. Tregu i Kapitalit të Shoqërit Pensionale

Tregu i kapitalit në vendet e zhvilluara siguron burime kryesore të fondeve pensionale dhe për operatorët ekonomikë. Duke ditur faktin, që në Republikën e Maqedonisë, në tregun e kapitalit investimet janë të pamjaftueshme, ato fillojnë vetëm nga një parim i vetëm, të cilin e quajnë e ardhur e siguruar. Financimi dhe zhvillimi i tregut të kapitalit ndihmon në rritjen e sigurimit, në zhvillimin ekonomik në qoftë se efikasiteti në të cilin janë kursimet do të kanalizohen në investime (*Dajmond, 2013:100*). Edhe pse shumica e analizave makroekonomike fokusohen në hulumtimin e implikacioneve nga mospërkryerja e tregjeve kreditore në fluktacionet ciklike, ana tjetër e programit fokusohet te rritja. Rëndësi të veçantë, tashmë të pranuar, për tregun e kapitalit për rritje, gjatë së cilës tregu i kapitalit doemos duhet të mbështetet në fitimin e pashpërndarë, në

ndryshimet e politikës ekonomike, të cilat u mundësojnë kompanive që të mbajnë rrezik më të lartë, rrezik i cili e përforcon rritjen ekonomike (*Po aty*, 92).

Në rastin e shtetit më pak të zhvilluar, siç është edhe vetë Republika e Maqedonisë, kërkohet investim në hulumtimin e shteteve më të zhvilluara, e sidomos në ekonominë e tregut ku hulumtimet dhe inovacionet janë të përshkruara mirë në modelin kompentativ dhe në standardin e tij. Për një model të tillë, e sidomos kur flitet për mjete pensionale, për krahasim duhet të merret në konsideratë një shtet tek i cili nuk ndërhyr qeveria, përgjithësisht për qëllim të krijimit të efikasitetit të tregut kapital (*Ekonomia për botën jo të përkryer, Arnot, Grinvold, Kanbur, Najlbaf, 2012*).

Çdo sistem financiar përbëhet nga dy pjesë përbërëse nga koordinimi i kursimit dhe nga investimet e tyre në ekonomi:

1. Tregu parësor (primar), i cili paraqet tregun financiar ku për herë të parë është tregtuar letra me vlerë, dhe
2. Tregun dytësor (sekondar), që paraqet blerjen dhe shitjen e letrave me vlerë që më herët kanë qenë të tregtuara dhe të emetuara. Në tregun dytësor bëjnë pjesë bursa e letrave me vlerë, e cila është vend i centralizuar, ku takohen blerësit dhe shitësit për të tregtuar letrat me vlerë. Shërbimet e bursës së letrave me vlerë ofrohen vetëm nga anëtarët e bursës dhe të shtëpive brokere si dhe dilerëve të licencuar për të drejtën e tregtimit dhe emetimit të letrave me vlerë jashtë bursës. Organi shtetëror ka të formuar komisionin e letrave me vlerë, i cili kontrollon punët e tregut të letrave me vlerë. Regjistri depozitar është personi juridik i cili mban dhe është përgjegjës për regjistrin e letrave me vlerë që, gjithashtu, ua jep ISIN letrave me vlerë dhe ofron shërbime të tjera financiare (*Po aty*, 93).

Ndërmjetësues financiar janë: bankat komerciale, kompanitë e sigurimeve, bordet investive dhe pensionale, brokerët, dilerët etj.

Ndërmjetësuesi financiar është institucioni i cili qëndron në mes të kursimorëve dhe investitorëve. Ndërmjetësuesit financiarë janë njësi të ekonomisë suficitare të cilët mundësojnë transfer të tërthortë të mjeteve në mes tyre me zvogëlimin e rrezikut dhe të shpenzimeve. Ndërmjetësues të rëndësishëm që kanë rol të rëndësishëm në sistemin pensional janë: Fondi investiv, i cili është ndërmjetësues financiar që është i formuar me qëllim që t'i grumbullojë mjetet nga investitorët. Ai ka statusin e personit juridik dhe mjetet e gatshme ka të drejtën t'i investojë, funksioni kryesor i ndërmjetësuesve financiarë është diversifikimi i rrezikut dhe menaxhimi profesional (*Po aty, 94*). Fondi investiv mundë të jenë *fondi i hapur investiv* i cili i grumbullon parat e gatshme përmes thirrjes publike për shitjen e dokumenteve dhe bonove dhe *fondi i mbyllur investiv* i cili i grumbullon parat e gadshme përmes thirrjes publike për shitjen e aksioneve. Investitorët institucionalë janë ndërmjetësues financiarë të cilët i investojnë mjetet e tyre në institucione të tjera dhe ato janë: banka, fonde investive, fonde pensionale investive, shoqëri sigurimi etj. Fondet investive ofrojnë zgjedhjen e parave të cilët shoqërohen me mjetet e fondeve të tjera me qëllim të shtimit të blerjes, ato themelohen nga ana e kompanisë investuese, të cilën e menaxhojnë profesionistë investues të cilët kanë qëllim të caktuar dhe plan-programin e caktuar investiv. Ka raste kur fondet shesin aksione aq sa kanë nevojë investitorët, të cilëve u shlyejnë dividendë nga të hyrat dhe normë të kamatës nga investuesi. Sot ekzistojnë më se 9500 fonde, të marra si model nga Robert Fleming i cili në vitin 1800 themeloi trustin e parë që edhe sot ekziston në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Qëllimi i fondeve investuese është të arrijë të hyra ditore të larta, të hyra në zhvillim të ardhshëm që çdoherë duhet të bartin dhe të kenë bazë rrezikun.

Shtëpitë brokere janë persona juridik të themeluar nga Komisioni i Letrave me Vlerë dhe personat të cilët marrin licencën dhe kryejnë punën e tregtimit të letrave me vlerë quhen brokerë dhe të cilët punojnë në emër të tyre për llogari të tjetrit pa e pasur parasysh interesin e tjetrit, përveç pagës bazë të caktuar nga shtëpia brokere. Dilerët janë ndërmjetësuesit financiarë, të cilët për dallim nga brokerët, ata shesin dhe blejnë letra me vlerë në emër të tyre dhe interes të tyre, e për dallim nga dilerët dhe brokerët, këshilltarët investicional janë gjithashtu persona fizik detyra e të cilëve është që investitorëve t’iu japin këshilla për investim dhe gjithashtu për rrugën e arritjes deri te investimi, duke e bërë matjen e drejtë të rrezikut.

Instrumentet financiare janë: letrat me vlerë, aksionet, fletobligacionet, depozitat, depozitat bankare. Instrumentet financiare janë të atyre personave të cilët i kanë emituar letrat me vlerë dhe shlyerja e pagesës së shitësit të instrumentit në bazë të kontraktimit. Investimi i mjeteve të fondeve pensionale kryhet nga shoqëria pensionale, e cila ka për obligim të menaxhojë me mjetet e grumbulluara të fondeve pensionale dhe ato të njëjtët mbajnë përgjegjësi për fondet investive pensionale. Mjetet e fondeve pensionale investohen në bazë të ligjit për financim kapital të fondit pensional, me qëllim të sigurimit të të ardhurave dhe kthimit më të lartë, gjithashtu për siguri të parave të fondeve pensionale, diversifikim të rrezikut dhe mbajtje të likuiditetit. Mjetet e Fondit të Obliguar Financiar Kapital kanë të drejtë ligjore të investohen në këto instrumente: depozita në banka komerciale, të cilat bartin normën e kamatës më të lartë, letra me vlerë, depozita të certifikuara, letra me vlerë që bartin hipotekë, aksione të ndryshme të shoqërive aksionare, letra me vlerë të shteteve, të cilët janë anëtarë të Unionit European dhe OECD, aksione nga kompanitë e huaja të shteteve që janë pjesë e UE dhe OECD (*Po aty*, 95).

Mjetet e shoqërive pensionale në bazë të ligjit për kapital financiar për sigurim pensional kanë të drejtë të investohen në: depozita bankare në banka të cilët janë të licencuara nga Banka Popullore dhe cilët depozita që përfshijnë edhe kamatë, bono të thesarit dhe letra me vlerë të cilët i garanton Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, certifikata për depozita, të cilat i garanton Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, letra me vlerë në bazë hipotetike të cilët janë të licencuara nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, aksione dhe letra me vlerë, të cilët tregtohen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Japoni dhe vende anëtare në Unionin European.

Mjetet e fondeve pensionale të cilët nuk kanë të drejtë të tregtohen në llojet e instrumenteve në vijim janë:

- Aksione, obligacione dhe letra me vlerë, të cilët nuk kotohen në tregun oficial dhe të cilët instrumente publikisht nuk i tregtojnë;
- Aksione në treg jo të sigurt;
- Mjetet të cilët nuk kanë të drejtë të investohen në objekte, në patundshmëri, automjete etj. (*Po aty, 99-100*).

Tabela nr.3 Llojet e instrumentëve ku investohen mjetet e fondit pensional të obliguar dhe vullnetar

Lloj i instrumenteve në të cilën mundet të investohen mjetet e fondit pensional	Përqindja maksimale prej mjeteve të fondit pensionalë
Investime të huaja (vetëm në vendet e Unionit Europian, Japoni dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës)	20%
Letra me vlerë të garantuara nga R e M-së ose Banka Popullore e R së M-së	80%
Depozita bankare, certifikata për depozitë, shënime komerciale, obligacione dhe letra me vlerë në bazë hipoteke nga banka e vendit	60%
Obligacione dhe shënime komerciale nga aksionerët e vendit, të cilët aksionerë nuk janë bankat	40%
Aksione nga shoqëritë aksionare të vendit	30%
Dokument për fletobligacione dhe aksione të fondit investiv të Maqedonisë	20%

Burimi: www.mapas.gov.mk

Në strukturën e instrumenteve financiare të kapitalit të vet në të cilat kanë investuar fondet e detyrueshme të pensioneve, sipas llojit të instrumentit të përdorur kryesisht janë aksionet në fondet e investimeve të huaja që plotësisht tregtohen në bursën e letrave me vlerë. Investimet në aksione në fondet e investimeve të huaja marrin pjesë me mbi 70% në strukturën e instrumenteve financiare të kapitalit të vet dhe në vitin 2015 rriten me 24,8%, e cila është ende shkalla e ngadalshme e rritjes në krahasim me 2014 (53,2%). Rritjen e investimeve në aksione në fondet e investimeve të huaja është si një alternativë e rëndësishme e investimeve për kompanitë që menaxhojnë fonde, sepse nga njëra anë, kemi një kthim të afërm të lartë të pritur të obligacioneve, në anën tjetër, investimet në aksione në fondet e investimeve të huaja në mënyrë indirekte do të thotë diversifikimin dhe për të zvogëluar rrezikun se investimet në letra me vlerë të emetuesit individual.

Fondet e Pensioneve Private kanë pak hapësirë për diversifikim të mëtejshëm të rrezikut nëpërmjet investimeve të mëtejshme në aksione në fondet e investimeve të huaja¹²⁷, duke marrë parasysh kufizimet ligjore për të investuar jashtë vendit¹²⁸ dhe shuma e investimeve në lloje të caktuara të instrumenteve financiare¹²⁹. Në kuadër të instrumenteve financiare të kapitalit neto të rritjes më të shpejtë të regjistruar aksionet e emetuesit të huaj me një rritje prej 35%, e cila ishte më e lartë nga 11,3 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2014. ¹²⁷ Më 31.12.2013, 27.5% nga totali i aktiveve të fondeve të detyrueshme pensionale janë investuar në letra me vlerë të huaja. ¹²⁸ Ligji mbi financim të detyrueshëm të sigurimit pensional ofron kufirin maksimal prej 50% të aseteve të fondeve që mund të investohet jashtë vendit (BE-së dhe OECD). Sipas rregullave në fuqi në BE për lëvizjen e lirë të kapitalit, nuk duhet të ketë kufizim i tillë në investimet e fondeve pensionale. ¹²⁹ Me ligjin për financim kapital të detyrueshëm të sigurimit pensional, kufijtë ekzistues mbi llojet e instrumenteve janë më shumë se 30% e aseteve mund të investohen në letra me vlerë të lëshuara nga kompanitë jo-shtetërore të huaja, bankat apo fondet e investimeve.

3.5.5.4. Institucionet financiare të sigurimit pensional

Institucionet financiare të sigurimit pensional janë: bankat komerciale; shoqëritë e kursimeve dhe kredive, bankat e kursimeve; unionet kreditore.

Banka komerciale paraqitet në kategori më të lartë të institucioneve depozitare të cilët paraqiten si ndërmjetësues financiarë që pranojnë depozita dhe lejojnë kredi, duke ofruar ndarjen e rrezikut, likuiditetit dhe shërbimit të informimit që të mund të shfrytëzojnë kursimtarët dhe huamarrësit.

Kursimtarët sigurojnë beneficione të ndarjes së rrezikut nga portfolija e diversifikuar kreditore e bankare. Huamarrësit mund të sigurojnë mjetet e nevojshme për financim. Të siguruarit dhe anëtarët preferojnë që të kursejnë përmes planeve të pensionit të ofruar nga punëdhënësit për arsye se: Fondet e pensioneve janë në gjendje që të menaxhojnë portfolion financiarë në mënyrë më efikase me shpenzime më të ulëta të transaksioneve, Fondet e pensionave mund të sigurojnë benefite, siç janë ato të anuitetit.

3.5.5.5. Investimi i mjeteve të fondeve pensionale

Fondet private zakonisht investojnë në një miks bono publike dhe korporative që kanë shkallë të lartë fitimi dhe risk të reduktuar. Në të shumtën e rasteve sistemet e sigurimit pensional janë të shoqëruara me kolonën e parë dhe me sistemin PAYG, të cilin sistem gjithmonë po e krijojnë fondet e investimit. Këto mund të jenë thjesht fonde rezervë afatshkurta për të siguruar institucionin në rast rreziku dhe në rast krize, e cila ndërpret rrjedhjen e të ardhurave kontributive, për shembull, në Slloveni 1.9% e të ardhurave vjen nga fondi i investimit i cili është i krijuar nga një pjesë e të ardhurave dhe nga privatizimi i pensionistëve shtetërore. Investimet e siguruara pensionale janë të krijuara për ti mbrojtur interesat e anëtarëve- qytetarëve për atë është e nevojshme që ato të menaxhohen me kujdes dhe përgjegjësi. Investimi i fondeve mund të sjellë një kontribut të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e sistemeve pensionale, megjithatë investimi i fondit rezervë nuk është pa rrezik.

Objektivat parësore për investim të fondit të sigurimit janë:

- Siguria në të cilën investimet duhet të ndihmojnë sistemin pensional për të realizuar detyrimet e tij në një kosto efektive;

- Përfitimi- investimet duhet të sigurojnë maksimumin e të ardhurave, e cila është subjekt i riskut të pranueshëm (*ISSA 2004:1*).

3.5.5.6. Strategjia e investimit të shoqërit pensionale

Me shoqëri investimi nënkuptojmë institucion financiar që vatrëzohet në drejtimin e kursimeve të vendosura në aksione e në fletobliogacione e të tjera, si këto kapitale ose edhe të mallrave të tjera si tablo, diamante etj, vlera e të cilëve shpresohet se do të rritet në të ardhmen (*Skenderi, 2010:238*). Këto janë shoqëri aksionare veprimtaria, e të cilave është udhëheqja me fondet pensionale. Ky llojë i shoqërisë mund të jenë bankat, shoqëri sigurimi apo institucione të tjera financiare, të cilat marrin licencën nga Agjencia për Supervizion i Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional, detyra e të cilëve është të investojnë mjetet në fondet pensionale me qëllim të rritjes së vlerës së tyre. Shoqëritë pensionale mbajnë llogari të rregullt për gjendjen e tyre financiare dhe e informojnë Agjencinë për supervizion të kapitalit financiar të sigurimit pensional.

Shoqëritë pensionale private përgatitin dokument për zbatimin e strategjive investuese për 12 muaj duke përfshirë investimet e çdo lloji të mjeteve, kufizimet interne dhe ekspozimet në rreziqe (*Ligji për kapital financiar të sigurimit pensional, 07-1801/1/2002, neni 32*).

Shoqëritë e investimin përdorin politika të investimit të cilat duhet të bazohen në parimin që investitori investon ashtu siç duhet të investojë: kursimtar në mënyrë të arsyeshme- ajo përfshin rregullat e përshtatshme për alokimin e investimit në pronë specifike, ku gjatë vendosjes së rregullave duhet të merren parasysh menaxhimi i riskut të mjeteve pensionale, nevoja për shumëllojshmëri dhe shpërndarje që domethënë

investimi në klasa të ndryshme të pasurisë dhe investime të ndryshme brenda secilës klasë, kombinimi i të ardhurave dhe shpenzimeve duke marrë parasysh se kur do të maturohet secila, bashkërendimi i valutës, krahu i investimeve ngrihet t'i shërbejë qëllimeve të klientit dhe jo anasjelltas, në këtë rast klienti është person kryesor në të cilin investohen fondet, matja e rezultateve dhe monitorimi (131, *Ekonomia në botën e papërkryer, Arnot, Grinvold, Kanbur, Najlbaf, 2012*).

Investimet e fondeve private pensionale në dobi sociale dhe ekonomike

Investimi në projekte me rëndësi sociale dhe ekonomike, te këto investime fondet do të paguajnë të ardhurat nga tregu që domethënë kontribuesit ose përfituesit do të subvencionojnë atë qëllim social. Në shumë vende këto lloj investimesh përbëjnë një kontribut të rëndësishëm në shkallën e rritjes ekonomike kombëtare, megjithëse shkalla indirekte e të ardhurave mund të mos pasqyrohet tërësisht në shkallën monetare të të ardhurave. Duke kontribuar në rritjen ekonomike kombëtare afatgjate ato mund të përmirësojnë statusin financiar të sistemit të sigurimit pensional duke u shtuar numri i anëtarëve, sasia e të ardhurave të tyre të siguruar si dhe shkalla e të ardhurave nga investimet e sistemit pensional (ISSA, 2004: 7)

Menaxherët e investimit në fondet pensionale merren me vlerësimin e rezultateve , janë të disponuar të përqendrohen në faktin nëse një menaxher ka qenë i suksesshëm ose më pak i suksesshëm se të tjerët në biznes ose në treg pensional. Në përgjithësi kjo tregon aftësinë e tyre, por jo që tregon se politika e investimit po arrin politikat dhe objektivat e investimit.

Parakushtet lidhur me të ardhurat e mjeteve të investuara, shfrytëzohen në disa mënyra: të ardhura bazike, të ardhura optimiste dhe pesimiste.

Të ardhurat bazike përcaktohen në bazë të performancës së portfolios nga mjetet me përbërje të ngjashme të portfolios duke marrë parasysh pjesëmarrjen në fitim të polisës për anuitet fiks të realizuar për dhjetë vite.

Skenari optimist thekson variablat e të ardhurave dhe pasojat nga variabla e lartësisë së pensionit.

Skenari pesimist është parakusht për të hyra më të ulëta nga të hyrat e shfrytëzuara në skenarin bazik (*Po aty, neni 11*).

3.5.5.7 Rreziqet e fondeve pensionale private

Menaxhimi i riskut është pjesë themelore e drejtimit të korporatës, shoqata ndërkombëtare dhe Unioni European ka hartuar një udhëzim praktik në lidhje me zbatimin e një politike për menaxhim të riskut.

Llojet e rreziqeve në fondet pensionale janë:

- Rreziku në sigurimet pensionale mund të përcaktohet thjesht si mundësi e keqe e cila sjell pasoja negative;
- Për dallim nga risku i përgjithshëm, risku administrativ paraqet të metat e situatave kompjuterike, gabimet gjatë regjistrimit, përmbushja e dobët nga kontribuesit e skemës pensionale, skema për të deklaruar të ardhurat mbi bazën e të cilëve shpërndahen kontributet dhe punësime të një stafi të papërshtatshëm dhe të paaftë për të menaxhuar mjetet pensionale me qëllim të realizimit dhe administrimit të skemës në nivel të kënaqshëm dhe risku mashtrues i cili paraqitet në rastet kur shoqëritë pensionale paraqesin transaksione mashtruese dhe borxhe fiskale që rezultojnë nga vendimet politike dhe ligjore.
- Risku i likuiditetit është rrezik që fondet pensionale dhe shoqëritë pensionale, nuk do të mundën të disponojnë aq mjete për ti mbuluar pagesat për gjatë tërë vitit. E gjithë

kjo mund të përballohet duke vendosur një fond që investohen mjetet në një mënyrë që lejohet mbulimi dhe nevoja.

- Risku i jetëgjatësisë dhe risku ekonomik: risku ekonomik i referohet rastit të njerëzve që jetojnë më gjatë nga që pritet, ndërsa risku ekonomik i referohet një sërë faktorësh duke filluar nga ndikimet negative të ciklit të biznesit në nivelin e punësimit dhe shlyerjen e kontributeve si dhe efektet e inflacionit në një skemë ku përfitimet janë plotësisht të indeksuara por kontributet nuk janë të indeksuara.

- Risku politik, qëndron në faktin që politika do të ndryshojë pikëpamjet e tyre apo rregullat për përfitime.

Institucionet e sigurimeve pensionale duhet t'i vendosin rregullat proceduriale për identifikimin, përcaktimin e masës dhe menaxhimin e llojeve të ndryshme të rreziqeve.

(Dajmond, 2013: 72)

Kompensimin që e paguan shoqëria pensionale

Shoqëritë pensionale nga anëtarët e tyre dhe nga mjetet e anëtarëve përfitojnë nga kontributet e tyre, mirëpo në Ligjin për Kapital Financiar të Sigurimit Pensional Republika e Maqedonisë ka të rregulluar kompensimet që i paguan shoqëria pensionale. Shoqëria pensionale paguan kompensim vetëm për kontributet, vlera maksimale e të cilëve mundet të arrihet 4% nga kontributi i paguar, 0,05% nga njësia mujore e kontributeve të paguara. Kompensimi paguhet edhe në rast të transferit të anëtarit nga njëri fond i obliguar pensional në tjetër fond të obliguar pensional. Rojtarëve të pasurisë u paguhet kompensim nga vlera e kontributeve ditore nga ana e shoqërisë pensionale, të cilën përlllogaritje e kryen Agjencia për Supervizion i Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional.

Në rast se shoqëria vlerëson se, shoqëritë që menaxhojnë fondet pensionale duhet t'u rritet vlera e kompensimit nga kontributet, ato së pari duhet të dërgojnë kërkesën e shkruar deri te Këshilli i ekspertëve të Agjencisë për Supervizion të Kapitalit Financiar të Fondit Pensional, të cilët do ta shqyrtojnë kërkesën dhe marrin vendim në bazë të ligjit për kapitalin financiar të fondit pensional. Agjencia informon shoqërinë pensionale për vendimin kolegjal dhe shoqëria pensionale me letër të shkruar informon anëtarët që kanë ndryshuar normën e kompensimit (*Po aty, 106*). Ndërsa te Fondi Pensional Vullnetar shoqëritë pensionale që udhëheqin fondet pensionale vullnetare, ato paguajnë kompensim në rastin e investimit të mjeteve të skemat pensionale profesionale dhe vlera e kompensimit nuk ka të drejtë të jetë më e madhe se 7%. Me reformën pensionale Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton Ligjin për Kompensim të Kontributeve ku aty përcakton që shoqëritë pensionale do t'i paguajnë kompensim Fondit Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë e cila vlerë kompensuese arrin 0,1% për çdo parapagues të kontributeve, gjithashtu duhet t'i paguajë kompensim depozitari të pasurisë dhe Agjencisë për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional me vlerë prej 0,8% prej çdo parapaguesi të kontributit. Kontributet, mjetet e bartura dhe të gjitha fitimet nga investimet e tyre sistemohen në llogari individuale që janë në emër të anëtarëve të fondit pensional vullnetar. (*Ligji për Kapital Financiar të Sigurimit Pensional, 07-115/1/2008: neni 122*)

3.5.5.8 Pensionet dhe kompensimet pensionale nga Kolona e Dytë Pensionale

Më lart kemi përmendur që Republika e Maqedonisë ka sistem pensional multidimensional pensional, cilët sigurojnë mbrojtje të rrezikut të pleqërisë, invaliditetit dhe vdekjes. Pjesa e parë e pensionit siguron vlerën e pensionit të pleqërisë të përbërë nga baza e 80% të vlerës së grumbulluar të kontributeve të paguara për periudhën e punës, pjesa e dytë siguron pension pleqërie të mjeteve të grumbulluara, të cilët janë akumuluar dhe shumëzuar për aq vite punë të cilët janë shtesë e pensionit të obliguar dhe pjesa e tretë e pensionit vullnetar e cila është kursim për pension pleqërie (*Po aty, 106*).

Kur anëtari i fondit pensional fiton të drejtën e kompensimit pensional, shuma e mjeteve të akumuluar mund të shfrytëzohet në këtë mënyrë:

- Pagesa e shumës së përgjithshme të llogarisë së anëtarit përnjëherë ose për më shumë herë;
- Blerja e anuitetit pensional që paguhet deri në fund të jetës;
- Tërheqje e programuar e mjeteve;
- Kombinim i opsioneve më lart. (*Po aty, neni 122*).

Procedura për realizim të së drejtës së pensionit nga kolona e dytë pensionale

Që një anëtarë të fiton të drejtën e pensionit, nevojitet që në kompletimin e dokumentacionit dhe të kërkesës së parashtruar të statusit pensionist, të parashtron kërkesë për realizimin e së drejtës për pension të pleqërisë deri te Fondi Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë, Fondi Pensional Shtetëror verifikon të dhënat e anëtarit dhe sjell vendim për përmbushje ose mospërmbushje të kushteve të së drejtës për pensione pleqërie, kopjon vendimin e sjellë dhe e dorëzon te shoqëria pensionale. (*Po aty, neni 28*).

Anëtari i Fondit Pensional që posedon llogari individuale në shoqërinë pensionale parashtron kërkesë tek Shoqëria Pensionale e cila në emër të tij ose asaj fillon kuotizimin në qendrën për kuotë në varësi të llojit të përcaktuar të pensionit. Pasi kryejnë procedurat e kuotizimit qendra për kuotë dorëzon te shoqëria pensionale tabelën përmbledhëse me të gjitha ofertat për anëtarin e shoqërisë pensionale dhe në afat prej 30 ditëve anëtari ka të drejtë të përcaktojë llojin e ofruar për pension pleqërie nga kolona e dytë e kapitalit financiar të sigurimit pensional (*Po aty, neni 29*). Në rastet kur anëtari i Shoqërisë Pensionale përcaktohet për pension nga Kolona e Dytë përmes anuitetit nënshkruan polisë për anuitet me shoqërinë e sigurimit dhe në rastet kur anëtari kombinon pensionin e kolonës së dytë me tërheqje të programuar dhe anuitet të prolonguar të përhershëm, nënshkruan marrëveshje me shoqërinë pensionale si dhe nënshkruan polisë për anuitet me shoqërinë e sigurimit (*Po aty*).

E drejta e pensionit vetëm nga Kolona e Dytë- anëtari i shoqërisë pensionale i cili nuk ka të realizuar të drejtën për pension pleqërie në Fondin për Sigurim Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë ose Kolona Parë Shtetërore, si shkak i mosplotësimit të kushteve ligjore, atëherë anëtari ka të drejtë të shtrojë kërkesë për realizimin e së drejtës për pension vetëm nga kolona e dytë pensionale. (*Po aty, neni 34*) Kërkesa për pension në Shtyllën e Dytë parashtrohet atëherë kur anëtari arrin moshën 65 vjeç dhe në kërkesën e parashtruar nga anëtari duhet të përcaktojë mënyrën e tërheqjes së mjeteve (*Po aty*).

Ekzistojnë dy mënyra të së drejtës së pensionit vetëm nga Kolona e Dytë:

- Pagesa e njehershme e mjeteve nga Kolona e Dytë pensionale e kapitalit financiar të sigurimit pensional të grumbulluara në llogarinë individuale si kursime pensionale.

- Realizimi i pensionit vetëm nga Kolona e Dytë, ky lloj vjen në shprehje atëherë kur pensioni është më i lartë ose i barabartë me 40% të shumës më të ulët të pensionit në ditën e realizimit të së drejtës së pensionit (*Po aty.*).

Shoqëria pensionale e cila paguan pensionet ka për obligim të kryejë përlllogaritje të pagesës së tatimit pensional mbi të ardhurat në emër dhe në llogari të shfrytëzuesit të pensionit (*Po aty.*).


Detyrimet e fondeve pensionale ndaj anëtarëve:

Detyrimet dhe obligimet e fondeve pensionale ndaj siguruesve janë të shumta: çdo shoqëri është e obliguar që deri më datë 31 Mars të shpallë prospektin informativ për fondin pensional me të dhëna të sakta për fondin pensional, prospekti përmban:

- Emrat e anëtarëve të këshillit drejtues;
- Emrat dhe adresat e aksionarëve si dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqërinë kapitale;
- Emrin dhe vendndodhjen e depozitarit të pronës;
- Dokument i strategjisë së investimeve;
- Kompensimi që paguhet nga anëtarët e fondit pensional vullnetar;
- Numrin e anëtarëve të fondit pensional vullnetar;
- Neto vlerën e mjeteve të fondit pensional vullnetar në ditën e vlerësimit të fundit

(Ligji për kapital financiar të sigurimit pensional vullnetar, 7-115/1/2008: neni 1-3).

Figura 1. Funksionimi i sistemit pensional në Republikën e Maqedonisë



Burimi: www.mapas.gov.mk

3.6. Avantazhet për anëtarët e sistemit të reformuar pensional me kapital financiar

Reforma pensionale ofron siguri të lartë për anëtarët, falë mjeteve që shpërndahen në dy ose më tepër kolona pensionale. Nga kjo mënyrë e reformuar pensionale apo prej funksionimit të tri kolonave krijon diversifikim të rreziqeve në të cilin çdo sistem duhet t'i bartë me vete rreziqet, gjë që nënkupton se rritet shkalla e sigurisë pensionale. Në aspektin individual një reformë e tillë është shumë e dobishme dhe pozitive për shkak të financimit të pensioneve në dy kolona ku pensioni i Kolonës Parë përllëget nga paga e të siguruarit dhe pjesa e dytë e kontributeve paguhet nga llogaria individuale e Kolonës Dytë Pensionale dhe një pjesë shumë e rëndësishme e mjeteve është ajo e kursimit të

mjeteve në mënyrë vullnetare në Shtyllën Tretë Pensionale ku kursehen mjetet me qëllim që t'u jepet mundësi, që në kohën e pensionit të pleqërisë të mund të marrin pensionin e kombinuar nga tri kolona pensionale, gjë e cila siguron pleqërinë. Anëtarët janë të bindur që të drejtat e kursimeve të tyre janë shumë të sigurta sepse qëndrojnë në aktivë dhe në llogarinë individuale të tyre. Për t'i mbrojtur interesat e anëtarëve më të moshuar, që më herët dhe me vite kanë kontribuar në sigurimin pensional, sistemi pensional i tranzicionit dhe ai i ri i reformuar, i përbërë nga dy e më tepër kolona pensionale do të funksionojnë paralelisht. Për t'i mbrojtur interesat dhe të drejtat e anëtarëve Agjencia për Supervizion i Kapitalit Financiar të Sigurimit Pensional, çdo siguruesi i hap llogari individuale me të cilën fondet private pensionale ofrojnë transparencë në punë, i siguruari-anëtari në çdo kohë mund ta kontrollojë dhe të verifikojë, por edhe të jetë i informuar për mjetet që ka në dispozicion. Anëtari pranon edhe letër arsyetim për mjetet e investuara dhe për instrumentet e investuara në tregun financiar, gjithashtu do të informohet edhe për përfitimet që do t'i sjellin në moshën e pleqërisë dhe në kohën e pensionimit mjetet e investuara. Pikërisht këto ndryshime rrisin vetëdijen për reformë pensionale, e cila është e financuar vetëm sipas *Pay-As-You-Go*, që nënkupton se të ardhurat mbledhen nga të punësuarit dhe menjëherë përdoren për pagesën e pensioneve. Ky lloj i reformës përfshin rritjen e moshës së pensionimit, zbatimin, sigurimin pensional të obliguar dhe atë vullnetar me financim kapital me të cilat vjen deri te ngecja dhe zvogëlimi i ndryshimeve demografike.

Avantazh tjetër është krijimi i sistemit pensional solvent me jetëgjatësi të gjatë me të cilin çdo vend do të krijonte politikë sociale dhe stabilitet social. Përparësi e anëtarëve është se krijohet hapësira e njohjes dhe e plotësimit në procesin e së drejtës së njohjes së përfitimit pensional në mes të shteteve. Përfitimet pensionale janë të lidhura në mes

shumë shteteve, përmes të cilave iu mundësohet gjeneratave të ardhshme përfitim social pensional i bashkuar.

Për shembull, supozojmë se një anëtar ka veprimtari prej 10 vitesh në Maqedoni, 5 vite veprimtari në Kosovë dhe 3 vite veprimtari në Shqipëri, në rastin e përmbushjes së kushteve, anëtar i parashtrohet kërkesë për grumbullimin e përvojës pensionale dhe taksapaguesit do t'i njihen 18 vite përvojë e punës dhe pagesë për pension, që është kushti themelor minimal 15 vite punë. Po i njëjti taksapagues, në qoftë se është banor i Republikës së Maqedonisë dhe në kohën e pensionimit do të jetojë në Republikën e Shqipërisë, e gëzon të drejtën e plotë që të parashtrojë kërkesë për tërheqje të pensionit në vendin ku do të jetojë dhe e gjitha kjo vjen si rezultat i marrëveshjeve ndërshtetërore bilaterale të njohjes së stazhit dhe njohjes së përvojës së shtetit tjetër. Mjetet do të grumbullohen në llogaritë individuale nga tri shtetet në shtetin amë dhe krijohet llogari në mes të fondeve pensionale dhe vjen në konsideratë transferimi i pensionit nga shteti amë, Maqedonia, në shtetin ku i pensionuari do të jetojë, në Shqipëri. Kjo është edhe njëra nga reforma e cila sjell efikasitet të lartë në jetën sociale dhe lehtësi për individët të cilët kanë kryer veprimtari të ndryshme në shtete të ndryshme.

Reforma pensionale me kapital financiar të sigurimit pensional ofron shumë oportunitete për qytetarët e Republikës së Maqedonisë nga shkakut që për një pjesë të kontributeve i garanton shteti me institucionin i cili menaxhon fondet pensionale dhe Fondi Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë. Gjatë periudhës së pensionimit, në qoftë se falimenton fondi dhe shoqëritë pensionale private, shteti garanton për pensionet, për kthimin e kontributeve të kursyera në kursimoren pensionale.

Tabela nr. 4 Kushtet e anëtarësimit në shtyllën e dytë pensionale

Nëse jeni anëtar :	Atëherë
	Anëtarësim i obliguar
Të punësuar për herë të parë pas 1 Janar 2003	Ju jeni të obliguar të anëtarësoheni në njërin nga fondet private pensionale dhe keni të drejtë të zgjedhni në cilin fond dëshironi të anëtarësoheni.
Kolona e II-të	Anëtarësim vullnetar vetëm për të punësuarit para vitit 2002
Të punësuar për herë të parë para 1 Janar 2003, të cilët në periudhën e anëtarësimit (20.09.2005-31.12.2005) nuk kanë qenë në marrëdhënie pune	Derisa në periudhën e anëtarësimit (20.09.2005-31.12.2005) nuk keni qenë në marrëdhënie pune, keni të drejtë në mënyrë vullnetare për anëtarësim në fondet private pensionale në afat prej tre muaj duke llogaritur nga data e re e ripunësimit. Anëtarësimi është zgjedhje e juaj personale dhe ajo është vendimi juaj.
Me më pak se 5 vite përvojë pune deri në momentin e anëtarësimit	Derisa jeni në këtë kategori dhe anëtarësoheni në njërin nga fondet private pensionale, sigurisht që do të fitoni pension më të lartë.
Të punësuar para 2003	Atëherë
5-10 përvojë pune deri në momentin e anëtarësimit	Derisa jeni në këtë kategori dhe anëtarësoheni duhet të dini se 5-7 vite përvojë pune para mometit të anëtarësimit në fondet private pensionale do të pranohen gjatë llogaritjes të një pjese të pensionit tuaj të cilën do ta fitoni nga Fondi FPIOM. Në këtë rast sigurisht do të fitoni pension më të lartë në sistemin dykolonësh.
Më shumë se 10 vite përvojë pune deri në momentin e anëtarësimit	Seriozisht duhet të mendoni për vendimin tuaj. Ekziston besueshmëri më e madhe se do të keni pension më të lartë nëse nuk do të anëtarësoheni në njërin nga fondet private pensionale
Pensionerë	Pensioni juaj mbetet i sigurt në sistemin pensional ekzistues dhe nuk ndryshon.
Kategoritë anëtarët	Periudha e zgjedhjes
Anëtarët vullnetarë –Kolona e III-të	
Anëtarët e obliguar-Kolona e II-të	
Të punësuar për herë të parë pas 1 Janar 2003	Tre muaj nga data e punësimit të parë, nëse nuk zgjedhin fondin, atëherë MAPAS i përcakton me zgjedhje të rastësishme dhe i përcakton fondin

Burimi: www.mapas.gov.mk

Nga Tabela nr. 4 vërejmë se çdo i punësuar ka të drejtë të kryejë përzgjedhjen se në cilin fond pensional do të përcaktohet dhe njëkohësisht do të nënshkruajë kontratë për anëtarësimin në Fondin Pensional Invalidor. Para nënshkrimit të kontratës agjentët e shoqërisë e kanë për obligim që të prezantojnë ofertën dhe kushtet e anëtarësimit dhe në rast të tërheqjes së kontratës, afati ligjor është 8 ditë; punëdhënësi nuk ka të drejtë ligjore të punësuarin e tij ta detyrojë dhe t’ia imponojë përzgjedhjen e Kolonës së II-të Pensionale dhe Fondin Pensional. Të gjithë të sigurvearit dhe pjesëmarrësit në skemën e re pensionale pas 12 muajve do të jenë të informuar për rritjen apo zvogëlimin e të hyrave totale të mjeteve të investuara në aksione, në depozita në tregun financiar të vendit, si dhe në tregun financiar ndërkombëtar.

Tabela nr. 5 Avantazhet për anëtarët e kolonës së dytë pensionale

Fondi i obliguar pensional invalidor në bazë të gjeneratave solidare (kolona e I-rë)	Kapitali financiar i sigurimit të obliguar pensional (kolona e dytë)	Kapitali financiar i sigurimit pensional vullnetar (kolona e tretë)
Kolona e parë pensionale e paraqet fondin e obliguar pensional FSPIRM. Do të funksionojë në të njëjtën mënyrë në princip të gjeneratave solidare e cila nënkupton që kontributet e të sigurvearve mbidhen dhe shpërndahen në mënyrë proporcionale.	Kolona e dytë pensionale përmban dy fondet pensionale private ndërsa të sigurvearit duhet të përcaktojnë fondin pensional privat. Mjetet do të investohen në pajtueshmëri me ligjin dhe do të sigurohet mbrojtje e	Kolona e tretë pensionale është risi e cila mundëson për qytetarët sigurim pensional për të papunët, por ky sigurim pensional mundë të shfrytëzohet edhe nga të punësuarit me qëllim të sigurimit të pensionit më të lartë.

Burimi: www.mapas.gov.mk

Tabela nr. 6 Kontributet për anëtarët e kolonës së Parë Pensionale dhe anëtarët e kolonës së Dytë

Nëse jeni anëtar i siguruar vetëm në kolonën e parë pensionale	Nëse jeni anëtar i dy kolonave pensionale-sistemi i ri i reformuar pensional
21,2% kontribute të paguara në Fondin Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë	21,2% do të vazhdojë të paguajmë kontribute në FPIOM dhe do të ndahen në: 13,78% do të mbesin në aktivën e FPIOM , dhe 7,42% do të transferohen në llogarin individuale të fondit pensional
Vlera e pensionit përlogaritet nga % e pagës mesatare të cilën e kanë pranuar përgjatë gjithë periudhës së veprimtarisë dhe e cila pagë është e evidentuar në FPIOM Lartësia e përqindjes ka varshmëri nga stazhi i punës dhe vitet.	Pensioni i anëtarëve do të përfitohet nga dy burime: Nga FPIOM – i përlogaritur si % e pagës mesatare të cilët e kanë pranuar anëtarët gjatë gjithë veprimtarisë së tyre dhe e cila është e evidentuar në FPIOM Nga fondi privat pensional– e cila buron nga mjetet e akumuluar në llojë të anuitetit ose tërheqjes së programuar të pensionit. Zgjedhje e vetë dëshirës së të pensionuarit. * lartësia e % ka mvarshmëri nga stazhi i punës dhe vitet.

Burimi: www.mapas.gov.mk

3.7. Tipologjia e pensioneve me kapital financiar të sigurimit pensional

Në ligjin për pension dhe në ligjin për kapital financiar të sigurimit pensional janë rregulluar mënyrat e pensionimit, kushtet si dhe llojet e pensionit.

Ekzistojnë tre lloje të pensioneve në Republikën e Maqedonisë:

1. Pension pleqërie- pension i cili përcaktohet nga mesatarja mujore e pagesave që i siguruari realizoi gjatë gjithë periudhës së sigurimit, duke filluar më herët nga 1 Janari i vitit 1970 dhe deri në vitin e fundit, i cili i paraprin vitin të realizimit të së drejtës. Pensioni i pleqërisë përcaktohet nga baza e pensionit në përqindje të caktuar varësisht nga lartësia e stazhit.

2. Pension invaliditeti- invaliditeti shkaktohet si pasojë e sëmundjeve, lëndimeve jashtë punës dhe gjatë punës apo sëmundjeve profesionale. Të drejtën e pensionit invalidor e kanë anëtarët, kur për shkak të ndryshimeve në gjendjen shëndetësore, e cila nuk mundet të mënjanohet me shërim, aftësia e punës është zvogëlim i përhershëm për më tepër se gjysma në krahasim me të siguruarin e ngjashëm me aftësi fizike dhe psikike dhe me arsim të ngjashëm. Në rastet kur i siguruari për shkak të ndryshimeve të gjendjes shëndetësore, e cila nuk mundet të mënjanohet me shërim, ndodh humbje e përhershme e aftësisë për punë. Anëtarit të shoqërisë pensionale me përfitimin e statusit pensionist në bazë të ligjit për pension invalidor, statusi që e përcakton Fondi Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë, vlerën totale në llogarinë individuale e cila është e grumbulluar për vite stazh dhe pagesë për pension në kapitalin financiar të sigurimit pensional të obliguar shoqëria e transferon në Fondin Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë dhe në të njëjtën kohë anëtarin e informon për transferimin e mjeteve si

dhe për vlerën totale të tyre (mjeteve) të grumbulluar dhe, në fazën përfundimtare pasi anëtarë është i informuar, shoqëria pensionale mbyll llogarinë e anëtarëve (*Po aty.*).

3. Pension i trashëguar – ekzistojnë shumë mënyra të organizimit të pensionit të trashëguar. Për një bashkëshort, i cili mbetet gjatë nga një palë, në parim ekziston nevoja për më shumë se gjysma e të ardhurave të çiftit me qëllim për të mbajtur standardin e vazhdueshëm të jetesës (*Dajmond, 2013:146*). Kushtet e përgjithshme për fitimin e së drejtës së pensionit familjar, janë nëse i siguruari prej të cilit merret e drejta e pensionit familjar, deri në ditën e vdekjes ka mbushur më së paku 5 vite stazh të sigurimit apo më së paku 10 vite stazh pensioni. Nëse vdekja e të siguruarit është shkaktuar si pasojë e lëndimit në punë ose nga sëmundjet profesionale anëtarët e familjes e fitojnë të drejtën e pensionit, pa marrë parasysh lartësinë e stazhit të pensionimit të të siguruarit. Në rast të vdekjes së të siguruarit, të trashëguarit i takon pensioni deri në vdekje në rastet e paafta për punë dhe në rastin që pas vdekjes së të siguruarit të kenë mbetur një apo më tepër fëmijë, të cilëve u takon e drejta e pensionit familjar. Fëmija të drejtën e pensionit e gëzon deri në moshën 26 vjeç, po që se është në shkollë apo nëse ndjek studimet. Fëmija, i cili e ka ndërprerë shkollimin për shkak të kryerjes së obligimit ushtarak, pensioni familjar paguhet edhe në atë periudhë obligimi. E drejta e pensionit i takon të trashëguarit edhe në rastet kur fëmija lind pas vdekjes së të siguruarit, gjegjësisht kur shtatzënia ka ekzistuar edhe në ditën e vdekjes së të siguruarit (*Po aty.*). Ndërsa për dallim të pensionit bazë nga Kolona I, Kolona II pensionale me kapital të financuar i ofron të trashigimtarit më shumë lloje të pensioneve: duke filluar nga pensioni i programuar për një periudhë kohore, pension të programuar për një periudhë prej një viti, pension me anuitet dhe pension me bashkim anuitetesh-këtë lloj pensioni e përdorim në praktikë në rastet kur e trashëguara ende kryen veprimtari dhe paguan kontribute; në rast se tërheq pension do t'i ndërpritet

marrëdhënia e punës dhe do të tërheqë pension me vlerë të zvogëluar. Atëherë e siguruara, meqë posedon llogari individuale në Shtyllën II Pensionale me kapital të financuar, vendos t'i bashkojë anuitetet.

Të drejtat që rrjedhin nga reforma e pensioneve me kapital financiar të sigurimit pensional dhe invalidor në Republikën e Maqedonisë janë:

- E drejta e pensionit të pleqërisë është e drejta e të siguruarit kur ai ose ajo arrin të drejtën e pensionit të pleqërisë në moshën 64 vjeç për burra dhe 62 vjeç për gra, me më së paku 15 vite përvojë pune me stazh pensional;
- E drejta e pensionit invalidor kupton të drejtën kur i siguruari tek i cili do të shkaktohet paaftësi e përgjithshme për punë si dhe tek i siguruari me aftësi të mbetur për punë i cili për shkak të arritjes së një moshe të caktuar nuk mund që me rehabilitim profesional të aftësohet për të kryer ndonjërin nga veprimtaritë e tjera përkatëse dhe fiton të drejtën e pensionit invalidor në bazë të dy të dhënave;
- E drejta e pensionit familjar është pension familjar i cili realizohet nga siguruesi i ndjerë dhe të drejtën e pensionit e gëzon bashkëshortja ose bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit që janë në kategori kur i ndjeri i siguruar i kishte ushqyer nën kushtet e përcaktuara ligjore (paaftësi për punë, të meta mendore psikike dhe fizike etj.);
- E drejta e rehabilitimit profesional, e drejtë e cila i takon çdo të siguruari që është në kategori të paaftësisë së plotë për veprimtari dhe posedon dokumentacion mjekësor për rehabilitim;
- E drejta e kompensimit në të holla, është e drejtë e cila i takon çdo të siguruari i cili gjatë kryerjes së veprimtarisë ka pësuar ndonjë dëmtim fizik;

- E drejta e shumës më të ulët të pensionit, e drejtë e cila është e përcaktuar me ligj pensioni minimal për mbijetesë (Raporti aktuar i Fondit Pensional Invalidor i Republikës së Maqedonisë).

Pas reformës pensionale kolona e obliguar shtetërore ka filluar të stabilizohet në procesin e funksionimit të plotë.

Kolona II e obliguar e kapitalit financiar të sigurimit pensional tanimë vetëm se është e implementuar dhe në vazhdimësi pranon aktivitete shtesë, kjo reformë në mënyrë të shkëlqyer ka përparuar dhe vazhdon të përparojë.

Kolona III vullnetare, funksionon në bazë vullnetare investimin e mjeteve individuale, kjo shtyllë po sjell risi në tregun shoqëror.

Pagesa e pensionit shlyhet njëherë në muaj, pension të cilin e tërheq vetë i pensionuari në bankë komerciale. Shoqëria pensionale private i transferon mjetet pensionale në agjencinë bankare që është e përcaktuar nga drejtoria rajonale e sigurimit pensional privat dhe i pensionuari tërheq pensionin duke paraqitur edhe njërin nga dokumentet e identitetit (*Kepi, 2003: 81*). Në rastet kur i pensionuari është i paaftë, kur kryen heqje lirie apo është jashtë shtetit, gëzon të drejtë të autorizojë dhe persona të tjerë, të cilët janë pjesë e afërt e familjes për ta tërhequr pensionin. Në rastet kur i pensionuari shumën e pensioneve e depoziton në banka të ndryshme, atëherë pensionistët depozitues përfitojnë interesa bankare sipas shumave të depozituara për kohën e qarkullimit të mjeteve monetare në banka dhe përqindje të interesit që jep banka në ⁴denarë (*Kepi, 81-83*). Pensioni në Republikën e Maqedonisë paguhet gjatë gjithë kohës që i pensionuari është gjallë. Në rastet kur i pensionuari ka tërhequr pensionin në fillim të muajit dhe vdes nga datat e fundit të muajit, Fondi për Sigurim Pensional Invalidor në Republikën e

⁴ Valutë kombëtare e Republikës së Maqedonisë-autorja Vjollca Sulejmani Asani.

Maqedonisë nuk kërkon nga trashëgimtarët vlerën e pensionit të ditëve të marra më tepër që të kthehen në Fondin Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë (*Kepi, 2003: 81-83*).

KAPITULLI I IV

FUNKSIONIMI I PLANIT SHTETËROR TË PENSIONEVE DHE SHOQËRISË PENSIONALE PRIVATE

Në kapitullin e katërt të punimin është trajtuar roli i aktuarëve në planet pensionale, rezultatet e arritura financiare gjatë funksionimit të Fondit për Sigurim Pensional Invalidor në Republikën e Maqedonisë në periudhën para reformës dhe pas reformës, si dhe rezultatet financiare të Shoqërive Pensionale Private nga themelimi i tyre 2006 e deri në vitin 2013.

4.1. Roli i aktuarëve në planet pensionale

Kapitali financiar i sigurimit pensional funksionon me ndihmën e projeksioneve aktuariale. Shkenca aktuariale u bë një disiplinë formale matematikore në fund të shekullit XVII me rritjen e kërkesës për mbulimin e sigurimit afatgjatë, sigurim jete dhe anuitet. Shkenca aktuariale ndihmon që të implementohet kapitali financiar i sigurimit pensional, e cila është disiplinë që aplikon metoda matematikore dhe statistikore për të vlerësuar rrezikun në sigurime pensionale, rrezikun në financa, në industri dhe profesione të tjera. Historikisht shkenca aktuariale përdor metodat determinante për të ndërtuar tabelat për vlerësim pensional dhe ato të vdekshmërisë.

Në industrinë e pensioneve metodat aktuariale janë përdorur dhe përdoren për të matur koston e strategjive alternative në lidhje me projektimin, financimin, kontabilitetin, administrimin dhe ridizajnimin e planeve të pensioneve.

Aktuar është një individ i cili është i bazuar në shkollimin e tij/saj, trajnimin dhe përvojën në pension. Aktuari/rja duhet të posedojë shkathtësi në bërjen e llogarive matematikore në lidhje me vlerësimin dhe financimin e programit të pensionit me benefite të definuara (pensione suplementare të definuara vetëm për një kategori të punëtorëve si psh: ushtria, policia, shërbimet e shtetit etj, *Autorja V.S*), ndërsa raporti aktuarial tregon gjendjen e mjeteve, detyrimeve dhe kërkesës për financim për pension me benefite të definuara duke i përdorur metodat, supozimet dhe të dhënat të shrytëzuara në arritjen e konkluzioneve aktuariale të udhëhequr nga eksperti/tja. (neni 5,23 tetor 2002, rregulla 15 mbi financimin dhe vlerësimin aktuarial të rregullimit pensional me benefite të definuar)

Pasqyrat financiare aktuale përbëjnë informacionet për njërin prej formave praktike të dhënies së burimeve aktuariale.

Pasqyrat financiare janë:

- Një pasqyrë që përfshihen të dhënat financiare dhe që paraqesin aktivën neto të vlefshme për përfitime, vlerën aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuar në tepriçë apo deficit.
- Pasqyrat financiare të skemës përmbajnë pasqyrën e ndryshimeve në aktivën neto të të dhënave për përfitim dhe ndryshim në vlerën aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuar.
- Pasqyrat financiare mundet të shoqërohen me një raport të aktuarit i cili raport paraqet argumentimin e vlerës aktuariale të përfitimeve për pension të premtuar (*IAS 26, SNK 26- Standardi ndërkombëtar i kontabilitetit 26, Kontabiliteti dhe raportimi për skemat e përfitimeve për pension, 1 Janar, 1998*).

Bërja e projeksioneve aktuariale përfshin një sërë hipotezash rreth së ardhmës,

periudha të projeksioneve, rishikim i hipotezave. Hipotezat merren nga eksperiencia e skemave statistikore kombëtare dhe ndërkombëtare. (*Drejtimi i sigurimeve shoqërore ILO, udhëzues praktik për anëtarët e këshillit drejtues të institucioneve të sigurimit shoqëror në Europën Qendrore dhe Lindore, 154*)

Aktuari do të fillojë punën duke vendosur bashkë me statistikatat në lidhje me popullsinë aktive të siguruar dhe përfituesit e skemave. Informacionet statistikore zakonisht merren nga aktiva e vetë institucioneve dhe në këtë mënyrë familjarizohet me programet kompjuterike, në bazën e të dhënave që tashmë ekzistojnë. Nëse gjatë analizës paraqitet boshllëk, atëherë duhet të bëhen vlerësime në mënyrë që të adresohen këto probleme dhe aktuari do të vlersojë se sa të qëndrueshme janë statistikatat me informacionet e tjera të përshtatshme, të cilët janë të huazuara nga burimet e ndryshme. Në raportin përfundimtar, aktuari do të përshkruajë të dhënat e përdorura dhe komente përsa u përket mjaftueshmërisë, saktësisë dhe besueshmërisë. Produkti final i aktuarit do të jetë një raport vjetor i drejtuar udhëheqësisë së fondit pensional privat. Në raport janë të përfshira rezultatet nga të ardhurat, shpenzimet dhe vlersimet e skemave në intervale të ndryshme të përshtatshme për që të dy periudhat, atë të së kaluarës dhe atë të projeksioneve, gjithashtu aktuari në raport do të krahasojë gjetjet e tanishme me ato të raporteve të mëparshme me shpjegime rreth ndryshimeve domethënëse në hipoteza apo në rezultate vjetore. (*Drejtimi i sig.shoq, ILO, udhëzues praktik për anëtarët e këshillit drejtues të institucioneve të sigurimit shoqëror në Europën Qendrore dhe Lindore, 155*)

Njësia aktuale kryen detyrimet e rregullta të planifikuara në programin e punës, si dhe të gjitha aktivitetet e jashtëzakonshme. Në kuadër të detyrimeve të rregullta, është kryer azhurnimi i modelit aktuar, i cili shfrytëzohet si një mjet për përgatitjen e projeksioneve afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata për sistemin pensional. Për azhurnimin e modelit

të dhënat për pensionistët dhe të sigurvearit si dhe parametrat financiarë për punën e fondit sigurohen nga baza e të dhënave të fondit dhe seksioni për koordinimin buxhetor, të dhënat demografike sigurohen nga Enti shtetëror për statistikë, ndërsa indikatorët makroekonomik nga Ministria e Financave.

4.2. Funksionimi i Fondi për Sigurim Pensional në Republikën e Maqedonisë

Sigurimi pensional në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2014 ishte i zhvilluar në mbështetje me politikën e parashikuar makroekonomike të Republikës së Maqedonisë dhe mjetet e planifikuara me buxhetin e Fondit për sigurim pensional invalidor të Republikës së Maqedonisë. Për të parë se si kishte funksionuar fondi për sigurim pensional në Republikën e Maqedonisë para reformës/pas reformës dhe për të parë arritjet financiare, së pari duhet të shohim strukturën demografike të popullatës përmes lindjeve të reja, tregun e punës-të sigurvearit dhe tregun financiar-arritjet e efekteve financiare të reformës pensionale.

4.2.1 Tregu i punës

Në Maqedoni pas vitit 1998 shkalla e papunësisë kishte arritur në 35% e popullatës të ishin të papunë. Tregu i punës pas vitit 1999 nuk ishte fiks, ndikuan shumë faktorë si ai ekonomik, politik, social që tregu në vazhdimësi të zgjerohet dhe të rritet numri i të punësuarve qoftë në sektorin shtetëror edhe në atë privat. Forca e tregut të punës ka ndikuar që shtresa e të rinjve të punësuar të financojë personat në moshën e mplekjes.

Në tregun e punës institucionet dhe ndërmarrjet kanë qëllim punësimin e të rinjve nga shkaku që në kalkulim paga e një të riu është më e ulët në raport me një të moshuar,

i cili në vete ka përvojën e punës dhe me automatizëm bart edhe pagën më të lartë, mirëpo në mungesë kuadri apo profesionalizmi atëherë aplikohet që në mungesë të kuadrit të ri, të vazhdojë punën personi i moshuar dhe i pensionuar, edhe pse kjo udhëheqje krijon komponent negativ në treg duke filluar nga zvogëlimi i përqindjes së të papunëve e deri te tatimet dhe obligimet financiare ndaj shtetit.

Në bazë të analizës së tregut të punës nga agjencioni për punësim në Republikën e Maqedonisë afarojnë 569.000 punëtorë në marrëdhënie të rregullt pune, ku prej tyre vetëm 390.000 paguajnë kontribute në sigurimin pensional invalidor në Republikën e Maqedonisë.⁵ Pritet që sistemi i reformuar pensional me kapital të financuar, për afër 25-50 vite të përfshijë të gjithë popullatën e punësuar në anëtarësimin e Kolonës së II-të Pensionale dhe të përfshijë të gjithë tregun e punës, që njihet si vektor pozitiv në të hyrat e fondit pensional dhe shoqërisë pensionale.

Në kushte ekonomike të tregut të punës, nuk është karakteristike të ofrohet kujdes i madh nëse kontributet pensionale janë paguar nga ana e punëmarrësit ose punëdhënësit. Kontributet e detyrueshme të paguara për punëdhënësin në parim kanë efektë të zvogëlimit të pagave të cilët i ofrojnë punëmarrësve, punëdhënësit i paguajnë shpenzimet e kontributeve duke i ofruar pagë më të ulët.

Në aspekt të tregut të punës parashtrohen disa dilema dhe pyetje:

- Numri i të punësuarve në tregun e punës nuk është fiks;
- Shumë skema pensionale motivojnë në pensionimin e parakohshëm;
- Kërkesa nga forca e tregut të punës nga punëtorët më të moshuar pikërisht pensionistë.

⁵ www.piom.gov.mk

Shumë skema pensionale motivojnë në pensionimin e parakohshëm, për atë edhe po reformohen pensionet dhe forma e pensionimit, pikërisht në moshën dhe në kushtet e plotësuara të pensionimit parakohe ose paskohe në pensionim, që kupton një vlerë më të madhe neto me qëllim të punësimit të të rinjve, pasi që në kontiunitet po rritet kërkesa e tregut të punës nga tregu i punëtorëve më të moshuar.

Tabela nr. 7 Shkalla e papunësisë e shprehur në %

viti	Papunesia %
1996	31.90%
1997	36.01%
1998	34.50%
1999	32.40%
2000	32.20%
2001	30.50%
2002	31.90%
2003	36.70%
2004	37.20%
2005	37.30%
2006	36.02%
2007	34.90%
2008	33.80%
2009	32.20%
2010	32.00%
2011	31.40%
2012	31.00%
2013	29.00%

Burimi: Qendra për Statistikë në Republikën e Maqedonisë


Në Tabelë është matur shkalla e papunësisë e shprehur në %, në të shihet se papunësia në vitin 1996 para reformës pensionale ishte në 31,90% e popullatës e papunë, ndërsa prej vitit 1997 e deri në vitin 2011 përqindja e papunësisë shënoi rritje, ndërsa në vitin 2013 shkalla e papunësisë paraqitet me % më të ulët për 2,90% krahasuar me vitin e parë para reformës pensionale. Nga kjo tabelë shohim se përqindja e papunësisë në nivel republikan është në ulje.

4.2.2 Parashikimet demografike në reformën pensionale

Reforma pensionale është e menduar të bëhet si shkak i rritjes së përqindjes së implakjes së popullatës, e cila përqindje po rritet çdo vitë dhe faza e implementimit të reformës pensionale të korigjoj jostabilitetin financiar afatgjatë pensional.

Në vazhdim është paraqitur grafiku ku shihet analiza dhe struktura e ndryshimit të popullatës.

Grafiku 1. Struktura e ndryshimeve të popullatës



Burimi: www.piom.gov.mk

Në Grafikon 1. për ilustrim kemi 35 - 85 vitet e ardhshme me moshë mbi 60 vjet ku fenomen botëror është mortaliteti. Nga grafiku shohim se në Republikën e Maqedonisë po zvogëlohet numri i lindjeve që dmth në të ardhmen pritet që numri i pensionistëve të jetë më i madh se numri i të siguarve. Gjithashtu, këtu luan rol stabiliteti ekonomik dhe zvogëlimi i numrit të të punësuarve dhe të të siguarve, ndërsa për përlllogaritje financiare


shumë është e rëndësishme numri i të siguarve dhe pensionistëve nga shkaku që kontributet e të punësuarve paguajnë pensionet e pensionistëve. Nga grafiku që është paraqitur për strukturën e moshës së popullsisë, shohim që ndërlidhja e këtyre dy grupeve të moshës po rritet nga 25,6 në vitin 2005 në 63,01 në vitin 2057 dhe bie në 49,7 në vitin 2100. Kjo mplakje e popullatës do të ndikojë dukshëm në shtimin e numrit të pensionistëve, nga shkaku se sa më i lartë që është numri i popullatës së mplakur, aq më e lartë do të jetë numri i pensionistëve⁶.

Në Maqedoni marrëdhëniet në mes të personave mbi 60 vjet me personat e moshë 18 - 59 është paraparë të rritet prej 24 - 34% në vitin 2020, në vitin 2030 (42%) dhe deri në vitin 2050 do të arrij në 55% ⁷.

⁶ www.piom.gov.mk

⁷ Burime nga Enti Statistikor I Republikës së Maqedonisë.

Grafiku.2 Parashikimet për mplakjen e popullatës




Burimi: www.mapas.gov.mk

Në Grafikun nr. 2 është e paraqitur parashikimi për mplakjen e popullsisë, struktura e popullsisë në këtë rastë është e paraqitur në piramidë, ku është paraqitur numri i popullatës, mosha dhe gjinia deri në vitin 2100, në të shohim që në vitin 2040 gjeneratat e reja paraqiten me numër më të vogël të shtimit të popullsisë dhe në mënyrë absolute do të dominojnë individë të moshuar⁸. Nga grafiku vërehet se në Maqedoni ekziston trendi i mplakjes së popullatës, kjo sjell deri në rritje numrit të personave të moshuar në popullsinë e përgjithshme, në realitet ndryshimet e marrëdhënieve mes pensionistëve dhe punëtorëve të siguruar.

⁸ www.mapas.gov.mk

Grafiku. 3 Krahاسimi i popullatës prej 18-64 dhe 65+



Burimi: www.piom.gov.mk


Tregues për mplakjen e popullsisë është krahاسimi i popullatës së vjetër me popullatën e aftë për punë. Në grafikonet e mësipërme është paraqitur krahاسimi i popullatës së vjetër me popullatën e aftë për punë dhe lëvizja e këtij krahاسimi në të tre skenarët. Krahاسimi i këtyre dy grupeve të popullatës rritet nga të tanishmet 18,9% në 49,9% në vitin 2060 dhe reduktohet deri në 44,1% në vitin 2080. Kjo do me thënë se në të ardhmen rreth gjysma e popullatës mbi 18 vjeç do të jetë popullatë e vjetër.

Sipas skenarit optimist arrin maksimumin prej 45,4% në vitin 2060 që në vitin 2080 të reduktohet në 36,7%. Në skenarin optimist krahاسimi lëviz nga 53% maksimumin në vitin 2070 deri më 50% në vitin 2080. Sipas tre skenarëve ekziston mplakja e popullatës në afat më të gjatë.

4.2.3 Numri i të sigurve dhe pensionistëve

Efektet e reformës pensionale i masim pikërisht nga numri i të sigurve dhe pensionistëve. Nga shkakuqë nga numri pjesëmarrës i të sigurve përcakton të ardhurat e pensioneve dhe fondeve pensionale ndërsa numri i pensionistëve i përcakton shpenzimet për pensione nga fondet pensionale.


Grafiku.4 Numri i te sigurve nga 1991 - 2013




Burimi: Autorja V. Sulejmani

Në grafikun lartë është paraqitur numri i të sigurve prej vitit 1991 deri në vitin 2013, pikërisht është paraqitur numri i të sigurve prej periudhës para reformës pensionale e deri në 10 vjetët e para të funksionimit të saj. Është e shpjeguar edhe në historikun e pensioneve në Maqedoni se destabilizimet e para për qëndrueshmëri të ulët se sistemi pensional i kishte shfaqur në vitin 1995 - 2001, pikërisht nga shkak që numri i kontribuesve në skemën pensionale kishte filluar dukshëm të zvoglohet si pasojë e tregut të punës dhe uljes së punësimeve të reja, ndërsa për këtë periudhë numri i pensionistëve po rritej. Në periudhën pas reformës të vitit 2003 shihet një lëvizje drejt rritjes së numrit të të sigurve. Në vitin 2007 - 2009 në periudhën e pensioneve të reformuara prap kishte filluar të ulet numri i të sigurve si pasojë e tregut të punës, mirëpo prej vitit 2010 - 2013 shihet se numri i të sigurve në skemën pensionale kishte arritur në 595.687 të sigurve.

Grafiku.5 Numri i të siguruarve deri në moshën 40 vjet dhe të siguruarit prej 40 deri në 60 vjet



Burimi: Autorja V.Sulejmani




Burimi: Autorja V.Sulejmani

Në grafik është paraqitur lëvizja e numrit të të sigurve prej vitit 1996-2013 duke filluar të matet numri i të sigurve deri në moshën 40 vjet dhe të sigurve prej 40 deri 60 vjet. Nga grafiku shohim se numri total i të sigurve në dy situatat e lartpërmendura arrin afër 600.000 të sigurve. Nga gjithsej numri i të sigurve në skemën pensionale shohim se numri i të sigurve në skemën pensionale në moshë deri 40 vjet ka arritur deri në 596.000 të sigurve për krahasim me numrin e të sigurve prej moshës 40 - 60 numri i të cilëve kishte arritur në 218.756 të sigurve. Ky dallim në dy situata është paraqitur për shkak të tregut të punës të cilët kishin paraparë se me reformën e re të pensioneve të përfshihet në skemën pensionale mosha e anëtareve të moshës së re nga


shkaku që norma kontribuese për të siguruarit e rinj është më e ulët për krahasim me ato të moshës 40-60 vjet.

Grafiku.6 Numri i të siguruarve sipas gjinisë



Burimi: Autorja V.Sulejmani

Grafiku.7 Numri i të siguruarve sipas gjinisë



Burimi: Autorja V.Sulejmani

Në grafik është paraqitur numri i të siguruarve i ndarë sipas gjinisë meshkuj 40 - 60 vjet dhe femra 40-60 vjet prej vitit 1996 - 2013. Nga grafiku shihet se numri i të siguruarve në përgjithsi është më i lartë për gjininë mashkullore. Prej vitit 1996 deri në vitin 1999 numri i të siguruarve për femra kishte lëvizur nga 90.000 në 110.000 të siguruara ndërsa pas vitit 2004 numri i të siguruarve femra kishte mbajtur pothuajse një numër të njejtë të të siguruarve. Për dallim të situatës së parë të gjinisë femërore, numri i të siguruarve në skemën pensionale për gjininë mashkullore kishte lëvizur në vitet e para parareformuese ku në vitin 1998 numri i kontribuesve në skemën pensionale shënoj ulje dhe më pas prej


vitit 2000 e deri në vitin 2013 numri të siguruarve për gjininë mashkullore kishte arritur në 238.900 sigures - kontribues.

Tabela.8 Projektione për të siguruarit në periudhë afatgjatë

Të siguruarit						
Viti/skenari	Kolona e parë (gjithsej)			Kolona dytë		
	optimist	Bazik	Pesimist	Optimist	bazik	Pesimist
2014	553,497	544,634	538,356	370,794	364,857	360,651
2015	574,089	559,829	550,686	404,106	394,065	387,625
2016	593,308	577,063	565,683	440,845	425,175	416,780
2017	625,260	596,852	579,521	479,932	458,090	444,763
2018	653,596	617,490	593,897	521,756	492,868	473,992
2019	683,394	639,016	608,832	565,503	528,679	503,639
2020	693,102	661,475	624,351	593,182	565,970	534,109
2025	731,703	698,869	638,260	719,408	686,719	626,936
2030	764,975	725,728	645,185	833,413	790,071	702,109
2035	746,680	709,133	630,715	870,143	825,954	734,428
2040	730,486	693,772	616,720	879,584	835,246	742,435
2045	708,138	671,775	596,244	860,607	816,641	724,946
2050	676,993	640,773	567,344	811,714	768,652	680,767
2055	642,255	606,104	535,068	750,084	707,978	625,066
2060	613,156	576,669	507,383	711,261	668,936	588,565
2065	597,013	559,099	489,830	692,535	648,555	568,202
2070	592,312	551,737	480,727	687,082	640,015	557,644
2075	591,512	547,435	473,771	686,154	635,025	549,574

Burimi: www.piom.mk

Grafiku.8 Krahasimi i të siguruarve në tre skenarët



Burimi: www.piom.gov.mk


Lëvizja e ardhshme e numrit të të sigurve dhe pensionistëve sipas skenarit bazik si dhe krahasimi i tyre është paraqitur në këtë grafik. Nga grafiku mund të vërehet se në periudhën fillestare të projeksioneve deri në vitin 2020 numri i të sigurve rritet, ndërsa pas vitit 2020 numri i të sigurve fillon të ulet për shkak të lëvizjeve demografike dhe stabilizimit të rritjes ekonomike. Numri i pensionistëve në mënyrë të vazhdueshme rritet në 50 vitet e ardhshme, pastaj reduktohet. Krahasimi mes të sigurve dhe pensionistëve nga të tanishmit 1,8% të sigurve në një pensionist në afat më të gjatë reduktohet në 1,2% të sigurve në 1 pensionist. Ky trend i krahasimit do të thotë se gjithnjë e më pak të sigurve do të paguajnë për një numër më të madh të pensionistëve.

4.2.4 Numri i Pensioneve sipas llojit

Në Republikën e Maqedonisë, në bazë të Ligjit për Sigurim Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë, ekzistojnë tre lloje të pensioneve, e ato janë:


- Pension pleqërie,
- Pension invaliditeti dhe
- Pension i trashëguar ose pension familjar.

Grafiku Nr. 9 Pensionet sipas llojit



Burimi: Autorja V.Sulejmani

Grafiku Nr. 10. Pensionet sipas llojit



Burimi: Autorja V.Sulejmani

Në grafik lartë është paraqitur numri i pensionistëve sipas llojit prej vitit 1991 deri në vitin 2013, për tre lloje të pensioneve: pensione familjare, pensione invalidore dhe pensione të pleqërisë. Në grafik shihet se numri i pensionistëve të pensionit familjar ishte në rritje ku numri i pensioneve të po këtij lloji prej vitit 1991 - 2013 kishte lëvizur nga 50.000 në 70.000 pensione familjare, ndërsa pensionet e llojit të invaliditetit prej vitit 1996 kishin filluar të rriten pastaj në vitin 2005 kishin pësuar rënie nga shkak i ndryshimit legjislativ dhe kushteve rigoroze për invaliditet ndërsa pensionet e pleqërisë prej vitit 1996 e deri më vitin 2013 numri i pensionistëve ishte në rritje të vazhdueshme duke filluar nga 198.700 në 289.756 pensionistë të llojit të pensionit pleqërisë nga shkak i strukturës demografike dhe shtimit të popullatës së vjetër.

Tabela Nr. 9 Numri i të siguruarve dhe pensionistëve prej reformës e deri më 2013

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Të siguruarit	3327 28	3211 05	3482 12	47017 9	46522 5	498.6 53	448.1 23	518.0 35	407.8 87	518.0 35	595.6 87
Pensionis tët	2542 67	2600 75	2651 52	26968 1	27269 6	27328 1	27397 6	27371 5	27744 1	28233 4	28911 4
Balanca	78,46 1	61,03 0	83,06 0	200,2 49	192,5 29	225,3 72	174,1 47	244,3 20	139,4 46	235,7 01	306,5 73

Burimi: Autorja V.Sulejmani

Në tabelën e mësipërme është paraqitur numri i të siguarve dhe pensionistëve prej vitit 2003 deri më vitin 2013 ku është bërë edhe krahasimi i tyre me qëllim për të matur efektet financiare në reformë. Një faktor shumë i rëndësishëm i cili na ndihmon të masin efektin financiar është edhe numri i kontribuesve në skemën pensionale nga që kontribuesit paguajnë pensionet e realizuara (pensionistëve). Nga tabela e paraqitur vërehet se prej fillimit të reformës të vitit 2003 numri i kontribuesve në skemën pensionale është shumë më i lartë se sa numri i pensionistëve. Në fillim te reformës numri i të siguruarve ishte më i lartë për 78.461 ndërsa në vitin 2013 numri i kontribuesve arrin 306.573 kontribues në skemën pensionale. Nga kjo shohim se reforma e pensioneve në Republikën e Maqedonisë jep efekte financiare pozitive. (Kur themi efekte financiare pozitive themi për 10 vitet e para nga egzistenca e saj dhe ky kalkulim është edhe kalkulim afatshkurtër).


Tabela Nr. 10 GDP për frymë banori në Euro

Viti	GDP për frymë banori, e shprehur në Euro
1990	2235
1991	2083
1992	1937
1993	1785
1994	1742
1995	1705
1996	1709
1997	1732
1998	1781
1999	1848
2000	1924
2001	2036
2002	2099
2003	2164
2004	2252
2005	2470
2006	2682
2007	2982
2008	3308
2009	3300
2010	3459
2011	3665
2012	3680
2013	3948

Burimi: Qendra për statistikë në Republikën e Maqedonisë

Në tabelë është e paraqitur GDP për frymë banori e shprehur në Euro; nga tabela shohim se në Republikën e Maqedonisë GDP kishte lëvizur drejt rritjes, në vitin 1990 GDP për frymë banori ishte 2.235 Euro ndërsa në vitin 2013 GDP kishte arritur në 3.948 euro për banori.

Grafiku Nr.11 Të dalat për pensione si pjesë e GDP



Burimi: Autorja V.Sulejmani


Në grafik janë paraqitur të dalat e pensioneve si pjesë e GDP dhe në të shohim se të dalat rriten në fillim të vitit 1994 dhe arrijn në 16 shkalla e GDP, ndërsa prej vitit 1996 e deri në vitin 2013 ka filluar të ulet GDP nga shkaku që Republika e Maqedonisë që atëher kishte filluar në kontiunitet ta reformonte sistemin pensional.

Tabela Nr. 11 Projektione për pensionistët dhe krahasimi ndërmjet të siguruarve dhe pensionistëve në periudhë afatgjate

Pensionistët dhe krahasimi ndërmjet të siguruarve dhe pensionistëve						
Viti/skenari	Pensionistë			Krahasimi ndërmjet të siguruarve dhe pensionistëve		
	Optimist	Bazik	Pessimist	optimist	bazik	Pessimist
2014	299,328	299,359	299,384	1,92	1,87	1,84
2015	304,366	304,517	304,643	1,97	1,90	1,86
2016	309,357	309,708	310,003	2,02	1,93	1,87
2017	314,413	315,039	315,564	2,08	1,96	1,88
2018	319,421	320,389	321,197	2,14	1,99	1,90
2019	324,137	325,504	326,644	2,14	2,03	1,91
2020	347,571	351,702	354,707	2,11	1,99	1,80
2025	369,485	377,427	382,205	2,07	1,92	1,69
2030	388,878	401,239	406,822	1,92	1,77	1,55
2035	410,695	427,568	432,390	1,78	1,62	1,43
2040	435,341	455,685	458,782	1,63	1,47	1,30
2045	461,277	483,222	484,119	1,47	1,33	1,17
F2050	484,443	506,784	505,255	1,33	1,20	1,06
2055	496,792	519,290	516,075	1,23	1,11	0,98
2060	492,504	515,556	511,651	1,22	1,08	0,96
2065	476,613	500,480	496,360	1,24	1,10	0,97
2070	461,120	485,202	480,571	1,28	1,13	0,99
2075	295,146	295,144	295,141	1,28	1,85	1,82

Burimi: www.piom.mk

Grafiku nr. 12 Projektione afatgjate për të siguruarit dhe pensionistët



Burimi: www.piom.gov.mk

Në grafik është paraqitur lëvizja e ardhshme e numrit të të sigurve dhe pensionistëve sipas skenarit bazik si dhe krahasimi i tyre. Nga grafiku mund të vërehet se në periudhën fillestare të projeksioneve deri në vitin 2020 numri i të sigurve rritet, ndërsa pas vitit 2020 numri i të sigurve fillon të ulet për shkak të lëvizjeve demografike dhe stabilizimit të rritjes ekonomike.


Numri i pensionistëve në mënyrë të vazhdueshme rritet në 50 vitet e ardhshme pastaj reduktohet. Krahasimi mes të sigurve dhe pensionistëve nga të tanishmit 1,8% të sigurve në një pensionist në afat më të gjatë reduktohet në 1,2% të sigurve në 1 pensionist. Ky trend i krahasimit do të thotë se gjithnjë e më pak të sigurve do të paguajnë për një numër më të madh të pensionistëve.

Tabela Nr. 12 Projektione afatgjatë për shpenzimet për pension

Shpenzime për pensione								
Viti/skenari	Në proporcion me BPV			Në milion denarë (vlera e tanishme)				
	Optimist	Bazik	pesimist	Optimist	bazik	pesimist	bazik	Pessimist
2014	9,63 %	9,75 %	9,82 %	45,662	45,273	45,169	736	734
2015	10,7 %	10,94 %	11,10 %	52,920	52,252	52,047	850	846
2016	10,6 %	11,02 %	11,25 %	55,308	54,425	54,108	885	880
2017	10,30 %	10,78 %	11,08 %	56,205	55,134	54,712	896	890
2018	9,94 %	10,53 %	10,91 %	57,190	55,930	55,404	909	901
2019	9,59 %	10,28 %	10,73 %	58,225	56,778	56,157	923	913
2020	9,52 %	10,02 %	10,53 %	59,295	57,658	56,928	938	926
2025	9,29 %	9,88 %	10,63 %	66,174	63,504	62,042	1,033	1,009
2030	8,89 %	9,62 %	10,52 %	74,337	70,512	67,928	1,147	1,105
2035	8,47 %	9,27 %	10,20 %	82,060	76,968	72,822	1,252	1,184
2040	8,04 %	8,90 %	9,80 %	90,485	83,740	77,398	1,362	1,259
2045	7,56 %	8,45 %	9,31 %	98,043	89,282	80,488	1,452	1,309
2050	7,02 %	7,91 %	8,74 %	103,401	92,400	81,351	1,502	1,323
2055	6,63 %	7,49 %	8,29 %	109,948	95,918	82,320	1,560	1,339
2060	6,59 %	7,41 %	8,18 %	124,007	104,767	87,144	1,704	1,417
2065	6,42 %	7,20 %	7,92 %	139,507	114,272	92,161	1,858	1,499
2070	6,14 %	6,89 %	7,58 %	157,360	125,208	97,931	2,036	1,592
2075	5,96 %	6,70 %	7,37 %	181,132	140,057	106,212	2,277	1,727

Burimi: www.piom.mk

Grafiku nr.13 Shpenzimet tranzitive në krahasim me buxhetin



Burimi: www.piom.gov.mk

Në të dhënat tabelare në grafikun më lartë janë paraqitur shpenzimet tranzitive në krahasim me buxhetin. Nga grafiku mund të vërehet një reduktim gradual i shpenzimeve për pensione në tre skenarët. Kjo ka të bëjë me dy faktor, reduktimin e obligimeve të fondit për shkak të reformave parametrike dhe reduktimin gradual të shkallës zëvendësuese të pensioneve prej 80% në 72% për të siguruarit që do të mbesin vetëm në Shtyllën e Parë. Në skenarin bazik shpenzimet për pensione reduktohen prej 8,53% nga BPV në 6,64% nga BPV në fund të periudhës së projeksionit.

Shpenzimet tranzitive janë të karakterit të përkohshëm dhe do të zhduken me kalimin e kohës. Ato fillojnë të ulen në vitin e parë të reformës dhe gradualisht rriten, prandaj në vitin 2050 pritët të arrijnë një nivel prej 1,43% të buxhetit. Maksimumin e tyre prej 1,78% nga buxheti e arrijnë në vitin 2028, në të cilën periudhë do të rritet pjesëmarrja e fuqisë punëtore në Shtyllën e Dytë dhe kështu deflaksi i kontributeve nga Kolona e Parë do të jetë i rëndësishëm. Shpenzimet tranzitive do të zhduken në vitin 2045 atëherë kur do të ndriçojë Kolona e Dytë me ç'rast barra e financimit të pensioneve kryesisht bartet në kolonën e dytë ndërsa ka ndikim të drejtpërdrejtë në reduktimin e shpenzimeve për

pensionet në kolonën e Parë. Shpenzimet transitive menaxhohen më shumë nga demografia, se sa nga ekonomia. Në skenarin optimist kanë vlera më të larta se sa në atë pesimist, nga arsye të thjeshta ku parametrat ekonomik janë më të mirë në atë skenar, buxheti dhe rritja e pagave është gjithashtu më e lartë, që do të thotë se kapaciteti për financimin e shpenzimeve është më i lartë, ndërsa në skenarin pesimist është e kundërta.


4.3 Struktura e të hyrave dhe shpenzimeve të Fonfit për Sigurim pensional

Invalidor në Republikën e Maqedonisë

Fondi në vitit 2013 realizoj gjithsej te hyra 51.070,23 milionë denarë dhe gjithsej të dala prej 50.854,76 milionë denarë, këtu është paraqitur tepricë e të hyrave mbi të dalat në shumë prej 215,47 milionë denarë. Me të hyrat e realizuara nga kontributet dhe mjetet e buxhetit të vendit si dhe nga të hyrat e tjera, Fondi pensional në vitin 2013 në mënyrë të rregullt ka kryer pagesën e pensioneve në periudhën e caktuar. Në vitin 2013 është kryer harmonizim i rregullt i pensioneve në mbështetje me dispozitat ligjore edhe atë: 1,15% prej 1 Janarit harmonizim plotësues prej 5%, përkatsisht në shumën nominale prej 550 denarë nga muaji shkurt për të gjithë shfrytëzuesit e pensionit të cilët të drejtën e kanë realizuar në shkurt të vitit 2013 dhe 0,75% prej 1 korrikut të vitit 2013.

Grafiku Nr. 14 Struktura e të hyrave dhe shpenzimeve të Fondit për Sigurim

Pensional të Republikës



Burimi: www.piom.gov.mk

Tabela Nr. 14 Numri i të siguruarve në vitin 2013

Nr. Rendor	Njësia	Të obliguar	Të siguruar
1	Berovë	552	3.072
2	Manastir	4.098	27.203
3	Vallandovë	359	2.279
4	Veles	1.928	12.100
5	Vinicë	504	4.459
6	Gjevgjeli	1.501	10.221
7	Gostivar	3.085	12.201
8	Dibër	543	2.485
9	Dellçevë	735	5.234
10	Demir Hisar	264	1.405
11	Kavadar	1.650	11.253
12	Kërçovë	1.771	6.050
13	Koçanë	1.561	9.837
14	Kratovë	224	1.355
15	Kriva Pallankë	503	3.465
16	Krushevë	257	891
17	Kumanovë	3.645	20.956
18	Makedonski Brod	276	1.112
19	Negotinë	917	5.153
20	Ohër	2.570	15.598
21	Prilep	3.260	20.118
22	Probishtip	361	3.384
23	Radovish	1.051	4.938
24	Resnjë	494	2.910
25	Shën Nikollë	841	4.207
26	Strugë	2.262	9.826
27	Strumicë	3.082	19.235
28	Tetovë	4.496	24.034
29	Shtip	1.877	21.024
30	Shkup	25.797	260.904
Gjithsej		70.464	526.909

Burimi: www.piom.gov.mk

Në tabelën lartë është paraqitur numri i përgjithshëm i të siguruarve dhe numri i të obliguarve, nga tabela shohim se në vitin 2013 numri i të siguruarve ka arrit në 526.909 të siguruar dhe 70.464 të obliguar.

**Tabela nr.14 Shkalla e rritjes së pensionistëve prej vitit 1991 - 2013
sipas llojit të pensionit**

Vitet	Përfitues të rinj të pensionit të pleqërisë	Përfitues të rinj të pensionit invalidor	Përfitues të rinj të pensionit familjar	Gjithsej
1992-1991	7,8	7,4	5,0	6,9
1993-1992	11,6	6,9	5,2	8,9
1994-1993	2,5	3,7	3,5	3,0
1995-1994	-0,3	2,3	3,3	1,1
1996-1995	0,7	2,0	3,0	1,6
1996-1991	23,6	24,1	21,7	23,2
1997-1996	1,0	3,1	3,1	2,0
1998-1997	0,9	3,7	3,0	2,3
1999-1998	1,2	1,7	2,3	1,6
2000-1999	3,0	0,9	2,0	2,3
2001-2000	3,3	0,1	2,8	2,5
2002-2001	1,0	-0,2	1,5	0,9
2003-2002	2,6	-0,5	2,6	1,9
2004-2003	3,6	-1,2	2,4	2,3
2005-2004	3,6	-2,7	2,1	2,0
2006-2005	2,8	-1,6	1,8	1,7
2006-1996	25,5	4,1	26,1	21,1
2007-2006	2,2	-2,7	1,1	1,0
2008-2007	-0,3	1,1	1,0	0,3
2009-2008	0,3	-1,3	1,2	0,3
2010-2009	1,2	-3,8	-0,3	-0,1
2011-2010	2,7	1,9	1	2,1
2012-2011	3,9	-2,8	0,1	2,9
2013-2012	4,5	-2,1	0,5	2,4

Burimi: www.piom.gov.mk

Edhe në vitin 2013 fluksi i përfituesve të pensionit invalidor edhe në vitin 2013 u reduktua si edhe në vitet e mëparshme për shkak të ndryshimeve në Ligjin për Sigurim Pensional dhe Invalidor.

Sipas të dhënave në tabelë del se në rritje është numri i përfituesve të pensionit edhe në vitin 2013 më shumë se gjysma apo (58,6%). Nga gjithsej numri i përfituesve të

pensionit janë përfitues të pensionit të pleqërisë, ndërsa pjesa e ngelur janë përfitues të pensionit familjar dhe invalidor.

**Tabela nr. 15 Numri i përfituesve të kompensimit pensional
i shprehur në para prej vitit 1997 – 2013**

Lloji i të drejtës Viti	Koha e pritjes për punë	Orarë i shkurtuar i punës	Pagë e ulët	Të ngelura	Gjithsej
1997	947	1196	1616	1016	4775
1998	946	972	1501	972	4391
1999	950	837	1364	910	4061
2000	897	573	1115	812	3397
2001	893	286	733	724	2636
2002	1035	200	616	676	2527
2003	1123	147	332	645	2247
2004	1180	130	265	488	2063
2005	1407	90	170	0	1667
2006	1659	63	106	0	1828
2007	1768	67	113	0	1948
2008	202	15	8	0	225
2009	183	14	9	0	206
2010	158	13	6	0	177
2011	145	16	10	0	171
2012	94	13	9	0	116
2013	95	13	9	0	117

Burimi: www.piom.gov.mk

Në vitin 2013 për përfituesit e kompensimit në para janë paguar mjete në vlerë prej 7,08 milionë denarë dhe janë në nivel të njëjtë me vitin 2012, ku janë paguar mjete në vlerë prej 7,24 milionë denarë.

Në periudhën prej vitit 2001 deri në vitin 2013 pensionet më së shumti u rritën në vitin 2008, për shkak të harmonizimit plotësues të pensioneve me Vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe vitin 2013 me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, që solli rritjen e vlerës reale të pensioneve dhe përmirësimin e sigurisë sociale dhe materiale të përfituesve të pensionit. Me

harmonizimet e kryera të pensioneve, pensioni mesatar në dhjetor të vitit 2013 arrinte 11.845,00 denarë, dhe e njëjta në krahasim me vitin 2012 në vlerë prej 11.038,00 denarë është më e lartë për 7,3%. Rritja është rezultat i harmonizimit të rregullt dhe të kryer të pensioneve të kryera për vitin 2013, si dhe lartësinë e pensioneve të përfituesve të rinj të pensionit.

Tabela nr. 16 Pjesëmarrja e pensioneve në pagën mesatare neto

Vitet	Pension pleqërisë	Pension invalidor	Pension familjar	Gjithsej pensione
2001	70,8	53,5	50,6	61,7
2002	69,1	52,5	49,1	60,2
2003	70,4	53,7	49,9	61,4
2004	67,8	51,9	48,1	59,3
2005	64,9	49,9	45,9	56,9
2006	63,3	48,7	44,4	55,5
2007	57,6	44,4	40,2	50,5
2008	62	49,3	44,6	55
2009	55,4	44,3	39,7	49,1
2010	54,1	42,9	38,3	47,9
2011	56,5	44,5	39,6	49,9
2012	57,9	46,3	40,2	51,3
2013	61,8	49,29	43,12	55,0

Burimi: www.piom.gov.mt

Pjesëmarrja e të gjitha llojeve të pensioneve në krahasim me pagën mesatare neto të paguar për punëtor, në vitin 2013 në raport me vitin 2001 ka pësuar rënie prej 61,7% në 55,0%.

Tabela nr. 16 Vlera e pensioneve minimale në vite

Viti	Vlera më e ulët e pensionit (denarë)	Shfrytëzues të vlerës më të ulët të pensionit nga grupi i tretë
2000	3.362,00	16.761
2001	3.422,00	19.436
2002	3.647,00	20.565
2003	3.856,00	20.809
2004	3.903,00	21.173
2005	3.918,00	21.577
2006	4.023,00	22.142
2007	4.091,50	22.102
2008	5.262,00	22.342
2009	5.556,00	22.575
2010	5.634,00	22.357
2011	5.795,50	23.841
2012	5.895,00	22.534
2013	6.562,00	16.336

Burimi: www.piom.gov.mk

Reforma pensionale kishte paraparë edhe rritjen e vlerës më të ulët të pensionit e cila vërehet në tabelë ku pensionet kishin shënuar rritje. Pjesëmarrja e përfituesve të vlerës më të ulët të pensionit në vitin 2013 (16.336) në raport të gjithsej numrit të përfituesve të pensionit (291.821) arrinte 5,6%, ndërsa në vitin 2013 arrin 7,9%, e cila tregon faktin se është reduktuar pjesëmarrja e shfrytëzuesve të vlerës më të ulët të pensionit, e cila garantohet për përfituesit e pensionit, të cilët pensionin e realizojnë me stazh më të ulët të pensional.

Tabela nr. 18 Efektet financiare të sistemit të reformuar pensional

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Të ardhurat	27.72 7,70	20.02 7,88	28.91 1,71	32.40 9,24	34.05 3,25	37.62 1,70	41.58 9,52	41.47 0,03	43.93 7,09	46.37 0,63	51.07 0,23
Shpenzimet	25.88 0,42	27.76 4,35	29.11 6,81	29.02 8,91	31.20 6,70	32.76 9,55	38.73 3,14	41.39 2,97	42.50 7,46	43.30 5,77	50.85 4,32
Balanca	1847, 28	-7736	-205	1202, 54	2846, 55	4882, 15	2856, 38	77,06	1428, 63	3064, 86	215,9 1

Burimi: Autorja V.Sulejmani

Në tabelën e paraqitur më lartë janë matur të ardhurat totale të fondit shtetëror pensional duke i minusuar me shpenzimet totale të fondit shtetëror pensional prej vitit të parë nga reforma me qëllim për të matur efektet financiare si pasojë e reformës pensionale. Nga tabela lartë vërehet se në fillim të reformës pensionale balanca e të ardhurave dhe shpenzimeve sjellë efekte financiare negative, mirëpo prej vitit 2006 e deri në 2013 balanca e tyre kishte filluar të sjellte efekte pozitive me përfitime më të ulta pasi që ishin 10 vitet e para të reformës. Nga kjo tabelë me të dhënat dhe analizat lartë për tregun e punës, numrit të të siguruarve dhe numrit të pensionistëve përfundojmë se Reforma e Pensioneve në Republikën e Maqedonisë ka sjellur efekte financiare pozitive.

4.4. Struktura e të hyrave dhe shpenzimeve të shoqërive pensionale private me kapital financiar të sigurimit pensional

Tabela Nr. 19 Të hyrat e fondeve pensionale private për vitin 2013

Emërtimi	NLB		KB	
Të hyrat nga menaxhimi i fondit pensional të obliguar				
Kompensimi i kontributeve	73.732.214	46,11%	84.594.321	48,39%
Kompensim i mjeteve	62.353.635	38,99%	72.288.528	41,3
Kompensimi i kalimit	0	0,00%	0	0,00%
Të hyra totale nga menaxhimi i fondit të obliguar pensional	136.085.849	85,10%	156.882.849	89,74%
Të ardhurat nga menaxhimi i fondit pensional vullnetar				
Kompensimi i kontributeve	1.515.179	0,95%	1.938.395	1,11%
Kompensimi i mjeteve	1.560.104	0,98%	1.014.218	0,58%
Kompensim i kalimit	0	0,00%	0	0,00%
Të hyrat totale nga menaxhimi i fondit pensional vullnetar	3.075.283	1,92%	2.952.613	1,69%
Të hyrat financiare	18.379.116	11,49%	14.866.182	8,50%
Të hyra të tjera të shoqërisë	2.373.520	1,48%	117.748	0,07%
Të hyrat totale	159.913.768	100,00%	174.819.392	100,00%

Burimi: www.mapas.gov.mk

Në tabelë janë paraqitur të hyrat totale për fondet pensionale dhe për kolonat pensionale. Fondi pensional NLB për vitin 2013 në fondin e obliguar pensional ka realizuar të hyra prej 136.085.849 milion Euro dhe për fondin vullnetar ka realizuar të hyra 7.307.289 milion Euro, të hyrat totale për fondin NLB për vitin 2013 janë 159.913.768 milion Euro. Fondi pensional KB për vitin 2013 ka realizuar të hyra nga fondi i obliguar në vlerë prej 156.882.849 milion Euro dhe të hyra të realizuara nga fondi vullnetar 2.952.613 milion Euro, të hyra totale për shoqërinë pensionale KB për vitin 2013 janë 174.819.392 milionë Euro. Të hyra më të larta nga dy fondet pensionale ka

realizuar fondi KB në dallim prej 14.905.624 milion Euro nga shkaku që KB ka poseduar portfolio me risk më ulët.

Të ardhurat e fondeve pensionale vijnë nga pagesat dhe nga kontributet prej fondeve të detyrueshme dhe vullnetare të pensioneve (rreth 47% e NLB dhe 50% në KB), nga kompensimi i mjeteve prej fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale (40% NLB dhe 42% në Parë KB). Krahasuar me vitin e kaluar, përqindja e të ardhurave nga taksat prej kontributeve në të ardhurat totale ka rënë me rreth 3% janë rritur si përqindje e të ardhurave nga rimbursimet e fondeve, ndërsa pjesa e të ardhurave financiare dhe e të ardhurave të tjera të shoqërisë ka pësuar një rritje të lehtë në rreth 12% të NLB-së dhe rreth 9% në KB-së.

Tabela Nr. 20 Shpenzimet e fondeve pensionale për menaxhim të fondit të obliguar pensional për vitin 2013

Emërtimi	NLB		KB	
Shpenzime për menaxhimin e fondit pensional të obliguar				
Shpenzime për agjentët e shoqërisë	3.858.152	3,79%	3.954.558	3,91%
Shpenzime për marketing	5.537.131	5,43%	5.298.959	5,23%
Shpenzime për transaksione	723.840	0,71%	562.789	0,56%
Shpenzime për MAPAS-in	15.228.881	14,94%	17.288.851	17,08%
Shpenzime për depozitarin e pasurisë	8.760.705	8,60%	8.420.608	8,32%
Shpenzime për fondin SPIM	855.635	0,84%	864.241	0,85%
Shpenzime të tjera	50.774	0,05%	224.562	0,22%
Shpenzimet totale për menaxhimin e fondit të obliguar pensional	35.015.118	34,36%	36.614.568	36,17%

Burimi: www.mapas.gov.mk

Në tabelë janë paraqitur shpenzimet e fondeve pensionale për vitin 2013. Nga tabela shihet se shpenzimet për menaxhim të fondit të obliguar pensional për fondin NLB për vitin 2013 janë 35.015.118 milionë Euro dhe shpenzimet për fondin KB për vitin 2013 janë 36.614.568 milion Euro.

Tabela nr. 21 Shpenzime për menaxhimin e fondit pensional vullnetar

Shpenzime për menaxhimin e fondit pensional vullnetar				
Shpenzime për agjentët e shoqërisë	347.498	0,34%	1.344.118	1,3%
Shpenzime për marketing	1.812.117	1,78%	721.111	0,71%
Shpenzime për transaksione	313.414	0,31%	361.298	0,36%
Shpenzime për MAPAS-in	362.854	0,36%	541.320	0,53%
Shpenzime për depozitarin e pasurisë	326.088	0,32%	284.059	0,28%
Shpenzime të tjera për menaxhim të shoqërisë	35.344	0,03%	156.852	0,15%
Shpenzime totale për menaxhimin e fondit pensional vullnetar	3.197.315	3,14%	3.408.758	3,37%
Shpenzimet nga menaxhimi i shoqërisë				
Pagat dhe kompensimet e punëtorëve	41.030.780	40,26%	32.658.329	32,26%
Shpenzime për shërbime	14.003.004	13,74%	7.068.794	6,98%
Shpenzime për materiale	1.473.843	1,45%	2.008.330	1,98%
Amortizimi	2.482.306	2,44%	.357.292	3,32%
Të dalurat financiare	263.016	0,26%	40.472	0,04%
Shpenzime tjera nga puna	4.360.727	4,28%	16.065.623	15,87%
Shpenzimet e rezervuara dhe risku	78.098	0,08%	0	0,00%
Shpenzimet totale nga menaxhimi i shoqërisë pensionale	63.691.774	62,50%	61.198.840	60,46%
Shpenzimet totale	101.904.207	100,00 %	101.222.166	100,00%


Burimi: www.mapas.gov.mk

Në tabelë janë të paraqitura shpenzimet për menaxhimin e fondit vullnetar, shpenzimet totale për menaxhimin e fondit pensional vullnetar për fondin NLB janë 3.197.315 milionë Euro, ndërsa shpenzimet totale për fondin vullnetar janë 101.904.207 milionë Euro. Për fondin KB shpenzimet për menaxhimin e fondit pensional vullnetar janë 3.408.758 euro dhe shpenzimet totale të fondit vullnetar kanë arritur 101.222.166 milionë Euro.

Shoqëritë pensionale kanë shpenzimet më të larta të kompanisë (përafërsisht 63% NLB dhe 61% KB), për paga dhe përfitimet për punonjësit, e ndjekur nga kostoja e shërbimeve dhe nga kostot e tjera operative. Krahasuar me vitin e kaluar, pjesa e pagesave

në shpenzimet totale për NLB-në ishte ulur me tre për qind, ndërsa KB është lënë në rreth të njëjtin nivel.

Grafiku nr. 15 Struktura e të hyrave dhe shpenzimeve në shoqëritë pensionale KB dhe NLB për vitin 2012/2013



Burimi: www.mapas.gov.mk

Rritja më e madhe gjatë vitit 2012, e paraqitur në vitin 2013, lidhet me pjesëmarrjen e shpenzimeve të tjera të kompanive në total. Pjesa tjetër e kostove lidhen me kostot e menaxhimit të fondeve të pensionit (rreth 38% NLB dhe 40% KB). Nga këto, kostoja e marketingut dhe e agjentëve të shitjes arriti në rreth 11% për NLB-në dhe koalicioni i parë, që paraqet një rënie të lehtë në krahasim me vitin e kaluar rreth 25% e NLB-së dhe

27% në shpenzimet KB bien mbi tarifat dhe kompensimet për MAPAS-in, Fondin Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë dhe rojtarëve të pasurisë.

Tabela Nr. 22 Mjetet e fondit pensional

Emërtimi	NLB	KB
Kapitali dhe rezervat	292.728.587	307.938.3
Kapitali kryesor	130.001.478	110.459.0
Teprica e kapitalit mbi minimumim ligjor	25,25%	31,76%
Mjetet vetiake	262.765.574	280.616.3
Teprica e fondeve e përcaktuar me ligjë	124,86%	140,13%

Burimi: www.mapas.gov.mk

Sipas detyrimit ligjor, KB në Prill të vitit 2013 dhe NLB në Dhjetor të vitit 2013, e kishin të nevojshme për të siguruar rritje të kapitalit në raport me kapitalin aksionar, p.sh. kapitalit në vlerë prej 3.800.000 Euro, sepse shuma e fondit pensional të obligueshëm dhe vullnetar ka tejkaluar shumën prej 200 milion Euro.

Tabela Nr. 23 Asetet mesatare për të siguruarit

Emërtimi	NLB	KB
Indikatorët e të hyrave dhe të dalurave për anëtarë		
Të hyrat mesatare për anëtarë	961,43	951,60
Shpenzimet mesatare për anëtarë	612,67	550,99
Fitimi për anëtarë	348,76	400,61
Indikatorët për efikasitet		
Koeficienti i efikasitetit (shpenzimet totale/të hyrat)	63,72%	57,90%

Burimi: www.mapas.gov.mk

Në kushtet e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve për anëtar mund të vërehet se të ardhurat mesatare për anëtar përafërsisht janë të njëjta në të dyja fondet pensionale, por edhe aq më të larta janë shpenzimet mesatare për anëtar. Krahasuar me vitin 2012, të dyja fondet pensionale kanë një rritje në të ardhurat mesatare për anëtar, ndërsa shpenzimet

mesatare për anëtar janë përafërsisht të njëjta në KB, ndërsa për anëtarët e NLB-së shpenzimet mesatare janë më të ulëta. Në të dyja fondet paraqitet një rritje në fitim prej 33% në krahasim me vitin 2012 dhe një rënie në efikasitetin me koeficient prej rreth 10%.

Tabela Nr. 24 Kontributet për anëtarët në shtyllën e dytë pensionale në milion denarë

	Gjith. 2012	Jan.	Shk .	Ma .	Pr.	Ma.	Qe.	Ko.	Gu .	Sht .	Te.	Në.	Dh j	Gjith. 2013
NLB-O	1.779	152	152	154	155	154	157	163	161	156	164	160	189	1.916
KB-O	2.015	172	174	175	175	173	179	185	181	179	187	183	210	2.174
Gjithsej	3.794	324	325	328	330	327	336	348	342	335	351	343	399	4.090

Burimi: www.mapas.gov.mk

Në shoqërinë NLB numri i anëtarëve në fondin e obliguar ka arritur 166.329 anëtarë, për dallim nga NLB shoqëria KB për vitin 2013 kishte arritur numrin e anëtarëve prej 183.711 anëtarë. Numri total i anëtarëve në dy shoqërit për vitin 2013 ka arritur në 350.040 anëtarë. Shoqëria pensionale është e obliguar të kryej edhe projeksione për pritjen e anëtarëve të rinjë. Tabela tregon kontributet e përgjithshme (në milionë denarë) të paguara në kolonën e dytë për çdo muaj duke filluar që nga fillimi i vitit 2012 e deri në 31dhjetor të vitit 2013 dhe numri i përgjithshëm i anëtarëve në fund të çdo muaji është në të njëjtën periudhë. Nga kjo mund të vërehet se në përgjithësi gjatë muajve është paraqitur një rritje në numrin e anëtarëve dhe të kontributeve në fondet e obligueshme pensionale (edhe pse trendi i pagesave nuk është plotësisht linear, por ka disa ulje dhe rritje që i përkasin disa muajve).

Tabela Nr. 25 Pensionet e realizuara për vitin 2013

Llojet e pensioneve në fondin e obliguar pensional	NLB-O	KB-O	Gjithsej
Pension i invaliditetit	31	50	81
Pension familjar	28	36	64

Burim: www.mapas.gov.mk

Në tabelën për realizimin e pensioneve shohim se gjatë vitit 2013, janë paguar pensionet e llojit të pensionit për trashëgimi në llogari individuale të 81 anëtarëve të vdekur, të cilët janë 50 anëtarët NLB-O dhe 31 anëtarë KBP-O. Gjithashtu kanë realizuar pagesë pensionale mbi 4 persona, të cilët nuk kanë fituar statusin pensionistë të pleqërisë nga Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë, prej të cilëve tre anëtarë janë NLB-O dhe 1 anëtar KB-O.

Tabela Nr. 26 Numri i të siguarve dhe pensionistëve të Kolonës së Dytë

Pensionale prej vitit 2006-2013

Viti	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Të siguarit	128.031	162.653	195.140	237.024	266.975	296.631	323.480	350.040
Pensionistët	72	13	64	78	88	89	110	145
Dallimi	127,959	162,640	195,076	236,946	266,887	296,542	323,370	349,895

Burimi: Autorja V. Sulejmani

Në tabelën lartë është gjetur dallimi në mes të numrit të të siguarve dhe pensionistëve prej themelimit të fondeve pensionale private të vitit 2006 e deri në vitin 2013. Nga tabela vërehet se numri i të siguarve prej vitit 2006-2013 në krahasim me numrin e pensionistëve është shumë më i lartë nga shkakutë struktura pjesëmarrëse në shtyllën e dytë pensionale e të siguarve është mosha e re, të punësuarit deri në moshë 40 vjet dhe të punësuarit pas vitit 2002 e këndej.

Tabela Nr. 27 Norma e kthimit të investimit te fondet pensionale private

Emërtimi	NLB-O	KB-O
Mjetet neto për vitin 31.12.2012/2013	9.774,67	11.349,43
Kontributet	1.915,72	2.174,01
Kompenzimet e kontributeve	73,73	83,68
Tatimet e kontributet e reduktuara	1.841,99	2.090,33
Kompenzimi nga mjetet	62,35	72,29
Shpenzimet për broker	2,66	1,05
Transferi nga fondi tjetër	5,30	15,53
Transferi nga fondi tjetër	15,53	5,30
Transferimi në FPSIM përshkak të ndërprerjes së kontratës, rimbursimit të kontributeve dhe të daljes në pension	72,00	84,31
Pagesa për trashigimi	0,56	1,98
ension i njëhershëm	0,13	0,59
Fitimi bruto nga investimit	979,10	1.062,11
Neto fitimi nga investimit	914,09	988,76
Neto fitimi për vitin 31.12.2013	12.447,83	14.351,87

Burimi: www.mapas.gov.mk

Në tabelë janë të paraqitura mjetet aktive neto si dhe kontributet kumulative për vitin 2012/2013. Në të dyja fondet pensionale NLB-O dhe KB-O mjetet aktive neto dhe kontributet kumulative që nga themelimi i tyre kanë vazhdimisht rritje. Rritja më e madhe në aktivet neto (150%), dhe kontributet kumulative të paguara (40%) dhe dy fonde pensionale është regjistruar në vitin 2007. Pastaj pasoj me ngritjen dhe rënien e aktiveve neto duke paguar kontributet kumulative. Gjatë viteve ka ardhur gradualisht duke u stabilizuar rritja e aktiveve neto dhe konkretisht në tre vitet e fundit është rritur mesatarisht rreth 30%, ndërsa rritja e kontributeve të paguara kumulative për të njëjtën periudhë është rreth 10%. Në vitin 2013, rritja e aktiveve neto është 27% NLB-O dhe

KB-O 26%, ndërkohë që rritja e kontributeve të paguara kumulative llogaritet për 8% për të dyja fondet NLB-O dhe KB-O.

Tabela Nr. 28 Njësia kontabël nga fillimi i reformës pensionale

Vitet	Njësia kontabile nga fillimi i reformës	
	NLB-O	KB-O
31.12.2006	105,929336	106,265900
31.12.2007	115,511364	115,303221
31.12.2008	100,155213	107,116421
31.12.2009	116,874672	120,667142
31.12.2010	125,009646	129,590887
31.12.2011	129,003093	130,697013
31.12.2012	139,225567	142,372582
31.12.2013	151,117506	153,757419

Burimi: www.mapas.gov.mk

Në tabelë vërejmë lëvizjen e kontabilitetit i cili jep një shumë nominale në rritje, njësitë nga fillimi i sistemit të reformuar kishte ndryshuar në rritje përqindja e vlerës së njësisë kontabël. Që nga reforma e pensioneve shoqërit paraqiten me rritje të njësisë konsiderueshme, duke filluar nga viti 2006 që NLB kishte njësi prej 105,929336 dhe KB-106,265900, në vitin 2013 njësia kontabile për shoqërin NLB ka arritur në 151,117506 dhe për shoqërin KB ka arritur në 153,757419.

**Tabela Nr. 29 Të ardhurat dhe shpenzimet e fondeve private pensionale
prej vitit 2006-2013**

Viti	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Të ardhurat	118.785.989,07	179.552.256,11	215.283.281,07	263.831.823,50	291.672.677,45	242.807.325,05	263.954.942,04	292.968.698,6
Shpenzimet	127.764.716,50	166.740.449,0	161.111.108,0	195.033.199,00	188.514.199,00	194.735.310,90	200.217.643,00	203.128.373,02
Balanca	-8,978,727	12,811,807	54,172,173	68,798,624	103,158,478	48,072,015	63,737,299	89,840,325

Burimi: Autorja V.Sulejmani

Në tabelë janë të paraqitura të ardhurat dhe shpenzimet e fondeve pensionale private prej themelimit të tyre nga viti 2006 e deri më vitin 2013. Nga tabela shohim se balanca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të fondeve është pozitive në aspekt të të ardhurave të cilat tregojnë se veprimtaria pensionale e fondeve pensionale është në përfitim të lartë.

Tabela nr. 30 Shkalla anuale e kthimit nga investimet

Viti	2006-2007	2007-2008	2008-2009	2009-2010	2010-2011	2011-2012	2012-2013
Shkalla anuale e kthimit nga investimet	12.24%	17.53%	0.203%	29.29%	14.35%	4.06%	0.168%

Burimi: Autorja V.Sulejmani

Në tabelë lartë është matur shkalla anuale e kthimit nga investimet. Prej vitit 2006 e deri në vitin 2008 shkalla anuale e kthimit është në rritje, ndërsa në vitin 2009 shkalla anuale ka pësuar rënie ku prap prej vitit 2009 shkalla anuale e kthimit të investimit është në rritje.

Tabela nr. 31 Kontributet e fondit pensional nga viti i parë i reformës pensionale

Vitet	NLB-O		KB-O	
	Vlera	Vlera reale	Vlera nominale	Vlera reale
01.01.2006	0,05%		2,32%	
31.12.2006	3,33%		4,32%	
31.12.2007	2,67%		3,97%	
31.12.2008	8,80%		6,86%	
31.12.2009	6,00%		5,66%	
31.03.2010	5,05%	1,99%	5,37%	2,31%
30.06.2011	4,93%	1,80%	5,27%	2,12%
30.09.2012	4,81%	1,65%	5,28%	2,11%
31.12.2013	5,20%	2,16%	5,41%	2,37%
Fillimi	-	5,29%	2,24%	5,52%
				2,46%

Burimi: www.mapas.gov.mk

Në tabelë janë paraqitur lëvizjet e vlerës reale të kontributeve nga fillimi i reformës pensionale deri më 31 Dhjetor të vitit 2013. Lëvizja e vlerave në terma nominalë, gjatë tetë viteve të ekzistencës së sigurimit pensional me financim kapital, mund të shihet në tabelë, ku vlerat janë treguar duke filluar qysh nga periudha e fillimit të sistemit deri 31 Dhjetor të vitit 2013. Në fillim të ekzistencës së sistemit ka pasur një rritje e konsiderueshme, por në fund të vitit 2006 dhe 2007 janë arritur vlera të larta, ndërsa në fund të vitit 2008 ka vlera më të ulëta dhe kjo për shkak të zhvillimeve negative në tregjet financiare të vendit dhe në ato të huaja. Më pas vijon një rikthim gradual nga rendimentet e krizës drejt rritjes dhe rritja vazhdon jo vetëm gjatë vitit 2009, por edhe deri në fund të vitit 2010. Në fund të vitit 2011, ka pasur një rënie të lehtë në krahasim me atë në fund të vitit 2010. Në fund të vitit 2012 dhe 2013 është regjistruar rritje.

Tabela nr. 32 Fondet pensionale vullnetare për vitin 2013 (në milion denarë)

Emërtimi	NLB-v	KB-v
Vlera neto për vitin 31.12.2012	110,38	81,02
Kontributet	45,36	67,66
Kompenzimet nga kontributet	1,52	1,94
Përfitimet e reduktuara nga kontributet	43,84	65,73
Pagesa e llogarisë individuale të rimbursimit të tatimit mbi të ardhurat	0,31	0,16
Rimbursimi i kontributeve të paguara gabimisht	0,18	0,89
Shlyerje kontrate nga anëtarët	0,00	0,00
Kompenzimi nga mjetet	1,56	1,01
Shpenzimet për broker	0,10	0,03
Transfer nga fondi tjetër	0,00	0,00
Transfer në fond tjetër	0,00	0,00
Pages për trashigimi	0,19	0,40
Pages e kompenzimit, për pleqëri për pagesë të njëhershme	2,73	1,16
Bruto fitimi nga investimet	14,32	10,80
Neto fitimi nga investimet	12,66	9,75
Mjetet neto për vitin 31.12.2013.	164,08	154,22

Burimi: www.mapas.gov.mk

Nga tabela vërejmë lëvizjen në vlerën e aktiveve neto, kontributeve kumulative dhe rritjen në kontributet e paguara, rritjen në aktivet neto në NLB-v dhe KBP-v.

NLB-v nga fillimi i funksionimit të fondit pensional vullnetar, 2009-2010 ka dëshmuar një rritje të madhe në aktivet neto (465%) dhe kontributet e paguara (355%). Në vitin 2013, krahasuar me vitin 2012 NLB-v, mjetet neto u rritën me 49% dhe kontributet e paguara për 19%. Në KBP-v 2010-2011 ka pasur një rritje të mprehtë në aktivet neto (222%) dhe kontribute të papaguara (125%). Në vitin 2013%, krahasuar me vitin 2012, vit KBP-v ka shënuar rritje më të lartë në drejtim të rritjes dhe NLB-v në aktivet neto (90%) dhe kontributet e paguara (61%).

**Tabela Nr. 33 Vlera e njësisë kontabël për vitin 2012-2013
në fondet vullnetare pensionale**

Data	Vlera e njësisë kontabël për vitin 2013	
	NLB-v	KB-v
31.12.2012	118,742851	119,129537
31.03.2013	122,601457	122,701004
30.06.2013	123,133296	123,429792
30.09.2013	125,096825	125,358823
31.12.2013	130,511147	129,015451

Burimi: www.mapas.gov.mk

Nga tabela mund të vërehet se në vitin 2013 njësia kontabël ka pasur rritje në krahasim me vitin 2012. Vlera e njësisë kontabël për vitin 2012 ka përfunduar në NLB me 118,742851 dhe 119,129537 për KB-në, ndërsa për vitin 2013 vlera e njësisë kontabël ka mbaruar me 130,511147 për NLB-në dhe 129,015451 për KB-në.

Tabela Nr. 34 Vlera e njësisë kontabël e fondit vullnetar prej periudhës që ekzistojnë pensionet vullnetare

Data	Vlera e njësisë kontabile	
	NLB-v	KB-v
15.09.2009	100,000000	
21.12.2009	102,815757	100,000000
31.12.2009	103,061825	100,204385
30.06.2010	105,341097	103,075243
31.12.2010	107,592926	106,891617
30.06.2011	112,063231	112,822674
31.12.2011	111,854726	112,639593
30.06.2012	116,301719	115,898048
31.12.2012	118,742851	119,129537
30.06.2013	123,133296	123,429792
31.12.2013	130,511147	129,015451

Burimi: www.mapas.gov.mk

Në tabelën 27 janë paraqitur vlerat e njësisë kontabël që nga periudha e ekzistencës e deri më 31.12.2013. në vitin 2009 njësia kontabël për NLB ka përfunduar me 103,061825 dhe për KB 100,204385 dhe në vitin 2013 vlera e njësis kontabël për shoqërin NLB ka arritur 130,511147 dhe për shoqërin KB ka arritur 129,015451.

Tabela Nr. 35 Kontributet e fondit vullnetar dhe vlera e kompensimit

Periudha	NLB-v		KB-v	
	Vlera	Vlera reale	Vlera nominale	Vlera reale
31.12.2009	4,40%		6,67%	
31.12.2009	4,18%		6,02%	
31.12.2009	4,83%		5,93%	
31.12.2009	5,49%	1,97%	6,43%	2,88%
31.12.2009	5,22%	1,56%	6,14%	2,45%
31.12.2009	5,30%	2,05%	6,15%	2,87%
31.12.2009	6,08%	3,00%	6,52%	3,42%
Fillimi -	6,17%	3,29%	6,52%	3,42%

Burimi: www.mapas.gov.mk

Të dhënat në tabelë tregojnë që vlerat individuale vullnetare dhe llogaritë profesionale janë të ndryshueshme dhe mvaren nga kthimi i fondit pensional vullnetar dhe tarifat e ngarkuara nga kompania. Fitimet nuk mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, sepse ato mvaren nga kushtet e tregut të kapitalit dhe ekonomisë në përgjithësi. Në vitin 2013 për shoqërinë NLB vlera nominale ka arritur në 6,17% dhe vlera reale 3,29, ndërsa në shoqërinë KB vlera nominale ka arritur në 6,52% dhe vlera reale në 3,42%.

Tabela Nr. 36 Pensionet e realizuara në fondin vullnetar për vitin 2013

Pensionet realizuara	NLB-v		KB-v		Gjithsej
	Llogaria individuale	Llogaria profesionale	Llogaria individuale	Llogaria profesionale	
Pension pleqërie	14	14	13	58	99
Pension/trash .	2	2	1	1	6

Burimi: www.mapas.gov.mk

Në vitin 2013 u realizuan 99 pensione nga Kolona Tretë. Shumica e pagesave janë pagesa në rast pleqërie me tërheqje të njëhershme nga fondet si edhe pensione që, në rast të vdekjes së trashëgimtarit, paguhet një pjesë. Nga këto, 30 pensione janë paguar nga llogaria individuale dhe 75 pensione janë paguar nga llogaria profesionale.

KAPITULLI I V

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Në pjesën teorike u përshkruan të gjithë faktorët kryesorë që ju përkojnë kapitujve të lartshënuar, kështu që në këtë kapitull do të ofrohet një pasqyrë teorike dhe empirike mbi kuptimin dhe rëndësinë e reformës pensionale, analiza dhe rezultate nga sistemi i reformuar pensional në Maqedoni, si dhe metodologjia dhe metodat statistikore të përdorura në studim.

5.1. Analiza dhe rezultate nga sistemi pensional në Maqedoni

Teoritë mbi pensionet janë të shumta. Një pjesë e mirë e tyre është përfshirë në kuadrin teorik të këtij punimi. Megjithatë, në funksion të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave bazë të studimit, vetëm një pjesë e kuadrit teorik do të shfrytëzohet, në mënyrë më të detajuar do të trajtohet tek pjesa e mbledhjes, përpunimin dhe interpretimit të të dhënave.

Rikujtojmë edhe njëherë se dy janë pyetjet kërkimore të studimit:

- 1) A ka ndikuar pozitivisht reforma e pensioneve mbi numrin e të siguruarve?
- 2) A ka ndikuar pozitivisht reforma e pensioneve mbi asetet mesatare për të siguruarit?

Hipotezat e punimit janë:

H.1 Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguruarve.

H.2 Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

Siç edhe është saktësuar që në fillim të këtij studimi, bazuar në literaturën ekzistuese mbi pensionet e reformuara, tre janë burimet kryesore të informacionit për testimin e hipotezave:

- 1) Të dhënat e mbledhura drejtpërdrejt në Fondin për Sigurim Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë, Shoqëritë pensionale private dhe Autoriteti i Mbikqyrjes financiare-Agjencioni MAPAS këto të dhëna janë përpunuar me programin SPSS.
- 2) Shfrytëzimi i literaturës ekzistuese dhe studimeve të ndryshme mbi pensionet;
- 3) Citimi i të dhënave nga raporte të ndryshme të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me pensionet.

5.2. Metodologjia, metodat dhe instrumentët bazë të studimit

Ky studim më tepër ka karakter vlerësues dhe përshkrues, ku metodat bazë sipas së cilëve do të realizohet vlerësimi është modeli ekonometrik, ku përmes programit të SPSS është matur ndikimi i reformës pensionale tek të siguruarit. Ky studim dhe ky model është mbështetur dhe gjenë përshtatshmëri në studimin e autorës Anita Tuladhar me titull

“Pension Reform and Financial Markets”: Encouraging Household Savings for Retirement

5.2.1 Analiza empirike

Modeli ekonometrik (Modeli 1)

Në mënyrë që të masin ndikimin e variablave të pavarura në numrin e të siguruarve në Maqedoni është përdorur regresioni i shumëfishtë në të dhëna të serive kohore nga 2003-2013. Ku variabël i varur është numri i të siguruarve ndërsa variabla të pavarur janë shkalla anuale e kthimit, të ardhurat kombëtare për frymë banori, norma e papunësis dhe ndikimi i reformës.

Mbledhjen e të dhënave që janë përdorur në model janë burime nga Autoritet i Mbikqyrjes Finaciare-Agjencioni MAPAS, Fondi për Sigurim Pensional Invalidor dhe burime nga Qendra për Statistikë në Republikën e Maqedonisë.

Variablat janë variabla te vazhdueshme prandaj është zgjedhur ky llojë regresioni.

$$\log(\text{PFP}_t) = \beta_0 + \beta_1 \text{PFP}_{t-1} + \beta_2 \text{SHAK}_t + \beta_3 \log(\text{YPK}_t) + \beta_4 \log(\text{NP}_t) + \theta_1 \text{Reforma} + \varepsilon_i \quad (1)$$

Ku;

PFP- Numri i të siguruarve (Participimi në fondin e pensioneve);

SHAK- Shkalla anuale e kthimit;

YPK- Të ardhurat kombëtare për frymë banori;

NP- Norma e papunësisë;

Reforma- variable dummy që ndanë periudhat në para dhe pas reformës për të izuluar efektin e reformës në numrin e participantëve

B_0 është term konstant term, nga β_1 deri β_4 janë parametrat që do të nxirren nga variablat e pavarura të përfshira, pra cili është impakti mbi ndryshimin në përqindje të participantëve në sigurim dhe ε_i është termi i errorit.

Tabela Nr 37: Rezultatet e regresionit të shumëfishtë (variabël e varur numri i tësiguruarve në logaritëm), Modeli 1

	Modeli 1 të gjithë	Modeli 2 Deri në 40 vjet	Modeli 3 40-60 vjet	Modeli 4 Privat
Variable/Model	Koeficienti	Koeficienti	Koeficienti	Koeficienti
Constant	12.195*** (86.88)	12.629*** (138.162)	13.327*** (5.917)	11.562*** (194.523)
PFP _{t-1}	1.213E-7*** (5.707)	3.696E-6*** (3.637)	7.034E-7 (0.563)	3.832E-6*** (15.42)
SHAK _t	0.062* (1.794)	0.061*** (2.99)	0.007* (1.177)	.051*** (4.009)
Log(YPK _t)	0.348*** (2.962)	1.079*** (4.084)	0.097 (1.567)	2.777*** (12.076)
Log (NP _i)	-.043* (0.791)	-0.116** (2.253)	0.006 (0.531)	0.025 (0.12)
D(Reforma _t)	0.1173* (1.552)	0.416** (2.136)	0.074** (2.170)	0.754
R Square	0.778	0.733	0.284	0.993
Statistika F	7.704***	6.039***	0.874	74.29***

* Significant at 10%; ** Significant at 5%; *** Significant at 1%

Rezultatet

Tabela nr. 37 shprehë rezultatet e regresionit të shumëfishtë, për modelin e propozuar për të shpjeguar numrin e të siguruarve ku variabla e pavarur është numri i të siguruarve në vitin paraprak, performanca e fondit, të ardhurat kombëtare, norma e papunësisë dhe ndikimi i reformës.

Modeli 1 është model ku të dhënat janë për të gjithë individët në moshë pune.

Modeli 2 është model i kufizuar që përfshin individë deri në moshën 40 vjet.

Modeli 3 është model i kufizuar i cili përfshin të gjithë individët prej moshës 40-60 vjet.

Ndërsa modeli 4 është model që përfshin vetëm të siguruarit në shtyllën e dytë.

Variabël i varur është numri i të siguruarve dhe variabël i pavarur shkalla anuale e kthimit, të ardhurat kombetare për frymë banori, norma e papunësisë dhe reforma.

Përmes kësaj analize do të shikojmë se si ndikojnë variablat e pavarur në atë të varur, që është numri i të siguruarve. Përmes kësaj analize do të arrijmë të kuptojmë se si ndikon numri i të siguruarve në kategori të ndryshme.

Ekuacioni bazë i regresionit

$$\log(\text{PFP}_t) = \beta_0 + \beta_1 \text{PFP}_{t-1} + \beta_2 \text{SHAK}_t + \beta_3 \log(\text{YPK}_t) + \beta_4 \log(\text{NP}_t) + \theta_1 \text{Reforma} + \varepsilon_i$$

Në vazhdim do të gjejmë arsyetimin e çdo variabli vec e vec.

Ekuacioni për rastin e parë është:

$$1. \text{ Numri i të siguruarve} = \text{PFP}_{t-1} \text{ numri i siguruarve} + 1.213\text{E-}7^{***} + 3.696\text{E-}6^{***} + 7.034\text{E-}7 + 3.832\text{E-}6^{***}$$

Kujtojmë edhe njëher hipotezën e parë, me qëllim të vërtetimit të saj

H₀. Reforma e pensioneve NUK ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguruarve.

H_a. Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguruarve.

H₀ bie poshtë, ndërsa *H_a* vërtetohet nga shkakun që tre nga katër modelet kanë signifikançë.

Rezultatet tregojnë që **Koeficienti i Regresionit** për nivelin e të siguruarve për vitin paraprak në të gjitha modelet është pozitiv gjë që tregon që numri i të siguruarve në vitin paraprak ndikon pozitivisht mbi numrin e të siguruarve në vitin aktual, për modelin 1, 2 dhe 4 kjo maredhenie ka signifikançë statistikore në nivelin 1% ndërsa të dhënat për modelin e tretë nuk kanë signifikançë statistikore. Për modelin e tretë signifikançë nuk kanë të siguruarit, është e shpjeguar edhe në qëllimin e reformës por edhe në tregun e punës se qëllimi i reformës është të përfshijë në skemën pensionale të punësuar të rinjë nën moshën 40 vjet nga shkakun që norma kontribuive është shumë më e ulët për të punësuarit e rinjë sesa për ato të moshës mbi 40. Nga shkakun që përlogaritjet e normës kontribuive dhe e pagës bëhen përmes pagës dhe përvojës së punës.

Ekuacioni për rastin e dytë:

$$2. \text{ Numri i të siguruarve} = \text{SHAK}_{\text{tshkalla}} \text{ anuale e kthimit} + 0.062^{*} + 0.061^{***} + 0.007^{*} + .051^{***}$$

H₀. Reforma e pensioneve NUK ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguruarve.

H_a. Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguruarve.

Ho bie, ndërsa *Ha* vërtetohet nga shkakuqë në të katër modelet shkalla anuale e kthimit ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguruarve dhe signifikanca arrin nivelin prej 10%.

Performanca e fondit në model e matur përmes **shkallës anuale të kthimit**, në të katra modele ashtu sic pritej ka ndikim pozitiv i cili është signifikant në nivelin 10% për modelin e parë, 1% për modelin e dytë, 10% për modelin e tretë dhe 10% për modelin e katërt. Ndikimi më i madh i shkallës anuale të kthimit shihet në modelin e parë dhe modelin e dytë, nëse 1% rritet shkalla anuale e kthimit me 0,06% rritet numri i të siguruarve, ndërsa në shtyllën e dytë me 0,05% ndikimi më i vogël shihet te modeli i tretë ose grupmosha 40 - 60 ku 1% rritje në shkallën anuale e kthimit rrit numrin e të siguruarve me 0,07%. Shkalla anuale e kthimit është paraqitur me ndikim më të ulët në modelin e tretë nga shkaku që kontributet e po të njejtëve shfrytëzohen për pensione (1 kontribues 1 pensionist), ndërsa kontributet e modelit të parë dhe të dytë kursehen në formë individuale dhe mjetet e kursimit të tyre investohet edhe në tregun ndërkombëtar gjë që sjellin shkallë anuale të kthimit më të lartë.

Ekuacioni për rastin e tretë:

$$3. \text{ Numri i të siguruarve} = \text{Log}(\text{YPK}_t) \text{ GDP} + 0.348^{***} + 1.079^{***} + 0.097 + 2.777^{***}$$

Ho. Reforma e pensioneve NUK ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguruarve.

Ha. Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguruarve.

Ho bie, ndërsa *Ha* vërtetohet nga shkakuqë niveli i të ardhurave ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguruarve në të gjitha modelet përpos në modelin e tretë.

Niveli i të ardhurave kombëtare është njëra ndër variablat më me shumë ndikim mbi numrin e të siguruarve në të gjitha modelet, përpos në modelin prej moshës 40 - 60,

rezultatet kanë signifikançë statistikore, ndërsa ndikimi më i madhë shihet te kolona e dytë nëse të ardhurat kombëtare rriten për 1% numri i të siguarve rritet për 2,77%. Ndikimi në grupmoshën deri në 40 vjet është 1,079% ndërsa në modelin e parë ku përfshihen të gjitha grupmoshat është 0,348%. Ndikimi më i madh është i paraqitur në shtyllën e dytë nga shkakut që të ardhurat drejtpërdrejt ndikojnë në rritjen e numrit të punësimeve të reja me atë edhe rritet numri i të siguarve.

Ekuacioni për rastin e katërtë:

$$4. \text{ Numri i të siguarve} = \text{Log (NP}_i\text{)}\% \text{ e papunësisë} + -.043* + -.116^{**} + 0.006 + 0.025$$

Ho. Reforma e pensioneve NUK ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguarve.

Ha. Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguarve.

Ho bie poshtë *Ha* vërtetohet nga shkakut që norma e papunësisë vërtetohet në modelin e 1 dhe 2 përmes signifikançës, kurse në modelin 3 dhe 4 nuk vërtetohet.

Norma e papunësisë e përfshirë në model e cila është signifikante në modelin e parë dhe dytë por jo në modelin 3 dhe 4. Në modelin e parë ku është e përfshirë e tërë mostra mund të shihet se 1% rriten, ndërsa normën e papunësisë e zvoglon numrin e të siguarve me 0,043% ndërsa ndikim më i madh ka në grupmoshën tjetër deri në 40 vjet ku 1% rritje e papunësisë zvoglon numrin e të siguarve me 11,6%. Nga kjo shihet se struktura e moshës së të siguarve në skemën pensionale është nën moshën 40 vjet, pikërisht të siguar të rinjë.

Ekuacioni për rastin e pestë:

$$5. \text{ Numri i të sigurve} = D(\text{Reforma}) \text{reforma dummy} + 0.1173^{*} + 0.416^{**} + 0.074^{**}$$

Ho. Reforma e pensioneve NUK ka ndikim pozitiv mbi numrin e të sigurve.

Ha Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi numrin e të sigurve.

Ho bie poshtë, ndërsa *Ha* vërtetohet në tre modele përpos në modelin e katërt.

Ndërsa **ndikimi i reformës** është matur përmes **dummy variabël**, rezultatet tregojnë që variabla dummy në modelin e parë është 0.1173 ose 11,73%, në modelin e dytë 0.416 ose 41,6%, në modelin e tretë 0.074 ose 0,74% dhe në modelin e katërt variabli dummy është 0.754 ose 75%. Këto rezultate të variablit dummy na janë paraqitur nga shkakuqë është përfshirë i gjithë numri i të sigurve në model prej periudhës para reformës në periudhën pas reformës dhe në përgjithësi numri i të sigurve është më i madhë, e sidomos ndikimi më i madh është paraqitur në modelin e dytë ku janë përfshir të sigurve prej 18 deri në 40 vjet, dmth mosha e re nga shkakuqë struktura e të sigurve pjesëmarrës që i ka përfshir reforma është pikërisht të sigurve nën moshën 40 vjet, të sigurve që janë punësuar për herë të parë pas vitit 2003 e këndej dhe të sigurve që punësohen për herë të parë nën moshën 40 vjet. Në modelin e tretë variabli dummy është paraqitur me përqindje më të ulët nga shkakuqë në këtë model janë përfshirë vetëm të sigurve prej 40-60 vjet dhe rezultatet e modelit të katërt tregojnë përqindje më të lartë nga shkakuqë janë të përfshir në këtë model të gjithë të sigurve e shtyllës së dytë.

Koeficienti i determinancionit (R Square) për modelin e parë është 0.778 që nënkupton që rreth 78% e variancës në numrin e të punësuarve shpjegohen prej variablave

të përfshira në model, 73% për modelin e dytë, 28% për modelin e tretë dhe 99% për modelin e katërt.

Modeli është përfaqësues pasi variablat e pavarur të përzgjedhur shpjegojnë afërsisht ½ e numrit të të siguruarve në reformën e pensioneve.

A) Analiza e korrelacionit (cross-tabulation)

Kjo analizë bënë të mundur të kuptojmë korrelacionin që egziston ndërmjet variablit të varur është numri i të siguruarve ndërsa variabla të pavarur janë shkalla anuale e kthimit, të ardhurat kombëtare për frymë banori, norma e papunësisë dhe ndikimi i reformës. Përmes Chi-Square test do të arrijmë të kuptojmë nëse ka apo nuk ka lidhje ndërmjet këtyre variablave.

Tabela.38 Tabela e korrelacionit, Modeli 1

Indikatorë numri i të siguruarve		Shkalla anuale e kthimit	Ardhurat kombëtar	Norma e papunësisë	Reforma	Cross-Tabulation Asymp.Sig
Numri i përgjithshëm i të siguruarve						
	0-2	23 (23,8%)	70 (53,6%)	40 (28,7%)	25 (20,1%)	0.031
	5	58 (58,9%)	42 (31,7%)	56 (44,7%)	16 (10,3%)	0.002
	6<	19 (19,2%)	23 (16,4%)	20 (16,6%)	53 (42,3%)	0.015
Numri i të siguruarve deri në 40 vjet						
	0-2	75 (75,7%)	21 (17,3%)	24 (22,4%)	40 (24,9%)	0.007
	5	16 (16,2%)	12 (8,9%)	56 (50,8%)	16 (11,7%)	0.037
	6<	8 (8,1%)	56 (40,2%)	23 (16,6%)	20 (11,4%)	0.015
Numri i të siguruarve prej 40-60 vjet						
	0-2	73 (63,6%)	45 (40,8%)	24 (17,7%)	25 (20,6%)	0.001
	5	24 (24,2%)	22 (13,5%)	35 (20,4%)	18 (10,6%)	0.034
	6<	12 (12,1%)	16 (11,9%)	10 (7%)	54 (47,7%)	0.014
Numri i përgjithshëm i të siguruarve në shtyllën private						
	0-2	52 (52,6%)	72 (54,3%)	54 (47,4%)	50 (37,9%)	0.002
	5	29 (29,3%)	27 (14,1%)	36 (20,1%)	27 (11,8%)	0.011
	6<	18 (18,2%)	12 (10,7%)	14 (7,5%)	8 (4,6%)	0.014

Sic shohim në rezultatet përmbljedhëse të tabelës më sipër, numri i përgjithshëm i të siguruarve, numri i të siguruarve deri në 40 vjet, numri i të siguruarve prej 40-60 vjet dhe

numri i pergjithshëm i të siguruarve në shtyllën private ndryshon në varësi të shkallës anuale të kthimit, të ardhurave kombëtare, normës së papunësis, dhe reformës.

Në mënyrë të ngjajshme, vihet re se numri i të siguruarve ndryshon. Në të gjitha rastet Asymp.Sig fuqia shpjeguese e Chi-Square tests rezulton të jetë < 0.05 , që nënkupton se testi i këtyre dy variablave rrëzon H_0 (e cila pohon se NUK ekziston një lidhje ndërmjet tyre) dhe vërteton H_a (e cila pohon se kjo lidhje ekziston).

Modeli ekonometrik (Modeli 2)

Në menyrë që të masin ndikimin e variablave të pavarura mbi asetet mesatare për të siguruarit në Republikën e Maqedonisë është përdorur regresioni i shumefishtë, me të dhëna të serive kohore nga 2003-2013. Në modelin ekonometrik variabël i varur janë asetet mesatare për të siguruarë ndërsa variabla të pavarur janë numri i të siguruarve në vitin paraprak, performanca e fondit, të ardhurat kombëtare, norma mesatare vjetore e interesit për depozitat dhe norma mesatare e kthimit për bonot e thesarit.

Mbledhjen e të dhënave që janë përdorur në model janë burime nga Autoritet i Mbikqyrjes Finaciare-Agjencioni MAPAS, Fondi për Sigurim Pensional Invalidor dhe burime nga Qendra për Statistikë në Republikën e Maqedonisë.

Variablat janë variabla te vazhdueshme prandaj është zgjedhur ky lloj regresioni.

$$\mathbf{log(AMPP_t)} = \beta_0 + \beta_1 \mathbf{AMPP_{t-1}} + \beta_2 \mathbf{SHAK_t} + \beta_3 \mathbf{log(YPK_t)} + \beta_4 \mathbf{(NiD_t)} + \beta_5 \mathbf{(NKB_t)} + \theta_1 \mathbf{Reforma} + \varepsilon_i \quad (2)$$

Ku:

AMPP- Asetet mesatare për të siguruar (Asetet totale/numri i participantëve në fondin e pensioneve);

SHAK- Shkalla anuale e kthimit;

YPK- Të ardhurat kombëtare për frymë banori;

NID- Norma mesatare vjetore e interest per depozitat;

NKB- Norma mesatare vjetore e kthimit për bonot e thesarit në Maqedoni.

Reforma- variable dummy që ndanë periudhat në para dhe pas reformës për të izuluar efektin e reformës në asetet mesatare.

B_0 është term konstant, nga β_1 deri β_5 janë parametrat që do të nxirren nga variablat e pavarura të përfshira, pra cili është impakti mbi ndryshimin në përqindje të participantëve në sigurim dhe ε_i është termi i errorit.

Rezultatet

Tabla Nr.39 Rezultatet e regresionit të shumfishtë (variabël i varur asetet mesatare për të siguruarit në logaritëm), Modeli 2

	<i>Modeli 1</i>
	<i>Komplet</i>
Variable/Model	<i>Koeficienti</i>
Constant	1.252*** (7.014)
AMPP _{t-1}	0.100*** (3.881)
SHAK _t	0.045*** (6.455)
Log(YPK _t)	0.655*** (5.19)
NiD _i	-0.226* (-1.826)
NKB _t	0.031 (1.763)
D(Reforma _t)	0.319*** (3.507)
<i>R Square</i>	0.592
<i>Statistika F</i>	2.604*

* Significant at 10%; ** Significant at 5%; *** Significant at 1%

Tabela nr. 38 tregon rezultatet e regresionit të shumfishtë për modelin e propozuar për të shpjeguar asetet mesatare për të siguruarë ku variabla i pavarur është numri i të siguruarve në vitin paraprak, performanca e fondit, të ardhurat kombëtare, norma mesatare vjetore e interesit për depozitat dhe norma mesatare e kthimit për bonot e thesarit.

Modeli i dytë merr në konsiderat asetet mesatare për të siguruar. Rruga për testimin e hipotezës është e njëjtë si në rastin e parë

Ekuacioni bazë i regresionit

$$\log(\text{AMPP}_t) = \beta_0 + \beta_1 \text{AMPP}_{t-1} + \beta_2 \text{SHAK}_t + \beta_3 \log(\text{YPK}_t) + \beta_4 (\text{NiD}_t) + \beta_5 (\text{NKB}_t) + \theta_1 \text{Reforma} + \varepsilon_i$$

Kujtojmë edhe njëherë hipotezën e dytë:

Reforma pensionale ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

1. Ekuacioni për rastin e parë: **AMPP_{t-1}=0.100*****

Ho. Reforma e pensioneve NUK ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

Ha. Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

Për rastin e parë *Ho* bie poshtë ndërsa *Ha* vërtetohet

Rezultatet tregojnë që koeficienti i regresionit për nivelin e të siguruarve për vitin paraprak është pozitiv gjë që tregon se asetet mesatare për vitin paraprak ndikojnë pozitivisht mbi asetet mesatare për të siguruarit në vitin aktual.

2. Ekuacioni për rastin e dytë: **$SHAK_t=0.045^{***}$**

Ho. Reforma e pensioneve NUK ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

Ha. Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

Ho bie poshtë ndërsa *Ha* vërtetohet

Performanca e fondit në model, e matur përmes shkallës anuale të kthimit, ashtu siq pritej ka ndikim pozitiv i cili është signifikan në nivelin 1%; rezultatet tregojnë se nëse 1% rritet shkalla anuale e kthimit me 0,045% rritet asetet mesatare për të siguruar. Shkalla anuale e kthimit nga investimi, nënkupton fitim më i lartë i fondeve pensionale dhe me fitim më të lartë rriten edhe asetet mesatare për të siguruar.

3. Ekuacioni në rastin e tretë: **$\text{Log}(YPK_t)= 0.655^{***}$**

Ho. Reforma e pensioneve NUK ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

Ha. Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

Ho bie poshtë, ndërsa *Ha* vërtetohet.

Niveli i të ardhurave kombëtare është njëra ndër variablat më me shumë ndikim mbi asetet mesatare për të siguruar, që sipas rezultateve nëse 1% rriten të ardhurat për frymë banori, asetet mesatare për të siguruar rriten më 0,65%; ndërsa ky rezultat është signifikan 1%. Kur përllogariten asetet mesatare për të siguruar, niveli i të ardhurave kombëtare gjatë përllogaritjes është faktori i parë i cili ka ndikim edhe në këtë rast nëse niveli i të ardhurave është në rritje atëherë edhe asetet për anëtar janë në rritje.

4. Ekuacioni për rastin e katërt: $NID_i = -0.226^*$

H₀ Reforma e pensioneve NUK ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

H_a Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

H₀ bie vërtetohet, ndërsa *H_a* bie poshtë.

Variabel tjetër i perfshirë në model është norma vjetore e interesit për depozita, ndikimi i të cilës mbi asetet mesatare për të siguruarit është negativ dhe sipas rezultatit nëse 1% rritet norma e interesit mbi depozitat atëherë asetet mesatare për të siguruar bien në 0,226%, ky rezultat është signifikant në nivelin 10%. Kontributet e anëtarëve dhe mjetet e tyre investohen në depozita, letra me vlerë etj, mirëpo nëse ulet norma e interesit mbi depozita edhe asetet mesatare për të siguruar ulen nga shkak i interesit të dyfishtë sigurues-fond

5. Ekuacioni për rastin e pestë: $NKB_t = 0.031$

H₀ Reforma e pensioneve NUK ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

H_a Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

H₀ vërtetohet ndërsa *H_a* bie poshtë.

Ndërsa tabela e regresionit tregon që norma e kthimit nga bonot e thesarit nuk ka ndikim signifikant statistikor mbi asetet mesatare për të siguruarit.

6. Ekuacioni për rastin e gjashtë: $D(\text{Reforma}_t) = 0.319^{***}$

H₀ Reforma e pensioneve NUK ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

H_a Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

H₀ bie poshtë, ndërsa *H_a* vërtetohet.

Ndërsa **ndikimi i reformës** është matur përmes **dummy variable**, rezultatet tregojnë që krahasuar me periudhën para reformës në periudhën pas reformës përgjithësisht asetet mesatare për të siguruar janë më larta 39% dhe rezultatet janë signifikante në 1%. Këto rezultate janë paraqitur në model nga shkaku që asetet e të siguruarve investohen në tregun financiar kombëtar dhe ndërkombëtarë.

Koeficienti i determinancionit (R Square) për modelin është 0,592 që nënkupton që rreth 59% e variancës në asetet mesatare për të siguruar shpjegohet nga variablat e përfshira në model.

Modeli është përfaqësues pasi variablat e pavarur të përzgjedhur shpjegojnë afërsisht ½ e aseteve mesatare për të siguruarit.

A) Analiza e korrelacioni

Kjo analizë bënë të mundur të kuptojmë korrelacionin që egziston ndërmjet variablit të varur është asetet mesatare për të siguruar ndërsa variabla të pavarur janë Asetet mesatare për vitin paraprak, performanca e fondit, niveli i të ardhurave kombëtare, norma vjetore e interesit për depozita, norma mesatare e kthimit për bonot e thesarit dhe ndikimi i reformës. Përmes Chi-Square test do të arrijmë të kuptojmë nëse ka apo nuk ka lidhje ndërmjet këtyre variablave.

Tabela.40 Tabela e korrelacionit, Modeli 2

Indikatorë asetet mesatare për të siguruar	Performanca e fondit	Niveli i të ardhurave kombëtare	Norma vjetore e interesit për depozita	Norma mesatare e kthimit për bonot e thesarit	Reforma	Cross-Tabulation Asymp.Sig
Asetet mesatare për të siguruar						
0-2 58 (58,9%)	73 (56,7%)	37 (31,2%)	50 (42,8%)	40 (33,7%)	78 (63,8%)	0.057
5 24 (24,2%)	20 (13,9%)	40 (33,7%)	27 (22,6%)	22 (16,7%)	24 (20,6%)	0.830
6< 16 (10,3%)	7 (4,6%)	22 (16,4%)	8 (4,2%)	36 (21,6%)	11 (7,4%)	0.074

Sic shohim në rezultatet përmbledhëse të tabelës më sipër, numri i të siguruarve në vitin paraprak, performanca e fondit, të ardhurat kombëtare, norma mesatare vjetore e interesit për depozitat dhe norma mesatare e kthimit për bonot e thesarit dhe reforma ndryshon në varësi të aseteve mesatare për të siguruarë.

Në mënyrë të ngjajshme, vihet re asetet mesatare për të siguruarë ndryshon. Në të gjitha rastet Asymp.Sig fuqia shpjeguese e Chi-Square tests rezulton të jetë < 0.05 , që nënkupton se testi i këtyre dy variablave rrëzon H_0 (e cila pohon se NUK ekziston një lidhje ndërmjet tyre) dhe vërteton H_a (e cila pohon se kjo lidhje ekziston).

5.3 Përmbledhje e rezultateve të Analizës së Regresionit, testimi i hipotezave

Pasi kemi analizuar në këtë mënyrë të gjitha regresionet e mësipërme vec e vec mund të diskutojmë lidhur me testimin e dy hipotezave. Përderisa një ose më shumë faktorë ndikojnë në numrin e të siguruarve dhe mbi asetet mesatare, atëherë mund të themi se reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv dhe efektet e saj forcohen prej faktorëve të tjerë që ndikojnë në të.

HIPOTEZA 1:

H₀: Reforma e pensioneve NUK ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguruarve.

Ha: Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi numrin e të siguruarve.

HIPOTEZA 2:

Ho: Reforma e pensioneve NUK ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

Ha: Reforma e pensioneve ka ndikim pozitiv mbi asetet mesatare për të siguruarit.

Si përfundim, bazuar në rezultatet e dy modeleve të mësipërme të regresionit mund të themi se në të gjitha rastet, Ho bie poshtë dhe vërtetohet Ha.

KAPITULLI I VI:

DISKUTIME, KONTRIBUTET E STUDIMIT, LIMITET & PERSPEKTIVAT E THELLIMIT NË TË ARDHMËN, PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

6.1 Diskutime

Në këtë kapitull do të diskutojmë në mënyrë më të detajuar rezultatet e këtij studimi. Diskutimi është ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë do të diskutohen rezultatet e analizës deskriptive dhe pjesa e dytë do të fokusohet tek rezultatet e analizës së regresionit të shumëfishtë.

1. Analiza deskriptive

Në kontekst të studimeve të tjera nga autorë të ndryshëm dhe nga modele të ndryshme pensionale erdhëm deri tek konstatimi se Samuelson ishte i pari që ka përshkruar se transferat midis gjeneratave nënkuptojnë një normë të kthimit të barabartë me shkallën e rritjes së popullsisë, që ai e quante “norma biologjike e interesit”. Për këtë arsye, trendi demografik i një vendi është një çështje e rëndësishme, që duhet të merret në konsideratë, si në përcaktimin e masës në para të pensionit që duhet të përfitojë një individ, që ka paguar kontribute, ashtu edhe në përcaktimin e burimeve financiare të skemës së pensioneve. Përveç trendit demografik, aspekte të tjera, që duhet të merren parasysh, janë dinamika e tregut të punës (veçanërisht numri i personave në forcat e punës), politikat e tatimeve dhe taksave (sidomos aftësia në mbledhjen e taksave) dhe fakti që niveli i përfitimeve duhet të konsiderohet si një përshtatje e sistemit të pensioneve me ndryshimin e rrethanave. Ndryshimet demografike kanë padyshim një ndikim të drejtpërdrejtë mbi qëndrueshmërinë financiare të skemës së pensioneve.

Sipas Feldstein, (2001: 2-4), rritja më e madhe e numrit të pensionistëve, krahasuar me rritjen e forcave të punës nuk është një problem i përkohshëm, por është një shqetësim i përhershëm lidhur me qëndrueshmërinë financiare të skemës së pensioneve (Guxho, 2014).

Sipas Schmahl, (1999:45), ndryshimet në situatën demografike dhe dinamika e tregut të punës mund të konsiderohen si dy nga faktorët kyç më të rëndësishëm që kanë impakt në skemën e pensioneve. Kështu, në një situatë mplakjeje të popullsisë dhe ku faktorët e tjerë janë të pandryshueshëm, sa më e lartë të jetë shkalla e varësisë së moshës së vjetër, aq më e madhe është nevoja për reformimin e skemës.

“Mplakja e popullsisë do të ndikojë në mënyra të ndryshme në të dy sistemet e pensioneve, si në sistemin *Pay-As-You-Go*, ashtu edhe në atë plotësisht të financuar”, duke filluar nga lindja e nevojës për të kompensuar efektet e zvogëlimit të forcave të punës dhe të rritjes së shkallës së varësisë të kontributeve të sigurimeve shoqërore në masën e kontributeve për pension, duke kombinuar forcimin e tregut të punës me reformën e pensioneve, rritja e popullsisë që sjell efekt në rritjen ekonomike dhe për pasojë edhe në normën e kthimit në të dyja sistemet. Për këtë arsye ky efekt duhet të merret në konsideratë si në sistemin PAYG, ashtu edhe në atë të financuar; politikëbërësit duhet të analizojnë ndikimin që ka mplakja e popullsisë në ndikimin në buxhet dhe nevojën për një sistem për ndarjen e barrës fiskale midis gjeneratave (*Po aty.*).

Nga analizat tona të hulumtuara shohim se në Republikën e Maqedonisë po zvogëlohet numri i lindjeve që do me thënë se në të ardhmen pritet që numri i pensionistëve të jetë më i madh se sa numri i të siguarve. Këtu luan rol vendimtar stabiliteti ekonomik dhe zvogëlimi i numrit të të punësuarve dhe të të siguarve, ndërsa për përlllogaritje financiare të pensioneve shumë është e rëndësishme numri i të siguarve

dhe pensionistëve nga shkaku që kontributet e të punësuarve paguajnë pensionet e pensionistëve. Nga analizat që kemi bërë për strukturën e moshës së popullsisë, shohim që ndërlidhja e dy grupeve të moshës po rritet nga 25,6 (në vitin 2005) në 63,01 (2057) dhe bie në 49,7 (2100). Kjo mplakje e popullatës do të ndikojë dukshëm në shtimin e numrit të pensionistëve, nga shkaku se sa më i lartë që është numri i popullatës së mplakur, aq më e lartë do të jetë numri i pensionistëve.

Në Maqedoni marrëdhëniet midis personave mbi 60 vjet me personat e moshë 18–59 vjeqare është paraparë të rritet nga 24% në 34% në vitin 2020, në vitin 2030 është rritur për 42% dhe deri në vitin 2050 parashikohet se do të arrijë në 55% .

Gjithashtu del se parashikimi për mplakjen e popullsisë, struktura e popullsisë ku është paraqitur dhe trajtuar për analizë numri i popullatës, mosha dhe gjinia deri në vitin 2100, në të shohim që në vitin 2040 gjeneratat e reja paraqiten me numër më të vogël të shtimit të popullsisë dhe në mënyrë absolute do të dominojnë individë të moshuar. Nga përfundimet tona vërehet se në Maqedoni ekziston trendi i mplakjes së popullatës, kjo sjell deri në rritjen e numrit të personave të moshuar në popullsinë e përgjithshme, në realitet dalin ndryshimet e marrëdhënieve midis pensionistëve dhe punonjësve të siguruar.

Tregues për mplakjen e popullsisë është krahasimi i popullatës së vjetër me popullatën e aftë për punë. Në analizat tona është paraqitur krahasimi i popullatës së vjetër me popullatën e aftë për punë dhe lëvizja e këtij krahasimi në të tre skenarët. Krahasimi i këtyre dy grupeve të popullatës rritet nga të tanishmet 18,9% në 49,9% në vitin 2060 dhe reduktohet deri në 44,1% në vitin 2080. Kjo do me thënë se në të ardhmen rreth gjysma e popullatës mbi 18 vjeç do të jetë popullatë e vjetër.

Sipas skenarit optimist kjo arrin maksimumin prej 45,4% në vitin 2060 që në vitin 2080 të reduktohet në 36,7%. Në skenarin optimist krahasimi lëviz nga 53%

(maksimumin në vitin 2070) deri më 50% (2080). Sipas të tre skenarëve ekziston mplakja e popullatës në afat më të gjatë.

Kurse, në hulumtimet dhe analizat tona që kemi bërë për numrin e të sigurve dhe pensionistëve prej vitit 2003 deri më vitin 2013, ku është bërë edhe krahasimi i tyre me qëllim për të matur efektet financiare në reformë. Një faktor shumë i rëndësishëm i cili na ndihmon të masim efektin financiar është edhe numri i kontribuesve në skemën pensionale, ngaqë kontribuesit paguajnë pensionet e realizuara (pensionistëve). Këtë e vërejmë që prej fillimit të reformës të vitit 2003 numri i kontribuesve në skemën pensionale është shumë më i lartë se numri i pensionistëve. Në fillim të reformës numri i të sigurve ishte më i lartë për 78.461, ndërsa në vitin 2013 numri i kontribuesve arrin 306.573 kontribues në skemën pensionale. Nga kjo shohim se reforma e pensioneve në Republikën e Maqedonisë jep efekte financiare pozitive.

Në analizat tona rreth lëvizjes së ardhshme të numrit të të sigurve dhe pensionistëve sipas skenarit bazik dhe krahasimit të tyre vërejmë se në periudhën fillestare të projeksioneve deri në vitin 2020 numri i të sigurve rritet, ndërsa pas vitit 2020 numri i të sigurve fillon të ulet për shkak të lëvizjeve demografike dhe stabilizimit të rritjes ekonomike.

Dhe, kjo rezulton se numri i pensionistëve në mënyrë të vazhdueshme në 50 vitet e ardhshme rritet, e pastaj reduktohet. Krahasimi mes të të sigurve dhe pensionistëve nga të tanishmit 1,8% të sigurve në një pensionist në afat më të gjatë reduktohet në 1,2% të sigurve në 1 pensionist. Ky trend i krahasimit do të thotë se gjithnjë e më pak të sigurve do të paguajnë për një numër më të madh të pensionistëve.

Në të dhënat tabelare që kemi paraqitur në grafiket tona analitike janë paraqitur shpenzimet transitive në krahasim me buxhetin, ku vërehet një reduktim gradual i

shpenzimeve për pensione në tre skenarët. Kjo ka të bëjë me dy faktorë, reduktimin e obligimeve të fondit për shkak të reformave parametrike dhe reduktimin gradual të shkallës zëvendësuese të pensioneve prej 80% në 72% për të siguruarit që do të mbesin vetëm në Shtyllën e Parë. Në skenarin bazik shpenzimet për pensione reduktohen prej 8,53% nga BPV në 6,64% nga BPV në fund të periudhës së projeksionit.

Davis (1998:7), sistemet e menaxhuara privatisht kanë tendencë të kenë kosto administrative më të larta dhe "ekonomi" të shkallës më të ulët. Pjesëmarrja në një skemë pensionesh mund të jetë e detyrueshme me ligj, ose mund të bazohet në vendimin personal të individit. Skemat vullnetare të pensionit lejojnë individin që të vendosë vetë për mirëqenien e tij, por në përgjithësi mbartin me vete shumë rreziqe.

Sipas Bolle në Salisu, (2007:22), eksperiencat e deritanishme kanë treguar se skema pensionale me kapital financiar duhet të jetë e detyrueshme, kjo për arsye se personat me të ardhura të ulta mund të mos jenë të prirur për të mar pjesë në mënyrë vullnetare në skemë, ndërkohë që ata që janë me të ardhura të larta mund të mos e shikojnë të nevojshme pjesëmarrjen në skemën e sigurimit, që do të thotë se paraqitet mungesë e kontributeve në skemë për këto kategori individësh (*Po aty*).

Në Republikën e Maqedonisë është e përcaktuar në Ligjin për Kapital Financiar të Sigurimit Pensional se kolona pensionale me kapital financiar është detyrueshme dhe se pjesëmarrja në Shtyllën e Tretë pensionale është vullnetare.

Sipas Pinerës, (2004:24), në këtë sistem, punonjësit mund të zgjedhin cilëndo nga kompanitë e fondeve private të pensioneve për të menaxhuar llogaritë e tyre kontributive. Këto kompani nuk mund të angazhohen në asnjë aktivitet tjetër privat dhe janë subjekt i një mbikëqyrjeje të rreptë nga ana e një agjencie qeveritare. Punonjësve aktualë, që kishin kontribuar në sistemin shtetëror, u jepej mundësia të qëndronin në të edhe pse e ardhmja

e tyre ishte problematike. Ata që dolën nga sistemi morën një “bono njohjeje”, e cila vërtetonte kontributet e tyre në sistemin e vjetër. Kur këta punonjës do të dilnin në pension, qeveria do t’ua shlyente këto obligacione. Ligji inkurajonte posedimin e një portofolio të larmishme, pa asnjë lloj detyrimi për të investuar në bono qeveritare ose në forma të ndryshme sigurimi.

Të gjeturat tona tregojnë se në afat prej 30 ditëve anëtarët e kanë të drejtën për t’u përcaktuar se në cilin fond pensioni do të anëtarsohen, të drejtë anëtarësimi kishin personat nën moshën 40 vjet dhe të punësuarit e rinj, fondet e pensioneve janë nën mbikëqyrjen e Agjencionit MAPAS dhe se Ligji i inkurajonte që 70% të portfolios të ishin investuar në bono qeveritare.

Modeli Kilian është një lloj alternative e kursimeve të detyruara, i cili si model thekson vetëmbrojtje, por edhe një model të llogarive pensionale. Menaxhimi i llogarive pensionale është i privatizuar plotësisht dhe ka të bëjë me llogaritë pensionale nga vetëfinancimi politik e privat, nga kompani të sigurimit të pensioneve për të maksimizuar normën e kthimit, ndërsa implementimi i sistemit të sigurimit pensional është minimal. Modeli Kilian përfshin garantimet e llojit: një përfitim i ulët i ndihmës sociale për ato shpenzime që nuk mund të mbulohen nga plani i detyrueshëm, një pension minimal i garantuar nga shteti prej rreth 25% e pagës mesatare, nëse kontributet për pension janë paguar për të paktën 20 vjet dhe një normë përfitueshmërie minimale e garantuar për çdo fond pensioni, i krahasuar me mesataren për shtetin, ku pagesa e garantuar nga shteti vjen në shprehje në momentin kur kompania e sigurimeve pensionale private dështon në menaxhimin e saj (*Hysa, 2013:18-19*).

Në pjesën teorike kemi vërejtur se pensionet në Republikën e Maqedonisë janë të ndara, nga pensionet me kapital financiar 30% e pagës mesatare i garanton shteti nëse

kontributet për pension janë paguar për 15 vite me normë përfitueshmërie të pensionit minimal dhe se nëse kompania e sigurimeve pensionale private dështon në menaxhimin e saj atëherë 80% të kursimeve të grumbulluara i garanton shteti.

Xhejms dhe Vizas skemën e kursimeve pensionale të obliguar e kishin argumentuar me rolin dhe efektin financiarë të veprimtarisë përmes pyetjes së kursimeve pensionale (1995).

Nga analizat tona të hulumtuara statistikore vërehet se në fillim të reformës pensionale balanca midis të të ardhurave dhe shpenzimeve sjellë efekte financiare negative; mirëpo, prej vitit 2006 e deri në 2013 bilanci i tyre kishte filluar të sjellte efekte pozitive me përfitime më të ulta pasiqë ishin 10 vitet e para të reformës.

2. Analiza e Regresionit

Pjesa më e rëndësishme e këtij diskutimi i përket pikërisht analizës së regresionit e cila edhe do ti përgjigjet pyetjeve kërkimore?

1. A ka ndikuar pozitivisht reforma e pensioneve mbi numrin e të siguruarve?
2. A ka ndikuar pozitivisht reforma e pensioneve mbi asetet mesatare për të siguruarit?

Do ti kthehemi edhe njëherë gjetjeve të analizës së regresionit në të cilën do të shpjegojmë ndikimin e reformës së pensioneve në numrin e të siguruarve dhe ndikimin e reformës së pensioneve asetet mesatare për të siguruar.

Kujtojmë këtu se literatura dhe kuadri teorik i grupojnë faktorët që kushtëzojnë numrin e të siguruarve dhe asetet mesatare për të siguruar. Ndërkohë që faktorët që masin ndikimin e reformës mbi numrin e të siguruar janë, numri i të siguruarve në vitin paraprak, shkalla anuale e kthimit, të ardhurat për frymë banori dhe norma e papunësisë. Ndërsa faktorët

që kushtojnë ndikimin e reformës mbi asetet mesatare për të siguruar janë, shkalla anuale e kthimit, të ardhurat për frymë banori, norma mesatare vjetore e interesit për depozita dhe norma mesatare vjetore e kthimit për bonot e thesarit në Maqedoni.

- Problemi i parë lidhet me numrin e të siguruarve në vitin paraprak

Nga rezultatet e analizës së regresionit në studim numri i të siguruarve rezulton të jetë pozitiv. Rezultatet e studimit tregojnë që Koeficienti i Regresionit për nivelin e të siguruarve për vitin paraprak në të tre modelet është pozitiv gjë që tregon që numri i të siguruarve në vitin paraprak ndikon pozitivisht mbi numrin e të siguruarve në vitin aktual, në të tre rastet signifikanca është paraqitur më me pak problematik dhe kjo maredhënie ka signifikanc statistikore në nivelin 1% ndërsa të dhënat për modelin e tretë nuk kanë signifikanc statistikore.

Në bazë të studimit është që është shpjeguar edhe te qëllimi i reformës por edhe në tregun e punës, se qëllimi i reformës është të përfshijë në skemën pensionale të punësuar të rinjë nën moshën 40 vjet nga shkakun që norma kontribuive është shumë më e ulët për të punësuarit e rinjë sesa për ato të moshës mbi 40. Kjo është edhe arsyeja pse signifikanca statistikore në modelin e tretë është negative.

- Problemi i dytë lidhet me shkallën anuale të kthimit

Performanca e fondit në model është matur përmes shkallës anuale të kthimit, në të katër modelet ashtu sic pritej ka ndikim pozitiv i cili është signifikant në nivelin 10% për modelin e parë, 1% për modelin e dytë, 10% për modelin e tretë dhe 10% për modelin e katërt. Ndikimi më i madh i shkallës anuale të kthimit është paraqitur në modelin e parë dhe modelin e dytë, nëse 1% rritet shkalla anuale e kthimit me 0,06% rritet numri i të siguruarve, ndërsa në shtyllën e dytë me 0,05% ndikimi më i vogël shihet te modeli i tretë ose grupmosha 40 - 60 ku 1% rritje në shkallën anuale e kthimit rrit numrin e të siguruarve

me 0,07%. Shkalla anuale e kthimit është paraqitur me ndikim më të ulët në modelin e tretë nga shkak që kontributet e po të njejtëve shfrytëzohen për pensione (1 kontribues 1 pensionist), ndërsa kontributet e modelit të parë dhe të dytë kursehen në formë individuale dhe mjetet e kursimit të tyre investohet edhe në tregun ndërkombëtar gjë që sjellin shkallë anuale të kthimit më të lartë.

- Problemi i tretë lidhet me nivelin e të ardhurave për frymë banori

Niveli i të ardhurave kombëtare është njëra ndër variablat më me shumë ndikim mbi numrin e të siguruarve në të gjitha modelet, përpos në modelin prej moshës 40-60 vite, rezultatet kanë signifkancë statistikore, ndërsa ndikimi më i madh shihet te kolona e dytë nëse të ardhurat kombëtare rriten për 1% numri i të siguruarve rritet për 2,77%. Ndikimi në grupmoshën deri në 40 vjet është 1,079% ndërsa në modelin e parë ku përfshihen të gjitha grupmoshat është 0,348%. Ndikimi më i madh është i paraqitur në shtyllën e dytë nga shkak që të ardhurat drejtpërdrejt ndikojnë në rritjen e numrit të punësimeve të reja me atë edhe rritet numri i të siguruarve.

- Problemi i katërt lidhet me normën e papunësisë

Interesante janë edhe rezultatet e normës së papunësisë të përfshirë në model e cila është signifkante në modelin e parë dhe dytë por jo në modelin 3 dhe 4. Në modelin e parë ku është e përfshirë e tërë mostra mund të shihet se 1% rriten, ndërsa normën e papunësisë e zvoglon numrin e të siguruarve me 0,043% ndërsa ndikim më të madh ka në grupmoshën tjetër deri në 40 vjet ku 1% rritje e papunësisë zvoglon numrin e të siguruarve me 11,6%. Nga kjo shihet se struktura e moshës së të siguruarve në skemën pensionale është nën moshën 40 vjet, pikërisht të siguruar të rinjë.

- Problemi i pestë lidhet me ndikimin e reformës

Nga ana tjetër ndikimi i reformës është matur përmes dummy variabël, rezultatet tregojnë që krahasuar me periudhën para reformës në periudhën pas reformës përgjithësisht numri i të siguruarve është më i madh, e sidomos ndikimi më i madh është prej 18 deri në 40 vjet, por ndikimi i reformës kushtëzohet nga rrethana të tjera ekonomike të përfshira në model. Por kjo që ndodh kemi shpjeguar edhe më herët në punim se numri i sigurve në skemën pensionale prej viti në vit është rritje dhe ndikimi i moshës 18 - 40 vjet është për shkak se pjesë e reformës janë të punësuarit pas vitit 2003 e këndej, personat që për herë të parë punësohen dhe personat nën moshën 40 vjet.

- Problemi i gjashtë lidhet me performancën e fondit mbi asetet mesatare për të siguruar

Performanca e fondit në model, e matur përmes shkallës anuale të kthimit, ashtu siq pritej ka ndikim pozitiv i cili është signifikan në nivelin 1%; rezultatet tregojnë se nëse 1% rritet shkalla anuale e kthimit me 0,045% rritet asetet mesatare për të siguruar. Shkalla anuale e kthimit nga investimi, nënkupton fitim më i lartë i fondeve pensionale dhe me fitim më të lartë rriten edhe asetet mesatare për të siguruar.

- Problemi i shtatë lidhet me nivelin e të ardhurave për frymë banori mbi asetet mesatare për të siguruar

Niveli i të ardhurave për frymë banori është njëra ndër variablat më me shumë ndikim mbi asetet mesatare për të siguruar, që sipas rezultateve nëse 1% rriten të ardhurat për frymë banori, asetet mesatare për të siguruar rriten më 0,65%; ndërsa ky rezultat është signifikan 1%. Kur përllogariten asetet mesatare për të siguruar, niveli i të ardhurave kombëtare gjatë përllogaritjes është faktori i parë i cili ka ndikim edhe në këtë rast nëse niveli i të ardhurave është në rritje atëherë edhe asetet për anëtar janë në rritje.

- Problemi i tetë lidhet me normën vjetore të interesit për depozita

Norma vjetore e interesit për depozita, ndikimi i të cilës mbi asetet mesatare për të siguruarit është negativ dhe sipas rezultatit nëse 1% rritet norma e interesit mbi depozitat atëherë asetet mesatare për të siguruar bien në 0,226%, ky rezultat është signifikant në nivelin 10%. Kontributet e anëtarëve dhe mjetet e tyre investohen në depozita, letra me vlerë etj, mirëpo nëse ulet norma e interesit mbi depozita edhe asetet mesatare për të siguruar ulen nga shkak i interesit të dyfishtë sigurues-fond

- Problemi i nëntë lidhet me ndikimin e reformës mbi asetet mesatare për të siguruar

Ndërsa ndikimi i reformës është matur përmes dummy variable, rezultatet tregojnë që krahasuar me periudhën para reformës në periudhën pas reformës përgjithësisht asetet mesatare për të siguruar janë më larta dhe rezultatet janë signifikante në 1%,

6.2 Kontributet e studimit, limitet & perspektivat e thellimit në të ardhmën

Diskutimet rreth rëndësisë që ka sod pensioni për zhvillimin e një vendi janë të shumta. Në mënyrë më specifike rëndësia që ka reforma e pensioneve për zhvillimin e vendit është i padiskutueshëm. Por kur flitet për reforma të pensioneve gjithmonë merren shembuj nga shtetet më të suksesshme në botë të tilla si Zvicra, Sllovenia, Bullgaria etj, sepse ato janë shembuj që ofron pjesë më të madhe të literaturës që ne kemi shfrytëzuar.

Në përpjekje për të parë se si ka ndikuar reforma e pensioneve në Republikën e Maqedonisë ky studim është fokusuar në kuadër të plotë teorik mbi pensionet, reformën pensionale me kapital financiar, analizë teorike të funksionimit të Fondit për Sigurim Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë dhe Shoqërisë pensionale private dhe analizën e regresionit e cila na ka ndihmuar të masim ndikimin e numrit të të siguruarve

në kategori të ndryshme e cila është matur përmes shkallës anuale të kthimit, të ardhurave kombetare për frymë banori, normës së papunësisë dhe reformës dhe analiza e dytë e cila na ka ndihmuar që të masim asetet mesatare për të sigurarë, përmes numrit i të sigurve në vitin paraprak, performanca e fondit, të ardhurat kombetare, norma mesatare vjetore e interesit për depozitat dhe norma mesatare e kthimit për bonot e thesarit.

Në këtë kuptim ky studim jep një kontribut të rëndësishëm të reformës së pensione në periudhë afatgjatë të cilët do të shërbejnë jo vetëm shteteve të cilët do të bëjnë reforma të pensione por edhe strukturave të larta vendim-marrëse, studiuesve shqiptar dhe atyre të huaj.

Së pari, ky studim merr përsipër të analizoj reformën e pensione në vendin tonë. Studimi i pensione është i nivelit makroekonomik dhe është objekt i institucioneve të Ministrisë për Punë dhe Politik Sociale, Ministrisë së Financave dhe Agjencionit për Mbikëqyrje të Pensioneve.

Ky studim sjell një panoramë të përgjithshme të reformës së pensione. Së dyti përveç dhënies së një panorame të përgjithshme studimi ynë synon të analizoj dhe të gjejë se si ka ndikuar reforma e pensione në numrin e të sigurve në kategori të ndryshme dhe të masë ndikimin e reformës në asetet mesatare për të siguruar. Në këtë kuptim, ky studim nuk ka vetëm karakter përshkrues, por hulumtues dhe analitik duke synuar zbulimin e numrit të të sigurve dhe aseteve mesatare për të siguruar ndërmjet variablave të varur dhe të pavarur në pensione.

Së treti, përmes këtij studimi institucionet shtetërore që merren me pensione kanë mundësi të bëjnë një vlerim të aktiviteteve të tyre të përditshme duke theksuar aktivitetet që përmirsojnë pensionet dhe menaxhimin e tyre, duke korigjuar aktivitetet që mund të bëhen pengesë për zhvillim e tij.

Së katërti, ky studim ju vjen në ndihmë studiuesve shqiptar dhe atyre të huaj, që të krijojnë një ide konkrete mbi reformat e pensioneve dhe mbi këtë bazë të inicojnë studime të reja në të ardhmën.

Së pesti ky studim tenton të japë një kontribut modest në drejtim të pensioneve.

Së fundmi, në periudhë afatgjate në rast se rezultatet e këtij studimi merren në konsiderat pensionet do të përmirsohen ndjeshëm.

Ky studim është përballur me shumë vështirësi, të cilët e bëjnë që studimi të jetë i limituar.

Së pari studimi fokusohet në pensione që është pjesa më e ndjeshme e shtetit dhe mbledhja e të dhënave ka qenë relativisht e vështirë. Mirëpo pavarësisht limiteve, ky studim nxit studimet vijuese të po të këtij drejtimi të rëndësishëm në të cilë studiuesit mund të thellohen në nxitjen e rritjes së numrit të të siguruarve dhe rritjen e vlerës së aseteve mesatare për të siguruar.

6.3 Konkuzionet

Diskutimet rreth reformës pensionale janë të shumta. Por, kur flitet për pensione gjithmonë merren shembuj nga shtete të suksesshme të cilat i kanë reformuar pensionet. Motivimi për reformë në Republikën e Maqedonisë ishte për t'i shpëtuar një ekonomie në rënie. Në këtë kuptim, ky studim sjell disa kontribute të rëndësishme afatshkurtëra dhe afatgjata. Duke matur parametrat ekonomikë, ky studim ka patur qëllim ndikimin e reformës pensionale në Republikën e Maqedonisë si dhe interaksionin e saj në kushtet e tjera ekonomike në tregun pensional.

Në punim janë parashtruar dy hipoteza. Me synim për testimin e këtyre dy hipotezave është shtjelluar një kuadër i plotë teorik mbi pensionet, reformën pensionale me kapital financiar, analizë teorike e funksionimit të Fondit për Sigurim Pensional Invalidor të Republikës së Maqedonisë dhe Shoqërisë pensionale private me qëllim për të parë se si kishte ndikuar reforma.

Në testimin e hipotezave, përmes metodave statistikore të regresionit, është mundësuar përpunimi i të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve për reformën pensionale. Bazuar në analizën e regresionit dhe rezultatet, vijmë në përfundim se së pari reforma e pensioneve kishte ndikim pozitiv, numri i të siguruarve në vitin paraprak kishte ndikuar pozitivisht mbi numrin e të siguruarve, shkalla anuale e kthimit gjithashtu ka ndikuar pozitivisht në numrin e të siguruarve, niveli i të ardhurave për frymë banori ishte njëri ndër variablat më me shumë ndikim në numrin e të siguruarve, norma e papunësisë gjithashtu kishte ndikuar pozitivisht në numrin e të siguruarve dhe së dyti, në periudhën para dhe pas reformës, ndikimi i reformës mbi asetet mesatare për të siguruar është pozitiv, performanca e fondit e cila ishte matur përmes shkallës anuale të kthimit kishte ndikuar pozitivisht, niveli i të ardhurave për frymë banori mbi asetet mesatare për të

siguruar është variabli më me shumë ndikim mbi reformën e pensioneve ndërsa norma mesatare e interesit për depozita dhe bono të thesarit ishte variabli i vetëm i cili kishte ndikim negativ në asetet mesatare për të siguruarit.

Konkudojmë se në Republikën e Maqedonisë vërehet se ekziston trendi i mplakjes së popullatës dhe në realitet dalin ndryshimet e marëdhënieve midis pensionistëve dhe punonjësve të siguruar. Mplakje e popullatës do të ndikojë dukshëm në shtimin e numrit të pensionistëve, nga shkak se sa më i lartë që është numri i popullatës së mplakur, aq më e lartë do të jetë numri i pensionistëve.

Gjithashtu nga studimi vim në përfundim se reforma e pensioneve në Republikën e Maqedonisë jep efekte financiare pozitive ku prej vitin 2006-2013 kishte nxjerrur efekte pozitive midis të ardhurave dhe shpenzimeve, kuptohet që përfitimet janë më të ulëta nga shkakut që ishin 10 vitet e para të reformës së pensioneve.

Në tregjet në zhvillim, kursimet e familjeve për pension në fondet e pensioneve janë relativisht të vogla, por po rriten me shpejtësi. Akumulimi i kursimeve të fondeve pensionale varet nga një numër faktorësh, duke përfshirë reformën e pensioneve, veçanërisht pensionet e detyrueshme të financuara dhe performancën e fondeve. Faktorë strukturorë dhe shumë të rëndësishëm, si rritja e të ardhurave dhe shkalla e papunësisë gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e kursimeve të pensioneve, ndërkohë që mjetet e fondit të pensioneve çojnë në zhvillimin e rëndësishëm të sektorit financiar.

Bazuar në këta faktorë, implikimet kryesore të politikës për inkurajimin e kursimeve pensionale për të ardhurat e daljes në pension përfshijnë nevojën për:

- Lehtësimin e mbulimit dhe mbështetjes së të ardhurave të pleqërisë përmes formave të detyrueshme të kursimit, rregullave të paracaktuara dhe rrjeteve të tjera të sigurisë sociale.
- Rritja e kthimeve neto të rregulluara nga rreziku përmes rritjes së fleksibilitetit për përfitimet e diversifikimit
- Zvogëlimi i kostove duke shfrytëzuar ekonomitë e shkallës dhe minimizimin e ngarkesave të tjera
- Promovimin e mbrojtjes dhe vetëdijes së investitorëve përmes informimit dhe edukimit.

6.4. Rekomandimet

Nga të gjeturat e hulumtuara, të studiuara, analizave të bëra përmes të dhënave të përpunuara statistikore, shqyrtimeve teorike, përvojave nga periudhat e kaluara hulumtuese dhe fakteve e argumenteve tjera në këtë punim të doktoratës Reformat e Pensioneve në Republikën e Maqedonisë, në mënyrë që të bëhet një ndihmesë më e madhe në menaxhimin dhe adaptimin e këtyre reformave drejt një legjislacioni modern ekonomik e social për fushën e pensioneve të të gjitha llojeve, mendojmë se duhet dhënë këto rekomandime:

- Meqenëse parashikimet lidhur me të ardhmen financiare të skemës pensionale në Republikën e Maqedonisë janë mbështetur në supozime të shumta ekonomike, sociale dhe demografike. Prandaj, konsideroj se është e nevojshme që në situata të caktuara periodike dhe në mënyrë të saktë duhet të rishikohet modeli i pensioneve sipas Modelit Aktuarial.

- Shoqëritë pensionale private mendojmë se duhet të vazhdojnë të funksionojnë të pavarura nga institucionet shtetërore, qeveria dhe nga politika e vendit në tërësi.
- Procesi i tranzicionit social dhe ekonomik, i cili në fazat e tij fillestare kishte vështirësi të konsiderueshme për t'u adaptuar situatave të reja post-tranzicionale (sikurse edhe në vendet e tjera që kanë kaluar proceset tranzitore politike, ekonomike, sociale, kulturore e integruese të njohura) konsideroj se meqenëse po vazhdon ende, do të duhej menaxhuar konform situatave politike, ekonomike dhe sociale, që janë duke kaluar këto vende, në këtë rast edhe Republika e Maqedonisë.
- Gjithashtu konsiderojmë se duhet të ketë një koordinim efektiv midis politikave pensionale dhe politikave të nxitjes së punësimit, në mënyrë që të inkurajohen njerëzit që të qëndrojnë sa më gjatë aktiv në tregun e punës.
